

BOTIM I UNIVERSITETIT MESDHE'TAR TË SHQIPËRISË

EUROMEDITERRANEAN

Revistë periodike shkencore

4

Dhjetor 2012

Tiranë, Dhjetor 2011

© UMSH PRESS

EUROMEDITERRANEAN

Revistë shkencore

Botim i UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Nën Drejtimin e Akad.Asoc. Prof. Dr Anastas ANGJELI

Bordi i Nderit

Prof.Dr.Arben Put
Prof.Dr.Artistotel Pano
Prof.Dr.Sabah Hilmija
Prof.Dr.Ilia Kristo
Prof.Dr.Emin Riza
Prof.Dr.Vasil Tole

Kryeredaktor

MA. Ilir HEBOVIJA

Redaktorë Shkencore

MA.Nevila RAMA
MA.Kriton KUÇI

Bordi Drejtues-Shkencor -Editorial

Kryetar

Prof.Dr.ANASTAS ANGJELI
Akademik i Asoc.

Anëtarë

Prof.Dr.Kosta Bajraba
Prof.Dr Ilia Kristo
Prof.Dr. Esmeralda Uruçi
Prof.Dr. Stefan Çapaliku
MA. Ben Blushi
Prof.Asoc. Mimoza Manxhari
Prof.Dr.Orfea Dhuci
Dr. Hysen Çela
Dr. Altin Hoti
Dr. Fatos Ibrahimimi
Dr.Skender Demaliaj
MA. Gjergj Teneqexhi
MA. Ardian Petollari
MA. Nevila Rama
MA Jona MARASHI
MA. Ilr Aliaj
MA.Besnik Leskaj
MA. Kriton Kuci
MA. Etleva Vertopi
MA.Merita Myftari
MA. Emilio Cika

Kopertina Quick Advertise

Faqosja: Dafina Stojko

© UMSH PRESS

Shtypyr: GEER, 2011

PËRMBAJTJA

I. GLOBALIZIMI

EVROPA E QYTETARËVE: HABERMASI DHE SFERA PUBLIKE EVROPIANE

Enis SULSTAROVA

Universiteti i Tiranës 7

GLOBALIZIMI SI FENOMEN DHE SI PROCES.

GLOBALIZIMI DHE SFIDAT E ARSIMIT TË LARTË

Joana KOSHO

Universiteti Aleksandër Xhuvani 25

KRIZA GLOBALE DHE DEBATI PER EURON

Prof. Dr. Anastas ANGJELI

Rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë 39

DISA ASPEKTE LIGJORE TE LIDHJES SE GLOBALIZIMIT

ME PASTRIMIT E PARAVE

Naim MËÇALLA

Universiteti i Tiranës 45

GLOBALIZIMI DHE NDIKIMI I SAJ NË VLERAT ETIKE,

NE KULTURËN E POPUJVE SI DHE PASOJAT E SAJ NE SJELLJEN

E ADMINISTRATES PUBLIKE

Rita LOLOCI

Shkolla e Larte Private "Vitrina" 59

KULTURA KOMBËTARE SI IDENTITET

Tonin ÇOBANI

Instituti Shqiptar i Sociologjisë 70

IDENTITETI KOMBETAR PERBALLE GLOBALIZIMIT- RIKONCEPTIM I

EDUKIMIT TE ADOLESHENTEVE

Zhulieta DEMI

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës 75

**MIGRIMI I POPULLSISË DHE IMPAKTET SOCIALE TË TIJ NË RAJONIN
NDËRKUFITAR TË GOLLOBORDËS**

Artan LILA

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Ilir HEBOVIA

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Enis URUÇI

Universiteti “Aleksander Moisiu”, Durres 87

II. MIGRIMI

**PËRVOJA SHQIPTARE E MIGRIMIT NË NJË
KONTEKST NDËRKOMBËTAR**

Esmeralda URUCI

Universiteti Aleksandër Moisiu

Fatilda BERISHA TAHIRI

Universiteti i Tiranës

Anisa SINA

Universiteti i Tiranës 97

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TE EMIGRIACIONIT SHQIPTAR

Kosta BARJABA

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Jona MARASHI

Simpson College, USA

Joniada BARJABA

Stanford University, USA 106

**MIGRACIONI, LËVIZJA E LIRË E PERSONAVE DHE
MARRËVESHJET E RIPRANIMIT**

Ledia HYSI

Ministria e Punëve të Jashtme 111

I.

GLOBALIZMI

EVROPA E QYTETARËVE: HABERMASI DHE SFERA PUBLIKE EVROPIANE

Enis SULSTAROVA
Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

Many scholars of EU have noted the absence of the demos and the so-called democratic deficit of European integration. A project to solve this issue and to bring the project of European unification closer to the citizens has been proposed by Habermas, in the framework of his communicative theory. This paper will present his project of reforming and deepening the integration from below, as well as some of the discussions and critiques it has generated.

Keywords: Habermas, postnational Europe, public sphere, citizenship

Nuk mund të ketë shtet federal evropian të denjë për emrin e demokracisë evropiane nëse brenda caktit të kulturës së përbashkët politike nuk zhvillohet një sferë publike mbarevropiane; një shoqëri civile që të përfshijë shoqata të grupeve të interesit, organizata ndërkombëtare, lëvizje të qytetarëve etj. dhe, sigurisht, një sistem partiak të përshtatshëm për arenën evropiane.

Jyrgen Habermas (1998: 160)

Hyrje

Jyrgen Habermasi [Jürgen Habermas] ka dhënë kontribute të shquara në filozofi, sociologji dhe teorinë politike. Ai është një ndër intelektualët më të shquar të Gjermanisë dhe të Evropës, jo vetëm prej ndikimit të veprës së tij,

por edhe sepse ai ndërhysh në debatet publike lidhur me çështje të rëndësishme. Në vendin e tij ai është frymëzuesi i social-demokratëve dhe prej disa dhjetëvjeçarëve është përpjekur të zhvillojë një kulturë politike demokratike prej mësimëve të nxjerra nga katastrofa e Luftës së Dytë Botërore. Që nga vitet 60 të shek. XX ndërhyrjet e tij me peshë në çështjet shoqërore dhe politike kanë ndikuar në kulturën politike të Gjermanisë (Blühdorn, 1999: 185; Cronin & Pensky, 2006: vii; Finlayson, 2008: 10; Pensky, 2001: xi).

Gjithashtu, Habermasi është përkrahës i projektit të bashkimit politik të Evropës, si mënyra më e mirë për të ruajtur fitoret e liberalizmit dhe social-demokracisë në kushtet e globalizimit dhe për të avancuar në krijimin e një rendi kozmopolit botëror. Kjo ka qenë tema e një sërë esesh të tij gjatë viteve 90 të shekullit të kaluar dhe gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Duke u përqendruar te këto ese, në këtë artikull do të paraqitet vizioni i tij për një Evropë të qytetarëve që diskutojnë në sferën publike dhe krijojnë një qytetari evropiane. Së pari, do të trajtohet shtrati filozofiko-sociologjik mbi të cilin qëndron projekti habermasian për Evropën e bashkuar. Më pas do të përvijohet ky vizion dhe në fund do të diskutohet mënyra se si Habermasi Evropën e bashkuar e sheh si një stacion drejt një rendi kozmopolit.

Bota e jetës dhe globalizimi

Për të shtjelluar projektin e Habermasit të bashkimit politik të Evropës, më parë duhet të themi diçka për bazën filozofike mbi të cilën ngrihet ai. Habermasi dallon dy lloje të veprimit të arsyeshëm njerëzor: (1) veprimi komunikues, i orientuar për nga krijimi dhe pranimi i vlerave të përbashkëta dhe (2) veprimi instrumental që llogarit mjetet më të përshtatshme dhe me më pak kosto për arritjen e qëllimeve të caktuara, siç ndodh p.sh. në fushën ekonomike. Veprimi komunikues buron nga bota e jetës, e cila përmbledh tërësinë e aftësive informale dhe njohurive që individit përdor në situata të caktuara dhe që janë pjesërisht të dhëna nga familja, grupet e tjera shoqërore dhe kultura. Me fjalë të tjera, bota e jetës ofron një stok kuptimesh dhe një horizont shoqëror për takimet e përditshme midis njerëzve dhe funksioni i saj është minimizimi i divergjencave, mosmarrëveshjeve dhe keqkuptimeve gjatë komunikimit. Ajo është edhe mjeti për riprodhimin simbolik dhe kulturor të shoqërisë nga brezi në brez. Veprimi komunikues ndikon në ndryshimin e botës së jetës, por ky ndryshim bëhet pjesë-pjesë dhe gradualisht (Finlayson, 2008: 76-83).

Veprimi instrumental përdor sendet dhe njerëzit e tjerë si burime materiale

dhe organizative që individit të realizojë qëllimet e tij strategjike. Produkti i veprimit instrumental është sistemi, i cili në shoqëritë moderne ndahet në nënsistemin e pushtetit dhe në atë të ekonomisë. Veprimi instrumental në mënyrë paradoksale varet nga bota e jetës, por njëkohësisht ka tendencën për ta përçarë atë, prandaj në shoqëri, krahas solidaritetit, ndeshemi edhe me individualizmin e skajshëm. Zgjerimi dhe ndërlikimi në rritje i shoqërive si pasojë e industrializimit e vështirëson integrimin shoqëror dhe prandaj nënsistemet e ekonomisë dhe të administratës shtetërore e marrin përsipër një pjesë të barrës së veprimit komunikues. Por sa më shumë që sistemi ndërhyt në botën e jetës, aq më shumë ka rrezik që kjo e fundit të mos realizojë funksionin e saj integrues, sepse sistemi udhëhiqet nga interesa që nuk përkojnë gjithmonë me mirëkuptimin dhe bashkëpëlqimin. Prandaj, Habermasi flet për “kolonizimin e botës së jetës” nga sistemi. Duke qenë se sistemi faktikisht varet nga bota e jetës, kolonizimi sjell paqëndrueshmëri dhe kriza brenda sistemit (po aty: 84-87). Sikurse Maks Veberi para tij, edhe Habermasi mendon se solidariteti në shoqërinë moderne kërcënohet nga ndërhyrja e burokracisë, përlllogaritjes ekonomike dhe instrumentalizimit politik. Kontributi kryesor i teorisë së veprimit komunikues të Habermasit është mbrojtja e botës së jetës në kushtet e tanishme të modernitetit. Sipas tij, vazhdimi i projektit iluminist sot ka të bëjë me mbrojtjen e botës së jetës dhe të lirive qytetare nga efekti gjërryes i sistemit global (Habermas, 2001a: 71-72). Çdo çarje e botës së jetës, si pasojë e sistemit, ka nevojë për një mbyllje të mëpashme, me qëllim të ruhet integriteti i saj dhe të drejtpeshohet sistemi.

Vetëm liritë e papenguara komunikuese të qytetarëve, madje në aleancë me shkencën e teknikën, mund të arrijnë një drejtpeshim të forcave të mëdha, përmes të cilave integrohen shoqëritë moderne; mund të arrijnë një drejtpeshim të ri midis fuqisë së kapitalit dhe asaj administrative në njërën anë dhe solidaritetit qytetar në anën tjetër (Habermas, 2005a: 120).

Pas rënies së Murit të Berlinit, globalizimi përfaqëson për Habermasin një çarje të madhe të solidaritetit që kishte krijuar shteti kombëtar. Ai globalizimin e shpjegon si zmadhimin e shtrirjes së marrëdhënieve të shkëmbimit ekonomik dhe të komunikimit. Në radhë të parë ky është një shndërrim teknologjik, sepse, sikurse në shek. XIX hekurudha, anija me avull dhe telegrafi shpejtuan dhe shpeshantuan trafikun e mallrave, personave dhe informacionit, po kështu në shek. XX teknologjia satelitore, udhëtimi ajror dhe komunikimi i dixhitalizuar kanë zgjeruar rrjetet e qarkullimit të mallrave, parasë, njerëzve dhe informacionit. Më specifikisht, në aspektin ekonomik, globalizimi ka të bëjë me shpeshimin e tregtimit të mallrave industrialë midis shteteve, me

rritjen e ndikimit të korporatave transkombëtare, me rritjen e shpejtësisë së qarkullimit të kapitalit me anë të rrjeteve elektronike dhe, për pasojë, me autonominë e proceseve financiare, që kështu shkëputen nga ekonomia reale (Habermas, 2001a: 66). Ritmet e larta të lëvizshmërisë së njerëzve kanë bërë që të ndryshojë struktura kulturore e shteteve kombëtarë, aq sa “të gjithë kombet evropiane sot e gjejnë veten në rrugën drejt shoqërisë shumëkulturore” (po aty: 73). Në kushtet e reja shteti kombëtar nuk është më i aftë të sigurojë solidaritetin e nevojshëm shoqëror. Sipas Habermasit, shteti kombëtar u shfaq nga kriza e legjitimitetit dhe integritetit që pësoi shoqëria e vjetër feudale gjatë proceseve të modernizimit. Arritja e shtetit kombëtar ishte pikërisht integrimi i individëve të atomizuar nga moderniteti dhe legjitimiteti i politikës me anë të idesë së kombit (Habermas, 1998: 111). Proceset e tanishme globalizuese po e dobësojnë rolin e tij, sepse ai nuk është më homogjen nga brenda dhe sovran në marrëdhëniet me jashtë. Komunikimi i qytetarëve në sferën publike dhe procedurat demokratike të shtetit kombëtar nuk kanë kontroll mbi dinamikat globale.

Shteti kombëtar dikur përfaqësonte një përgjigje bindëse ndaj sfidës historike për të gjetur një ekuivalente funksionale për formën e hershme moderne të integritetit shoqëror, e cila ishte në procesin e shpërbërjes. Sot ne po përballemi me një sfidë analoge. Globalizimi i tregtisë dhe i komunikimit, i prodhimit ekonomik dhe financës, i përhapjes së teknologjisë dhe armëve dhe, mbi të gjitha, i risqeve ekologjike dhe ushtarake, parashtron probleme që nuk mund të zgjidhen më brenda kuadrin të shtetit kombëtar, me metodën tradicionale të marrëveshjeve midis shteteve sovranë (po aty: 106).

Në mënyrë të përmbledhur, sipas Habermasit, ne ndodhemi në një fazë paskombëtare, në të cilën shteti kombëtar nuk mundet të ushtrojë funksionet e tij klasike: paqen e brendshme dhe mbrojtjen e kufijve së jashtmi, kushtëzimin e ekonomisë kombëtare, ruajtjen e standardit të jetesës me anë të politikave të rishpërndarjes, ruajtjen të drejtave të individëve dhe krijimin e kushteve për realizimin e tyre (Pensky, 2001: xiii). Grupet shoqërore të varfra dhe të përjashtuar nga shoqëria e konsumit nuk po mundin të përmirësojnë kushtet e tyre dhe në afat të gjatë kjo çon në humbjen e solidaritetit shoqëror dhe të shkatërrimit të kulturës politike liberale, mbi universalitetin e të cilës bazohet demokracia (Habermas, 2001a: 50-51). Me terminologjinë e Habermasit, po ndodh një hapje e botës së jetës, e cila ka nevojë për një “mbyllje” të mëtejme që të funksionojë.

Përhapja e rrjeteve të shkëmbimit për mallrat, paranë, njerëzit dhe informacionin, kërkon një nivel të lartë të lëvizshmërisë. Në krahun tjetër,

horizontet hapësinore dhe kohore të botës së jetës, sado që të shtrihen, gjithmonë formojnë një të tërë, që është intuitivisht e pranishme, por gjithmonë e tërhequr në një sfond joproblematic; një e tërë që është e mbyllur në kuptimin që përmban çdo ndërveprim të mundshëm prej perspektivës së pjesëmarrësve në botën e jetës... Me çdo impuls drejt modernitetit, botët e jetës të bashkëndara në mënyrë ndërsubjektive hapen, në mënyrë që të riorganizohen dhe pastaj mbyllen sërish (po aty: 82-83).

Sipas Habermasit, ekzistojnë së paku pesë probleme të mëdha për të cilat tashmë është e nevojshme një qeverisje paskombëtare. Këto janë: kërcënimet ndaj sigurisë ndërkombëtare, rreziqet ekologjike, shpërndarja e shpërpjesëtuara e burimeve energjetike në botë, moszbatimi në të gjithë botën i të drejtave themelore të njeriut dhe mungesa e një rendi të drejtë ekonomik, i cili të mund të plotësojë nevojat jetike në mbarë botën, përtej asaj që mund të ofrojnë ndihmat *ad hoc* në raste katastrofash njerëzore (Habermas, 2011: 117). Nevojitet një “mbyllje” e re politike e kësaj çarjeje të madhe që po shkakton globalizimi, pra duhet globalizuar politika. Në fakt, në Evropë, Amerikë të Veriut dhe Azi po shfaqen forma të reja të organizimit të “regjimeve” kontinentale mbi nivelin e shtetit kombëtar dhe që mund të shërbejnë për të reformuar sistemin tashmë të paefektshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Projekti i Evropës së bashkuar

Habermasi beson se projekti në vazhdim i Bashkimit Evropian (BE) ia ka dalë mbanë që përmes politikave rishpërndarëse dhe subvencioneve të mënjanojë disa nga efektet e dëmshme të konkurrencës rajonale mes shteteve anëtare, prandaj BE-ja ofron një shans për një integrim politik, mbikombëtar dhe demokratik të shoqërive të kontinentit. Integrimi politik i kontinentit është i nevojshëm, sepse integrimi ekonomik i vetëm nuk mund të mobilizojë mbështetjen e masave: “alternativa ndaj abdikimit të politikës do të ishte ndjekja e rrugës për aty ku na drejton tregu, duke ndërtuar agjenci politike mbikombëtare. Një shembull i përshtatshëm është Evropa në tranzicionin drejt Bashkimit Evropian” (Habermas, 1998: 123). Vendimi për të mbështetur ruajtjen e një niveli të përgjithshëm të mirëqenies varet nga konceptet e drejtësisë shpërndarëse dhe, parë nga ky këndvështrim, projekti evropian është “një përpjekje e përbashkët e qeverive kombëtare për të rigjetur në Bruksel aftësinë për të ndërhyrë [në treg], të cilën e kanë humbur në vendet e tyre” (Habermas, 2001a: 14).

Zgjidhja politike e sfidës së globalizimit me anë të BE-së duhet bërë në atë mënyrë që të mos rrezikojë arritjet e realizuara nga shteti kombëtar, mbi të gjitha demokracinë. Brenda kuadrit të shtetit kombëtar liberal, pjesëmarrja demokratike e qytetarëve ka gjeneruar një solidaritet të bazuar në ligj, i cili është legjitimuesi i ekzistencës së vetë shtetit (Habermas, 1998: 112). Kjo është një arritje e shtetit kombëtar që duhet ruajtur në kushtet e reja të krijuara:

Sfida para nesh nuk është detyra që të *shpikim* diçka të re, por të ruajmë arritjet e mëdha demokratike të shtetit kombëtar evropian përtej kufijve të tij. Këto arritje përfshijnë jo vetëm garancitë formale të të drejtave qytetare, por edhe nivele të mirëqenies shoqërore, arsimit dhe kohës së lirë që janë parakusht si i autonomisë private, po ashtu edhe i qytetarisë demokratike (Habermas, 2001b: 6; kursivi në origjinal).

Efektet gërryese të globalizimit mund të përballohen vetëm nëse konstelacioni paskombëtar mund të zhvillojë forma të reja të vetorientimit demokratik, prandaj duhen testuar mundësitë për politikën demokratike përtej shtetit kombëtar dhe një shans të tillë e ofron BE-ja (Habermas, 2001a: 88).

Habermasi mendon që projekti i federatës evropiane, si shndërrim i mëtejshëm i sistemit ndërqeveritar të tanishëm të BE-së, është i mundur dhe i realizueshëm brenda traditës sociologjike të modernitetit evropiano-perëndimor. Për këtë duhet që të krijohet sfera publike evropiane, ku qytetaria evropiane të marrë po atë rol që ka qytetaria e shteteve kombëtare. Një solidaritet mbarevropian është i mundur të lëshojë rrënjë, sepse përderisa shteti kombëtar dikur përfaqësonte një integrim shtetëror dhe burokratik abstrakt përtej identiteteve vendore dhe dinastike, nuk ka arsye pse i njëjti proces të mos shtrihet edhe në një shkallë më të madhe se sa shteti kombëtar. Po me anë të atyre kushteve artificiale që krijuan vetëdijen kombëtare, mund të krijohet identiteti paskombëtar evropian dhe ato janë shoqëria civile evropiane, sfera publike mbarevropiane dhe kultura politike e bashkëndarë nga të gjithë qytetarët evropianë (Habermas, 2001b: 16).

Këtu duhet të sqarojmë se identiteti kombëtar i nënkuptuar nga Habermasi është ai civil dhe jo etnik: “një komb i qytetarëve nuk duhet ngatërruar me bashkësinë e fatit të formësuar nga prejardhja, gjuha dhe historia e përbashkët” (po aty: 15). Solidariteti kolektiv i kombit civil nuk është primordial, por vullnetarist, sepse ai lind nga procesi i komunimitit demokratik në sferën publike. Demokracia bën të mundur ndërtimin e legjitimitetit dhe kështu mbush çarjet që krijohen në integrimin shoqëror, duke gjeneruar një kulturë politike të përbashkët. Kultura politike e shtetit kombëtar, në qendër të së cilës qëndron respektimi i kushtetutës, dora-dorës shkëputet nga kultura e shumicës, duke

bërë të mundur që të gjithë qytetarët, pavarësisht nga prejardhja kombëtare apo etnike, të identifikohen me kulturën politike, proces të cilin Habermasi e quan “patriotizmi kushtetues” (Habermas, 2001a: 74). Patriotizmi kushtetues zëvendëson nacionalizmin etnik në kushtet e pluralizmit më të madh kulturor e fetar brenda shteteve evropiane. Ai nuk është statik, por një proces i vazhdueshëm i shqyrtimit të vlerave të një bashkësie të caktuar në dritën e normave universale.

Kultura politike e secilit prej shteteve të tanishme demokratike evropiane formohet nga interpretimi që secila traditë historike i bën parimeve universale të të drejtave të njeriut. Në vijim, edhe sfera publike mbarevropiane do të shfaqet si pasojë e hapjes së ndërsjellë të sferave publike kombëtare ndaj njëra-tjetrës, duke bërë të mundur komunikimin demokratik të qytetarëve evropianë dhe marrjen përsipër të përgjegjësive të përbashkëta. Ndërhyrja e rregullave të BE-së në rregullimin e jetesës së qytetarëve të vendeve anëtare dhe ndihmesa e ndërsjellë midis popujve evropianë ka nevojë për solidaritetin evropian dhe ky nuk mund të formohet pa një sferë publike dhe demokratike evropiane. Teza e hedhur se nuk mund të ketë një popull evropian është e vërtetë vetëm nëse populli kuptohet si një bashkësi parapolitike, anëtarët e së cilës besimin e ndërsjellë e lidhin me origjinën dhe fatin e përbashkët dhe me sakrificën që duhet të kryejnë ndaj bashkësisë. Mirëpo në një kulturë politike iluministe dhe demokratike, qytetarët e shohin veten si autorë të ligjit të cilit i binden dhe detyrimet lindin nga pajtimi i të drejtave të secilit me të drejta të barabarta për të gjithë (po aty: 98-101). Me fjalë të tjera, çështja nuk është identiteti evropian si i tillë, por krijimi i kushteve që të formohet solidariteti midis qytetarëve evropianë:

Në të vërtetë pyetjes a ka diçka të tillë që quhet identitet evropian sot duhet t’i përgjigjemi negativisht. Mirëpo, pyetja është parashtruar gabimisht. Bëhet fjalë për kushtet që duhet të plotësohen me qëllim që qytetarët solidaritetin e tyre qytetar të mund ta zgjerojnë tej kufijve ekzistues kombëtarë me synimin e një përfshirjeje të ndërsjellë (Habermas, 2005b: 83).

Procesi i bashkimit përfshin formimin e vullnetit të përbashkët demokratik në një nivel evropian. Për këtë arsye, si kusht të domosdoshëm të thellimit të integritetit politik të BE-së, Habermasi vendos miratimin e një kushtetute të Evropës federale. Kushteta do të legjitimojë institucionet politike evropiane dhe vendim-marrjen e përbashkët për taksat, politikat shoqërore, politikën e jashtme etj., që do t’i shkurajojnë vendet anëtare për të vepruar veçmas. Ai propozon që Parlamenti Evropian të funksionojë si një parlament normal, Komisioni të kthehet në qeveri, Këshilli i Ministrave të kthehet në

një dhomë të dytë të parlamentit dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë t'i zgjerohen kompetencat. Kjo do të thotë që një pjesë e mirë e sovranitetit të shteteve kombëtare do t'i kalojë federatës evropiane. Shtetet kombëtare do të ndërmarrin brenda tyre politika rregulluese që nuk bien ndesh me çështjet "e brendshme" të shteteve të tjerë (po aty: 100). Federata evropiane do të shmangë rrëshqitjen drejt nacionalizmit dhe përpjekjeve për hegjemoni të shteteve të veçantë brenda Evropës. Patriotizmi kushtetues do të respektojë larminë dhe integritetin e kulturave të ndryshme. Krijimi i një bashkësie solidariteti në vend të interesave partikulariste kombëtare, do t'i mundësojë Evropës që të flasë me një zë në arenën globale mbi problematikat ekonomike, ushtarake, mjedisore etj. (Müller-Dooch, 2010: 448-449). Gjithashtu, institucionet evropiane nuk mund të ekzistojnë pa sferën publike evropiane:

Nuk mund të ketë shtet federal evropian të denjë për titullin e demokracisë evropiane nëse brenda caktit të kulturës së përbashkët politike nuk zhvillohet një sferë publike mbarevropiane; një shoqëri civile që të përfshijë shoqata të grupeve të interesit, organizata ndërkombëtare, lëvizje të qytetarëve, etj. dhe sigurisht një sistem partiak të përshtatshëm për arenën evropiane. Shkurtimisht, sfera publike evropiane bën që komunikimi publik të kapërcejë kufijtë e sferave publike kombëtare (Habermas, 1998: 160).

Kuadri institucional i sferës publike evropiane krijon mundësinë e veprimit komunikues të qytetarëve evropianë, i cili nga ana e tij bën të mundur pranimin e vlerave të njëjta dhe rigjenerimin e botës së jetës ndërsujektive të evropianëve. Pra, evropianët mund të merren vesh me njëri-tjetrin mbi parimet dhe procedurat politike, edhe nëse kanë kultura të ndryshme kombëtare dhe etnike. Në këtë mënyrë, Habermasi propozon një njësi politike evropiane që nuk ka nevojë për "rrënjë shpirtërore", duke qenë se përkushtimet e qytetarëve nuk janë më të thella se sa standardet universale të të drejtave të njeriut, sigurisë vetjake dhe pjesëmarrjes demokratike (Turner, 2004: 308-309).

Habermasi bëri thirrje që Traktati Kushtetues të miratohej nga shtetet e BE-së dhe e quajti të rrezikshëm dështimin e tij në referendumet e Francës dhe Holandës. Ai vazhdon të ngulmojë që në parim procesi i integritetit më të ngushtë politik është pozitiv dhe se kjo rrugë nuk duhet të braktiset në shkëmbim të kompromiseve të përkohshme për t'i kënaqur të gjithë:

Nëse për hir të një paqeje të dyshimtë ne mënjanojmë këtë temë delikate [të ardhmen politike të Evropës] dhe çajmë përpara me të zakonshmet rrugë kompromisi, atëherë do të lemë të marrë udhët dinamika e tregjeve të çliruara dhe do të bëjmë sehir, ndërsa forca ekzistuese krijuese politike e BE-së të zhbëhet për llogari të një zone evropiane të zgjeruar e difuze të tregtisë së lirë.

Në procesin evropian të bashkimit gjendemi për të parën herë para rrezikut të rikthimit prapa nga niveli i arritur i integritimit (Habermas, 2006a: 151).

Habermasi nuk është i kënaqur që në vend të një kushtetute evropiane qeveritë bënë hapa mbrapa dhe miratuan Traktatin e Lisbonës. Sipas interpretimit që ai i bën këtij dokumenti, vendim-marrja evropiane mbetet sërish privilegj i qeverive, që me dyer të mbyllura do të vendosin ardhmërinë e Evropës. Gjithashtu kufizimi i kompetencave të Parlamentit të Evropës i bën qytetaët që ta shohin me skepricizëm këtë institucion dhe jo si një mekanizëm përfaqësimi të qytetarisë evropiane. Sfera publike në Evropë mbetet e mbyllur brenda kufijve të shtetit kombëtar dhe kjo ndikon te roli i dobët që ka Parlamenti Evropian (Habermas, 2011: 103).

Projekt normativ i Habermasit për Evropën e bashkuar është në pajtim me vizionin social-demokrat të modernitetit dhe me kritikën ndaj kapitalizmit (Habermas, 2001b: 12; Habermas, Michnik & Krzemiński, 1994: 24), të cilin e ndajnë edhe teoricienë të tjerë (p.sh. Balibar, 2009; Bauman, 2004; Delanty 1995; 2003; Vattimo, 2006). Filozofi bashkëkohor italian Xhano Vattimo [Gianno Vattimo], mendon se programi socialist duhet të njësohet me atë të integritimit evropian, sepse çështjet që shqetësojnë të majtën, si siguria, drejtësia, cilësia e jetës kolektive, ekologjia, karakteri imperialist i globalizimit etj., mund të formulohen brenda kërkesës për një bashkim të fortë evropian të frymëzuar nga vlerat e barazisë dhe të solidaritetit. Vlera e projektit evropian qëndron te realizimi për herë të parë në mënyrë demokratike dhe vullnetare të një bashkimi të madh politik, ndryshe nga “bashkimet” kombëtare dhe perandorake të së shkuarës (Vattimo, 2006: 119-120). Lidhur me këtë, Dahrendorfi vëren, me një dozë ironie, se Evropa e bashkuar është utopia më e fundit politike e së majtës evropiane, pikërisht po ai projekt i bashkimit të Evropës që dikur u përkiste kristian-demokratëve dhe që në kohë të ndryshme kundërshtohet nga socialistët në Gjermani, Francë dhe Britani të Madhe. Tani që BE-ja nuk është më dhe aq popullore në vendet që e themeluan atë, e majta e ka përqafuar projektin e bashkimit të Evropës në emër të utopisë për një të ardhme më të mirë (Dahrendorf, 2003: 110-111).

Projekti normativ evropian i Habermasit është i ndikuar nga situata politike e Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore. Mënyra se si ai formulon themelet e Evropës paskombëtare dhe të patriotizmit kushtetues, të kujton zgjidhjet që në të shkuarën ka ofruar për problemet e Gjermanisë së pasluftës. Me fjalë të tjera, Habermasi duket sikur projektin e Evropa marrëdhëniet midis politikës, ekonomisë, kulturës dhe ligjit në Gjermani (Turner, 2004: 294). Demokracia dhe tendenca drejt patriotizmi kushtetues u zhvillua në Republikën Federale

Gjermane, së cilës fuqitë pushtuese ia mohuan të drejtat e sovranitetit dhe i imponuan Ligjin Themeltar. Mposhtja e Gjermanisë më 1945 bëri që fati i Republikës Federale të lidhej me shtetet perëndimore dhe interesat kombëtare mund të avancoheshin vetëm në kuadrin e integritit evropian; ish-ministri i jashtëm i Gjermanisë, Hans-Ditrih Gensher, thoshte se “sa më evropiane të jetë politika jonë e jashtme, aq më kombëtare është ajo” (cit. po aty: 296). Gjithashtu, gjykimi i së shkuarës dhe i traditës gjermane, sidomos i periudhës naziste, nën dritën e parimeve universale ka shtruar rrugën e patriotizmit kushtetues gjerman, duke bërë që kultura politike t’i largohet nacionalizmit të gjakut dhe përkatësisë (Habermas & Michnik, 1994: 23).

Pas bashkimit të dy Gjermanive, Habermasi shqetësohej për rishfaqjen e vrullshme dhe të dhunshme të ksenofobisë e kundërsemitizmit. Ai nuk e miratonte faktin që thirrja e parë politike e gjermano-lindorëve më 1989, “Ne jemi populli” (gjer. “*Wir sind das Volk*”), e cila simbolizonte vullnetin e qytetarëve përballë diktaturës, shumë shpejt u kthye në thirrjen “Ne jemi një popull” (“*Wir sind ein Volk*”) (Habermas, Michnik & Krzemiński, 1994: 18). Shqetësimet e tij për normalizimin e identitetit kombëtar gjerman ai i ka transferuar në formulimin e patriotizmit kushtetues në nivelin evropian, i cili kërkon një shkëputje të qartë midis nacionalizmit qytetar dhe atij të përkatësisë së gjakut. Mirëpo, në shumë pjesë të Evropës, sidomos në anëtarët e rinj të BE-së nga ish-Evropa lindore nacionalizmi civil dhe ai etnik nuk mund të ndahen lehtë nga njëri-tjetri. Nëse integrimi evropian në pjesën perëndimore ka qenë i lidhur me dorëzimin vullnetar të funksioneve të sovranitetit të shteteve kombëtare të BE-ja, në pjesën ish-komuniste integrimi evropian është parë si një mënyrë për të pohuar lirinë dhe sovranitetin e shteteve të rinj të porsadalë nga hegjemonia sovjetike.

Rendi kozmopolit botëror

Projekti habermasian për federalizimin e Evropës artikullohet si pjesë e krijimit të një rendi kozmopolit në botë, të frymëzuar nga Kanti, rend të cilin Habermasi e përkufizon si “politikë të brendshme globale, por pa një qeveri botërore” (Habermas, 2006a: 6). Mund të ketë një kontradiktë midis projektit të hapur kozmopolitan kantian dhe “mbylljes” së Evropës së Bashkuar, por kjo mbyllje është e nevojshme si një zbatim pragmatist i idealit kantian, për sa kohë që nuk ekziston një bashkëpëlqim etik mbarëbotëror dhe demokratik.

Çdo bashkësi politike që dëshiron ta shohë veten si demokraci duhet të paktën që të dallojë anëtarët e saj nga joanëtarët... Edhe nëse një bashkësi e tillë

bazohet në parimet universale të një shteti demokratik kushtetues, ajo përsëri formon një identitet kolektiv, në kuptimin që i interpreton dhe i realizon ata parime nën dritën e historisë së vet dhe në kontekstin e formës së vet politike të jetës. Ky vetë-kuptim etiko-politik i qytetarëve për një jetë të caktuar politike mungon në bashkësinë gjithëpërfshirëve të qytetarëve të botës (Habermas, 2001a: 107).

Për realizimin e idealit kantian të një bote në paqe, Habermasi propozon që, krahas thellimit të integritetit politik të BE-së, të reformohen edhe institucionet ekzistuese ndërkombëtare, si p.sh. fuqizimi i funksioneve ekzekutive të OKB-së, për t'i dhënë mundësi kësaj organizate për të vepruar në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Që reformimi i OKB-së të jetë i efektshëm, nevojitet që shtetet kombëtare në zona të ndryshme të botës të integrohen në qeverisje të përbashkëta kontinentale, sipas shembullit të BE-së. OKB-ja dhe këto njësi kontinentale do të ndanin punën midis tyre dhe dora-dorës do të mund të arrihej te realizimi i përfundimit të qytetarëve në OKB, sipas shembullit të Parlamentit Evropian, që do të thoshte institucionalizim të qytetarisë së botës (Habermas & Mendieta, 2004). Gjatë luftës së NATO-s kundër ish-Jugosllavisë më 1999, Habermasi e përkrahte ndërhyrjen e armatosur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kundër sovranitetit të shtetit, mirëpo ai vërente një dallim midis qasjes evropiane dhe asaj amerikane:

Me evropianësh dhe amerikanësh... vihet re një ndryshim interesant në mënyrën e të kuptuarit të politikës së të drejtave të njeriut. Shtetet e Bashkuara e konsiderojnë realizimin global të të drejtave të njeriut si misionin kombëtar të një fuqie botërore që ndjek këtë objektiv sipas premisave të politikës së fuqisë. Ndërsa pjesa më e madhe e Bashkimit Evropian nënkupton me politikë të të drejtave të njeriut një projekt rregullimi ligjor tërësor të marrëdhënieve ndërkombëtare, një projekt që qysh sot ndryshon parametrat e politikës së fuqisë (Habermas, 2001c: 33).

Një fuqie të vetme nuk mund t'i besohet ruajtja e të drejtave të njeriut, edhe në qoftë kjo një fuqi demokratike si Amerika. Në pajtim me parimet demokratike, duhet që zbatuesit në shkallë globale të të drejtave të njeriut ta ndiejnë veten si autorë të tyre, prandaj nevojitet një rend global demokratik (po aty: 34). Është e domosdoshme që konsolidimi politik i BE-së t'i shërbejë këtij qëllimi, përndryshe thjesht krijimi i një superfuqie tjetër botërore nuk do të kishte vlerë:

Por nëse projekti federativ do të kishte për qëllim vetëm për të futur në lojë një tjetër lojtar global me fuqinë e SHBA-së, ai do të mbetej partikularist dhe thjesht do të pajiste me një përmasë të re ekonomike atë që në politikat e

emigrimit thirret “Fortesa e Evropës” (Habermas, 2006b: 88).

Duket qartë se Habermasi është kundër idesë së ndarjes së botës në hapësira të gjera të ndikimit sovran të një fuqie të madhe, diçka që ishte propozuar më parë nga juristi gjerman Karl Shmit [Carl Schmitt] për krijimin e *Mitteleuropa-s* rreth Gjermanisë dhe që pas vitit 1989 është përqafuar nga e djathta e re evropiane për të kundërshtuar njëpolarizimin liberal të botës (Habermas, 2005b: 208-209; shih më poshtë). Pikërisht këtu ai shikon një përcarje të madhe të Perëndimit: nga njëra anë Amerika me politikën e saj të fuqisë kombëtare dhe në krahun tjetër projekti evropian që udhëhiqet për nga zbatimi i normave ndërkombëtare. Habermasi mendon që edhe pse Amerika është e sigurtë për rrugën e saj të fuqisë për çastin dhe e shpërfill një rregullim ndërkombëtar ligjor, në afat të gjatë edhe asaj do t’i leverdiste që te fuqitë botërore të rrënjoset praktika e bindjes ndaj ligjit ndërkombëtar:

Një qeveri amerikane, e cila e mendon botën e ndryshuar të vitit 2030, nuk mund të dëshirojë që nesër Kina të silltet si Amerika e Bushit sot. Për më tepër, është në interesin e saj të përpiqet që fuqitë botërore të së nesërme t’i lidhë në një rend ndërkombëtar, i cili nuk do të ketë më nevojë për një superfuqi (Habermas, 2011: 127).

Në mënyrë që Amerika ta ndërmarrë këtë hap, ajo ka nevojë që edhe Evropa e bashkuar të ecë përkrah saj, gjë që do të thotë se “përcarja e Perëndimit” duhet kapërcyer. Prapëseprapë, veprimet e përbashkëta amerikano-evropiane në lidhje me mbështetjen e “Pranverës Arabe” nuk duket se shkojnë në këtë drejtim që përvijon Habermasi. Ndërsa është pozitive përkrahja që Perëndimi po i jep aspiratave popullore për demokraci dhe liri të popujve në Afrikë të Veriut dhe Lindje të Mesme, duket sikur veprimet ushtarake të NATO-s dhe vendeve të veçanta sërish janë të prira nga logjika e fuqisë dhe nga interesat e shteteve të veçantë për të zotëruar pasuritë e zonës (p.sh. naftën libiane). Në këtë mënyrë ato janë më shumë të shkaktuar nga ashpërsimi i konkurrencës prej krizës financiare botërore, sesa nga ndonjë plan i bashkërenduar i Perëndimit për përfshirjen e rajonit të Mesdheut brenda një rendi kozmopolit të paqes dhe të drejtësisë.

Evropa bërthamë?

Përkrahja që i dhanë pushtimit amerikan të Irakut më 2003 Britania e Madhe, Spanja, Italia dhe disa anëtarë të rinj dhe shtete që synojnë kandidimin në BE, të cilët u quajtën “Evropa e re” nga sekretari amerikan i mbrojtjes

Donald Ramsfeld, e shtynë Habermasin që të ndërmerre një veprim të njëkohshëm intelektual në disa shtete evropiane për të mobilizuar publikun pas projektit politik që ai dhe filozofi francez Zhak Derrida e quajtën “Evropa bërthamë”. Më 31 maj 2003 Habermasi dhe Derrida botuan një manifest në dy ndër gazetatat më të mëdha në Gjermani dhe Francë, së bashku me artikuj të intelektualëve të tjerë të njohur po atë ditë në gazeta të Italisë, Spanjës dhe Zvicrës. Thirrja e Habermasit dhe Derridas ishte për një politikë të jashtme të përbashkët të vendeve kryesore evropiane që ishin kundër luftës në Irak, të kryer në mospajtim me ligjet ndërkombëtare. Teksti i tyre është një ndihmesë për konstruktimin e sferës publike evropiane dhe të një bashkësie “të hollë” evropiane,. Këtë gjë Habermasi dhe Derrida tentojnë ta bëjnë duke artikuluar “vlerat e përbashkëta evropiane” përballë Amerikës si “tjetri” i tyre dhe e cila mishëron efektet negative të globalizimit.

Habermasi dhe Derrida e nisin manifestin duke përkujtuar tubimet e mëdha që u mbajtën më 15 shkurt 2003 në Londër, Romë, Madrid, Paris, Barcelonë dhe Berlin kundër luftës në Irak. Duke qenë se ata ishin tubimet më të mëdha që nga Lufta e Dytë Botërore, dy autorët thonë që mund të mbesin në histori si shenja të lindjes së sferës publike evropiane (Habermas & Derrida, 2005: 4). Shtetet bërthamë të BE-së, mbi të gjitha Franca dhe Gjermania, të cilat janë më të gatshme për ta pajisur BE-në me cilësitë e një shteti federal, duhet të ndjekin vullnetin e qytetarëve të shprehur në këta tubime dhe të hedhin hapin vendimtar për themelimin e politikave të përbashkëta të sigurisë, mbrojtjes dhe asaj të jashtme: “Bërthama pararojë e Evropës nuk duhet të mbyllet brenda një ‘Evrope të vogël’. Ajo duhet të jetë – siç ka qenë shpesh - lokomotiva” (po aty: 6). Është koha për artikulimin e identitetit evropian i cili do të shfaqet nga traditat historike dhe politike që kanë karakterizuar shtetet moderne evropiane. Sipas dy autorëve këta tradita janë: laiciteti dhe privatizimi i fesë; epërsia e demokracisë dhe e politikës ndaj tregut; ndjeshmëria e qytetarëve për paradokset e përparimit; skepticizmi ndaj teknologjisë; solidariteti shoqëror; kritika kundër totalitarizmave; dhe përkushtimi për paqen (po aty: 10-12). Habermasi më vonë e ka përsëritur idenë se politika e jashtme e përbashkët evropiane është “më pak nismë se sa një reaksion i lindur nga halli” (Habermas, 2005b: 60), sepse lufta e Irakut e ka bërë të domosdoshme ndarjen e BE-së nga varësia e Amerikës dhe se politika e jashtme e BE-së së bashku me atë të Amerikës, Kinës, Indisë dhe Japonisë mund të bëjë të mundur reformimin e institucioneve ekonomike ekzistuese ndërkombëtare, si edhe reformimin e OKB (Habermas, 2006a: 152-153).

Manifesti i Habermasit dhe Derridës ngjalli debate midis intelektualëve

në lidhje me marrëdhëniet Evropë-Amerikë. Në këtë rast në mendimin e Habermasit vihet re ndryshimi nga kërkimi i tij i mëparshëm për identitete racionale e kritike, te lavdërimi i modelit evropian, i cili konsiderohet si moralisht më i lartë se modelet joevropiane. Si “tjetri” i Evropës, Amerika paraqitet nga Habermasi si joracionale, që nuk i bindet ligjeve dhe sillet në mënyrë arbitrare, në kohën që “Evropa bërthamë” merr pamjen e botës më të mirë të mundshme, në të cilën ajo do të tërheqë edhe vendet e tjera anëtare të reja të BE-së (Heins, 2005; Parkin, 2009: 398-399). Ndaj kësaj kritike, d.m.th. për paraqitjen e “Evropës bërthamë” si etalon i Qytetërimit, Habermasi mbrohet me argumentin se në radhë të parë bëhet fjalë për një term teknik, përderisa Traktati i Nisës i vitit 2001 lejon për “bashkëpunimin e përforcuar” të atyre shteteve anëtare që duan të ecin më shpejt në thellimin e integritit politik se sa shtetet e tjera dhe se është një fakt se Gjermania, Franca, vendet e Beneluksit dhe Italia kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në ballë të procesit të integritit evropian. Në radhë të dytë, ka disa shtete brenda BE-së që duan të ruajnë hapësirën e tyre kombëtare të veprimit dhe janë më të interesuar për vendim-marrje ndër-qeveritare se sa për shtrirjen e sferës së veprimit të institucioneve mbikombëtare. “Evropa bërthamë” e merr kuptimin e saj si një përgjigje ndaj kësaj tendence (Habermas & Mendieta, 2004). Habermasi saktëson se një “Evropë të bërthamës dhe të periferisë natyrisht se vendet e tjera, të cilat parapëlqejnë që fillimisht të qëndrojnë mënjanë, do ta ruanin mundësinë për t’iu bashkangjitur në çdo kohë qendrës” (Habermas, 2011: 130).

Kritikët e Habermasit dhe Derridës kanë kundërshtuar edhe argumentin e përçarjes së Perëndimit, duke theksuar se Amerika dhe Evropa ndajnë të njëjtat tradita (Grimm, 2005: 100; Eehler, 2005). Amerika nuk është aq fetare dhe Evropa nuk është aq laike sa për t’i dalluar nga njëra-tjetra. Theksi mbi vlerat socialiste të Evropës lë jashtë shkollat neoliberalë evropiane, si ekonomia politike britanike dhe shkolla austriake e Mises dhe Hajekut (Kumar, 2008: 94-96). Për më tepër, vlerat e laicitetit, paqes, skepticizmit ndaj teknologjisë etj., tashmë kanë një shtrirje globale dhe nuk janë më veti vetëm e Evropës. Gjithashtu, brenda Evropës ka një larmi më të madhe kulturore se sa midis disa vendeve evropiane në njërën anë dhe Amerikës në anën tjetër. Prandaj, “përçarja e Perëndimit” do të jetë e përkohshme, se kemi të bëjmë me një “grindje familjare”, ngaqë të përbashkëtat peshojnë më shumë se sa gjërat që ndajnë dy brigjet e Atlantikut. Vërtet mund të thuhet se amerikanët janë nga Marsi dhe evropianët nga Venusi, por në fakt, në të kaluarën shtetet evropiane kanë qenë më të prira për luftë se sa Amerika dhe rendi i ri kantian i Evropës pas Luftës së Dytë Botërore ka lulëzuar nën mbrojtjen amerikane, e cila duke

ndjekur logjikën hobsiane e zgjidhi në shek. XX “çështjen gjermane” (Kagan, 2005: 94). Edhe pas rënies së Murit të Berlinit, prania ushtarake amerikane në Evropë është faktori kryesor për ruajtjen e paqes në Evropë. Gjithashtu, nën udhëheqjen e Amerikës, shtetet më të fuqishme evropiano-perëndimore po marrin pjesë në ruajtjen e rendit botëror dhe nuk e shohin njëri-tjetrin si konkurrentë për hegjemoni në kontinent (Mearsheimer, 2010). Vetë Habermasi pushtimin perëndimor të Gjermanisë më 1945, e sheh njëkohësisht si çlirim dhe ai e shikon Amerikën si një partner të BE-së për reformimin demokratik të sistemit të tanishëm ndërkombëtar. Në mbrojtje të Habermasit duhet thënë se kritikën e tij ndaj Amerikës janë empirike dhe jo ontologjike; ato shigjetojnë neoliberalizmin dhe unilateralizmit që janë përqafuar nga elita të tanishme politike e Amerikës, por që mund të ndryshojnë në të ardhmen.

Me gjithë vlerat që ka projekti habermasian për krijimin e një solidariteti politik evropian duke shmangur etnonacionalizmin, ai është kritikuar si jorealit, së paku porsa i përket situatës në Evropën Lindore. Aty rreziqet më të mëdha të shek. XX janë konsideruar dy totalitarizmat, komunizmi dhe nazizmi. Për pasojë, identiteti etno-kulturor e sovraniteti kombëtar gëzojnë prestigj të lartë, edhe në ato vende që tashmë janë pjesë e BE-së. Një kritik shprehet se, sikurse patriotizmi kushtetues i intelektualëve gjermanë doli jorealit në kohën e bashkimit të dy shteteve gjermanë, po ashtu ka gjasa që parashikimet e tyre se miratimi i kushtetutës së BE-së do ta thellojë edhe më bashkimin e anëtarëve të saj, të mos vërtetohen, e madje mund të vihet në rrezik vetë projekti evropian (Auer, 2010). Në fakt, jo vetëm në Evropën Lindore, por edhe në shtetet themeluese të BE-së forca politike dhe intelektualë vazhdojnë të kritikojnë projektin e tanishëm të BE-së dhe kanë ofruar modele alternative të solidaritetit evropian që bazohet pikërisht te identitetet etnike që Habermasi mundohet t’i shmangë.

Përfundime

Bashkimi i Evropës nuk është vetëm një projekt burokratik i cili drejtohet nga interesat e tregut të përbashkët dhe të shteteve anëtare. Te Bashkimi Evropian kanë varur shpresat e tyre edhe shumë intelektualë bashkëkohorë, të cilët e favorizojnë si një shans që po u jepet qytetarëve evropianë për të ndërtuar së bashku jo vetëm një ngrehinë burokratike, por edhe një sferë publike ku ata të ushtrojnë të drejtat e tyre si qytetarë të Evropës. Kjo do të jetë edhe baza për krijimin e një identiteti evropian. Ndër këta intelektualë, më i zëshmi në

këtë drejtim është filozofi dhe sociologu i njohur gjerman Jyrgen Habermas. Vizioni i tij për Evropën e bashkuar kërkon që integrimi nga sipër i elitave të shoqërohet edhe me hapjen e sferave publike kombëtare ndaj njëra-tjetres dhe me bashkëveprimin nga poshtë të një qytetarie evropiane. sikurse institucionet liberale dhe demokratike të shtetit kombëtar ushqehen nga opinioni publik dhe reagojnë ndaj tij, po ashtu institucionet e BE-së do të jenë ngrehina burokratike për sa kohë që nuk do të ketë një opinion publik të qytetarëve evropianë. Kjo mbetet një kritikë që Habermasi ia drejton BE-së edhe pas miratimit të Traktatit të Lisbonës dhe si një sfidë përpara Evropës së bashkuar në shek. XXI.

Projekti i Habermasit për Evropën e qytetarëve është një reagim ndaj situatës së tanishme ndërkombëtare, ku globalizimi ekonomik nuk është shoqëruar mjaftueshëm nga nisma racionale për ta kontrolluar atë. Ekzistenca e BE-së është e pamjaftueshme pa një bashkërendim të fuqive botërore dhe institucioneve ndërkombëtare. Mirëpo ky bashkërendim duhet të jetë njëkohësisht edhe një hapje e organizatave botërore ndaj mendimit dhe opinionit të qytetarëve. Forca tërheqëse e projektit habermasian qëndron pikërisht në faktin se ai integrimet evropiane nuk i sheh të izoluara nga zhvillimet në mbarë botën dhe se ai mendon se modeli i demokracisë dhe i qytetarisë perëndimore mund të aktualizohet edhe në pjesë të tjera të botës. Pavarësisht prej kritikave që i janë drejtuar, vizioni i Habermasit është për t'u marrë në konsideratë, si brenda Evropës dhe BE-së, po ashtu edhe në shkallë botërore nga ata që janë të interesuar për një llogaridhënie më të madhe të institucioneve ndërkombëtare dhe shteteve ndaj qytetarëve që ato i përfaqësojnë. Meditimet e Habermasit për Evropën e bashkuar mbeten shembull se si mendimi intelektual në kohën tonë është i angazhuar në mënyrë racionale e pragmatiste dhe jo thjesht utopike për të mirën e njerëzimit. Vepra e Habermasit është edhe një kujtesë për rolin e pazëvendësueshëm të intelektualëve publikë në atë që rëndom po e quajmë "era globale".

Bibliografia

- Auer, S. (2010) "New Europe': Between Cosmopolitan Dreams and Nationalist Nightmares", *Journal of Common Market Studies*, 48 (5): 1163-1184.
- Balibar, E. (2009) "Ideas of Europe: Civilization and Constitution", *Iris: European Journal of Philosophy and Public Debate*, 1 (1): 3-17.
- Bauman, Z. (2004) *Europe: An Unfinished Adventure*. Cambridge: University Press.
- Blühdorn, I. (1999) "Beyond Criticism and Crisis: On the Post-Critical Challenge

of Niklas Luhmann", *Debate: Journal of Contemporary Central and Eastern Europe*, 7 (2): 185-199.

Cronin, C & Pensky, M. (2006) "Editors' Preface", në Habermas, J., *Time of Transitions*. Cambridge: Polity.

Dahrendorf, R. (2003) "The Challenge for Democracy: Making Sense of the EU", *Journal of Democracy*, 14 (4): 101-114.

Delanty, G. (1995) *Inventing Europe: Idea, Identity, Reality*. London: Macmillan.

Delanty, G. (2003) "The Making of a Post-Western Europe: A Civilizational Analysis", *Thesis Eleven*, 72 (1): 8-25.

Finlayson, J. G. (2008) *Habermas: një hyrje e shkurtër*. Tiranë: Ideart.

Grimm, D. (2005) "A Great Innovation of Our Times: As a Worldwide Recognized Role Model, Europe Does Not Need a Constitution", në Levy, D., Pensky, M. & Torpey, J. (përg.) (2005) *Old Europe, New Europe, Core Europe: Transatlantic Relations After the Iraq War*. London; New York: Verso.

Habermas, J. (1998) *The Inclusion of the Other: Political Essays*. Cambridge (Mass): The MIT Press.

Habermas, J. (2001a) *The Postnational Constellation: Political Essays*. Cambridge (Mass): The MIT Press.

Habermas, J. (2001b) "Why Europe Needs a Constitution", *New Left Review*, 11: 5-26.

Habermas, J. (2001c) "Ruajtësit e rendit", në Lani, R., Mustafaj, B. & Misha, P. (përg.), *Lufta kundër luftës: intelektualë të shquar nga e gjithë bota rreth luftës në Kosovë*. Tiranë: Ora.

Habermas, J. (2005c) "Historia e botës nuk mund të kuptohet si një laborator për implementimin e një kuptimësie të qeniesimit të drejtuar nga filozofët!", në Salihu, A., *Pasmodernia e interpretuar për shqiptarët*. Prishtinë: Qendra për Studime Humanistike "Gani Bobi".

Habermas, J. (2005b) *Perëndimi i përçarë*. Shkup: Asdreni.

Habermas, J. (2006a) "Intuita avangardë për relevancat", *Polis*, 1: 144-153.

Habermas, J. (2006b) *Time of Transitions*. Cambridge: Polity.

Habermas, J. (2011) *Ah Evropë: përsiatje politike*. Shkup: Asdreni.

Habermas, J. & Derrida, J. (2005) "February 15, or, What Binds Europeans Together: Plea for a Common Foreign Policy, Beginning in Core Europe", në , D., Pensky, M. & Torpey, J. (përg.) (2005) *Old Europe, New Europe, Core Europe: Transatlantic Relations After the Iraq War*. London; New York: Verso.

Habermas, J. & Mendieta, E. (2004) "America and the World: a Conversation with Jurgen Habermas", *Logos* 3(3). Internet: www.logosjournal.com [Vizituar së fundi më 19.02.2010].

Habermas, J., Michnik, A. & Krzemiński, A. (1994) "Sot kemi më shumë përvuajtësi dhe më pak iluzione", *Përpjekja*, 1: 16-31.

Heins, V. (2005) "Orientalising America? Continental Intellectuals and the Search for Europe's Identity", *Millennium: Journal of International Studies*, 34 (2): 433-448.

Kagan, R. (2005) *Pushtet dhe parajsë: Amerika dhe Evropa në rendin e ri botëror*. Tiranë: Ideart.

Kumar, K. (2008) "The Question of European Identity: Europe in the American Mirror", *European Journal of Social Theory*, 11 (1): 87-105.

Mearsheimer, J. J. (2010) "Why Is Europe Peaceful Today?", *European Political Science*, 9: 387-397.

Müller-Doohm, S. (2010) "Nation State, Capitalism, Democracy: Philosophical and Political Motives in the Thought of Jürgen Habermas", *European Journal of Social Theory*, 13 (4): 443-457.

Parker, O. (2009) "Why EU, Which EU? Habermas and the Ethics of Postnational Politics in Europe", *Constellations*, 16 (3): 392-409.

Pensky, M. (2001) "Editor's Introduction", në Habermas, J. (2001) *The Postnational Constellation: Political Essays*. Cambridge (Mass): The MIT Press.

Turner, C. (2004) "Jurgen Habermas: European or German?", *European Journal of Political Theory*, 3 (3): 293-314.

Vattimo, G. (2006) *Nihilizmi dhe emancipimi*. Tiranë: Instituti i Studimeve Politike dhe Ligjore & Dita 2000.

Wehler, H. U. (2005) "Let the United States Be Strong! Europe Remains a Mid-Size Power: A Response to Jürgen Habermas", në Levy, D., Pensky, M. & Torpey, J. (përg.), (2005) *Old Europe, New Europe, Core Europe: Transatlantic Relations After the Iraq War*. London; New York: Verso.

GLOBALIZIMI SI FENOMEN DHE SI PROCES. GLOBALIZIMI DHE SFIDAT E ARSIMIT TË LARTË

Joana KOSHO

Universiteti Aleksandër Xhuvani

ABSTRACT

Even if many institutions or individuals define globalization in different ways, essentially it is a process that brings change, interaction and interdependence. Globalization with the new information technology is revolutionizing the goods and services, production, links and relations between states, cultural exchanges and cooperation in terms of education. There exists no community, which had remained unaffected by the effects of this revolution. The process of globalization is affecting the foundations of human relationships and social life. Nowadays it is important to discuss about 'knowledge society', when the world is rapidly changing through the information and communication technology (ICT). What are the effects of globalization and what is the importance of the knowledge society? What are the challenges of higher education in the context of competition and interdependence of a globalized society? These are some of the most important issues that will be discussed in this paper.

Keywords: Globalization, challenges, knowledge society, ICT, higher education

I. Globalizimi si fenomen dhe si proces

Globalizimi është një nga fenomenet më të diskutuara në ditët e sotme, për të cilin janë dhënë shumë përkufizime dhe janë ndezur debate nga më të ndryshmet. Nuk mund të gjejmë një sistem, organizëm apo politikë, e cila nuk është ndikuar apo transformuar nga kjo lëvizje, proces apo fenomen që quhet globalizim.

Në thelb globalizimi nënkupton një ndryshim, ndërlikohje, apo ndërvarësi në shkallë globale. E thënë më thjesht, globalizimi demonstroi sesi njerëzit në të gjithë botën janë ndërlikohur me njëri-tjetrin përmes konsumit të mallrave, shërbimeve dhe informacionit. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit i ka dhënë jetë krijimit të një 'fshati global', term i cili u emblemezua nga Marshall McLuhan në vitin 1962, që i referohet një shoqërie globale, ku informacionet qarkullojnë me shpejtësi marramendëse dhe ku rëndësia e kufijve ndërmjet shteteve dhe civilizimeve është reduktuar ndjeshëm.

Globalizimi konsiderohet një fenomen sepse është një fakt me të cilin përballemi në çdo vend, në çdo kohë. Globalizimi konsiderohet një proces sepse përfshin lëvizje, ndryshim të vazhdueshëm, transformim, evolucion dhe revolucion. Globalizimi si proces dhe si fenomen i korrespondon dy koncepteve shumë të rëndësishme "kompresimit [ngjeshjes] së kohës dhe hapësirës", si dhe "vetëdijes globale"¹. Proceset globalizuese ndikojnë tek dimensionet kohë dhe hapësirë duke i ngjeshur ato; kjo do të thotë që koha që duhet për të udhëtuar fizikisht dhe elektronikisht nga një pikë e hapësirës në tjetrën është zvogëluar ndjeshëm. Sot një lajm mësohet në çdo cep të botës në kohë reale dhe zhvillimi i teknologjisë së komunikimit ka zhdukur distancat përta i përket informimit. "Vetëdija globale" i referohet dukurisë së rritjes së interesimit dhe përfshirjes së njerëzve kudo në botë në diskutimin e ngjarjeve ndërkombëtare, si çështje të ekonomisë, politikës, medias, krizave dhe luftave, mjedisit dhe ngrohjes globale, kulturës dhe sportit, etj.

John Tomlinson në librin e tij "Globalizimi dhe kultura"² e përshkruan globalizimin si një ndërlikohje komplekse, kurse për Joseph Stiglitz³ globalizimi "është integrimi ndërmjet vendeve dhe popujve të botës [...] i nxitur nga reduktimi i kostos së transportit dhe komunikimit, si dhe nga rënia e barrierave artificiale ndaj lëvizjes së mallrave, shërbimeve, kapitalit, informacionit dhe njerëzve përtej kufijve."

Ekonomisti britanik, Phillipe Legrain, ka dhënë një shpjegim interesant mbi dobitë kulturore të globalizimit. "Bukuria e globalizimit," shkruan Legrain, "qëndron në faktin që ai mund t'i çlirojë njerëzit nga tirania e gjeografisë. Vetëm sepse dikush ka lindur në Francë nuk do të thotë se duhet patjetër të flasë frengjisht, të konsumojë ushqim francez, të lexojë libra francezë, të vizitojë muzeumet në Francë dhe gjëra si këto. Në këtë aspekt, një francez, apo një amerikan, mund t'i bëjë pushimet në Spanjë apo në Florida, të hajë sushi ose spageti për darkë, të pijë koka-kola apo verë kiliane, të shohë një film hollivudian apo të Almodovar-it, të dëgjojë bangra apo rrep, të praktikojë joga apo të bëjë boks, të lexojë revistën *Elle* apo *The Economist*, si dhe të ketë miq nga e gjithë bota."⁴

Të tjerë studjues kanë dhënë përkufizimet e tyre mbi globalizimin, duke u fokusuar në ndikimet pozitive apo negative të këtij procesi gjithëpërfshirës. Daniel Griswold, i institutit Cato, bën një lidhje mes progresit ekonomik dhe konsolidimit të lirisë, të drejtave të njeriut dhe demokracisë në vendet e ndikuara më shumë nga globalizimi. Louise Shelley, një profesoreshë e marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin George Mason në SHBA, ekzaminon efektet negative të globalizimit, që sipas saj, duke zvogëluar vlerën e kufijve dhe përmes teknologjisë së avancuar mund të krijojë lehtësi edhe për rrjetet e kriminelëve dhe terroristëve.⁵

Debati mbi impaktin e globalizimit, mbi dobitë dhe dëmet e tij vazhdon... Studjuesit bien dakort që globalizimi ka nxitur zhvillimin dhe ka rritur mirëqenien, por megjithatë, duhet pranuar se ndërlikshmëria e nxitur nga globalizimi krijon lehtësi edhe për rrjetet e terroristëve dhe trafikantëve, ndërkohë që ndotja e mjedisit dhe ngrohja globale kanë arritur në nivele shqetësuese.

II. Globalizimi dhe shoqëria e dijes

Termi 'shoqëria e dijes' i referohet kryesisht një komuniteti ku njohuria është faktor kryesor i zhvillimit, më i rëndësishëm se kapitali apo puna. Ne mund ta përcaktojmë një shoqëri të dijes duke iu referuar konceptit 'shoqëri e informacionit': Një lloj i ri shoqërie, në të cilën njerëzit kanë mundësinë të ndërtojnë një jetë më të mirë, një standard më të lartë jetese dhe një vend më të rëndësishëm në shoqëri, falë përdorimit global të teknologjive të informacionit dhe komunikimit.⁶ Informacioni është rezultati i kodifikuar i vëzhgimit, kurse dija përfshin aftësinë për të vepruar.⁷


Koncepti i 'shoqërisë së dijes' përfshin dimensionin e ndryshimeve sociale, kulturore, ekonomike, politike dhe institucionale, si dhe një perspektivë më pluraliste zhvillimi.⁸ UNESCO argumenton se kalimi nga shoqëria e informacionit në shoqërinë e dijes kërkon që 'përdorimi i teknologjisë së komunikimit dhe informacionit të kryhet me vetëdijen se dija është forca parësore e dimensioneve të zhvillimit social, politik, kultural dhe institucional, bazuar tek të drejtat e njeriut.⁹ Pra shoqëria e dijes është e orientuar drejt: demokratizimit, globalizimit dhe universalizimit të dijes.

Globalizimi, si një proces që çliron tregjet dhe komunikimin ndërnjerëzor nga kufijtë dhe barrierat kombëtare, krijon terrenin e favorshëm për zhvillimin e shoqërive të dijes. Anëtarët e kësaj shoqërie kanë arritur një standard arsimimi

më të lartë se sa në shoqëritë e tjera, të cilat nuk kanë si faktor kryesor për zhvillim informacionin dhe dijen. Profesionet më të përhapura në këto shoqëri janë: studjues, shkencëtarë, specialistë të informacionit, menaxherë njohurish, etj.

Shoqëria e dijes është e ndërtuar nga tre shtylla kryesore¹⁰, të cilat paraqiten në figurën e mëposhtme.

Figura 1: Shtyllat e shoqërisë së dijes



Shtylla e parë e shoqërisë së dijes është arsimit. Përse i përket arsimit, të mësuarit gjatë gjithë jetës është konsideruar si një kërkesë për të mbajtur konstante ritmin e ndryshueshmërisë të tregjeve globale të punës dhe teknologjive. Në fushën e arsimit të lartë, krijimi i dijes është sfida më e rëndësishme me të cilën përballen universitetet. Në botën e sotme, studentët e gjejnë veten në një shoqëri që është duke u bërë gjithnjë e më shumë e teknologjizuar. Të ballafaquar me këtë realitet, institucionet e arsimit të lartë nuk kanë tjetër zgjedhje veçse të analizojnë ‘prodhimin’ dhe ‘produktet’ e tyre, për të kuptuar se çfarë janë në gjendje ato t’i ofrojnë shoqërisë.¹¹

Shtylla e dytë e shoqërisë së dijes është teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (Information and communications technologies - ICTs), që shërben për të komunikuar, krijuar, menaxhuar dhe shpërndarë informacion. Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit përfshin kompjuterët, Internetin, telefonët, televizionin, dixhitalizimin, etj.

Inovacioni, shtylla e tretë e shoqërisë së dijes, shihet si një mbështetës i zhvillimit dhe i funksionimit të ekonomisë. Inovacioni konsiderohet si një proces i krijimit, shkëmbimit, evolucionit dhe aplikimit të njohurive (dijes) për të prodhuar mallra dhe për të ofruar shërbime, si dhe për zhvillimin e shoqërisë në tërësi.

Në shoqërinë e dijes, edukimi, teknologjia dhe inovacioni aplikohen optimalisht për të sjellë rritje ekonomike dhe mirëqenie. Në këto shoqëri:¹²

- Mundësitë individuale rriten, ndikuar nga konsolidimi i sistemit arsimor;
- Qasja ndaj globalizimit është e lartë, duke rritur konkurueshmërinë mes tregjeve dhe institucioneve në rang global dhe duke rritur si pasojë cilësinë e mallrave dhe shërbimeve;
- Bashkëpunimi është një strategji e rëndësishme për organizatat dhe ndër marrjet, në tregjet dhe në shoqëritë me nivel të lartë të integritimit dhe të ndërvarësisë.

Pra, gjithnjë e më shumë, vendet në të gjithë botën po pranojnë vizionin e zhvillimit të shoqërive të dijes, duke përshtatur politika dhe strategji të cilat inkurajojnë këtë projekt ambicioz. Arsimi është me rëndësi vitale për shoqërinë e dijes, si një burim i aftësive bazë, si themel për zhvillimin e njohurive të reja dhe të inovacionit dhe si një motor për zhvillimin socio-ekonomik. Pra, arsimi është një kërkesë jetike në krijimin e shoqërive të dijes që mund të stimulojë zhvillimin, rritjen ekonomike dhe prosperitetin. Arsimi nuk është vetëm një mjet përmes të cilit individët kthehen në pjesëmarrës të kualifikuar në socio-ekonominë, por është gjithashtu dhe një çelës kryesor për aplikimin e plotë dhe efikas të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Po vendi ynë, në çfarë stadi është përsa i përket shtyllave të shoqërisë së dijes? Sa investon shoqëria jonë për zhvillimin teknologjik, për inovacionin dhe arsimin e lartë? Në librin e tij "Globalizimi... ante portas", ekonomisti Adrian Civici, duke iu referuar statistikave të realitetit shqiptar, evidenton se: përqindja e shpenzimeve për kërkim-zhvillim teknologjik është ende mjaft e vogël dhe pothuajse pa asnjë efekt në zhvillimin ekonomik të vendit; ... klasifikohemi shumë poshtë në treguesit e leximit, në kontaktet me informacionet e reja tekniko-shkencore, në botimet ose në përdorimin e librave për 1000 banorë; kemi numër dhe tirazh revistash shkencore për 1000 banorë mjaft të ulët dhe shumë më të vogël se pjesa dërrmuese e vendeve në zhvillim. Gjithashtu, sipas Ministrisë së Arsimit dhe UNICEF, me një mesatare prej 8.6 vitesh shkollimi rezulton se ne arsimohemi 6 vjet më pak se evropianët; vetëm 50% e të rinjve frekuentojnë arsimin e mesëm, ndërkohë që arsimi i lartë frekuentohet vetëm nga 13% e tyre.¹³

III. Globalizimi dhe arsimit i lartë: ndikimet dhe sfidat

Globalizimi përmes zhvillimeve të reja në shkencë dhe teknologji, në evolucionin mediatik dhe dixhital, po shndërron sistemin arsimor dhe konkretisht arsimin e lartë. Ne jemi dëshmitarë të ndryshimeve që po pësojnë paradigmat e arsimit të lartë, nga 'kombëtare' në 'globale', nga 'arsimim i përgjithshëm' në 'sistem arsimor i përshtatur kërkesave të tregut', nga 'arsim elitari' në 'arsimim gjatë gjithë jetës për të gjithë', nga 'mësimdhënie me në qendër mësuesin (pedagogun)' në 'mësimdhënie me në qendër nxënësin (studentin)'. Këto ndryshime sjellin kërkesa dhe krijojnë sfida të reja për sistemet e arsimit të lartë.

Cilat janë sfidat e arsimit të lartë në kuadër të procesit të globalizimit?


1. Masivizimi i arsimit të lartë

Globalizimi ka rritur kërkesën për informacion dhe dije, duke e kthyer arsimin e lartë nga një 'arsim elitari'; në një 'arsim masiv'. Në vitet '60 - '70 të shekullit të kaluar përqindja e të rinjve të moshës 18 - 22 vjeç që ndiqnin universitetet nuk e kalonte 8%, ndërsa sot në të gjithë vende e BE-së kjo shifër varion në nivelet 35 - 40%.¹⁴

Dukuria e masivizimit lidhet dhe me fenomenin e krijimit të universiteteve private. Për të përballuar fluksin e kërkesave për të ndjekur studimet e larta, sistemi kombëtar arsimor i dha dritën jeshile sektorit privat, i cili po konkuron ndjeshëm atë publik.

Përsa i përket vendit tonë, në periudhën 2003 - 2011 arsimit i lartë është karakterizuar kryesisht nga masivizimi. Nëse do të krahasohej me periudhën e mëparshme, mund të vërehet fare lehtë hovi që ka marrë numri i të regjistruarve nëpër universitete. Që në vitin shkollor 2003-2004 bie në sy ritmi rritës më i lartë se në çdo periudhë më të hershme. Në këtë vit u regjistruan 22% më shumë studentë se një vit më parë. Edhe në vitet që pasuan, deri në 2007-n, ritmi ishte i lartë. Në vitet 2007-2008 dhe 2008-2009, rritja ra në nivelet 5% dhe 3%, ndërkohë që viti 2009-2010 shënoi bumin e studentëve që u ulën nëpër auditore, me 25% më shumë se sa një vit më parë dhe 3.1 herë më shumë se sa në vitin 1994-1995.¹⁵

Figura 2. Numri i studentëve të regjistruar në universitetet shqiptare (burimi: Open Data Albania)



2. Mobiliteti akademik

Lëvizshmëria akademike, pra mobiliteti i studentëve përtej kufijve shtetërorë apo kombëtarë, është një nga ndikimet më të dukshme të globalizimit dhe një nga sfidat e arsimit të lartë në çdo vend të botës. Sot ekziston një treg global i mirëfilltë për studentët dhe stafet akademike, ku më shumë se 2.5 milionë studentë studjojnë jashtë kufijve të vendit amë.¹⁶

Universitetet dhe vetë sistemet akademike kanë zhvilluar shumë strategji për të përfituar nga mjedisi i ri global dhe për të tërhequr studentë jorezidentë. Disa universitete të shteteve jo-anglishtfolëse, kanë ndërtuar programe akademike në anglisht për të tërhequr studentë nga vende të tjera, si dhe kanë krijuar partneritete me institucione akademike në shtete të tjera (kryesisht perëndimore, ose anglishtfolëse), për t'i krijuar një terren sa më të favorshëm trendit të kohës: mobilitetit të studentëve. Degë të reja kampusesh, programe konkurruese akademike dhe bashkëpunime për marrjen e gradave shkencore me universitete përtej kufijve, janë manifestimet e disa prej objektivave të sistemeve të arsimit të lartë kudo në botë, përsa i përket lëvizshmërisë akademike.

Mobiliteti i studentëve në vendin tonë zhvillohet kryesisht në kuadër të programit TEMPUS dhe Erasmus Mundus. Përsa i përket partneriteteve

në fushën e arsimit të lartë, programi TEMPUS nxit institucionet e Vendeve Anëtare të BE dhe vendeve partnere të përfshihen në bashkëpunimin e strukturuar përmes ngritjes së “konsorciumeve”. Gjithashtu, TEMPUS ofron grante të mobilitetit individual duke ndihmuar personat e angazhuar në sektorin e arsimit të lartë të ushtrojnë veprimtari të caktuara në vende të tjera. Programi Erasmus Mundus u krijua në vitet 2009 – 2013 për forcimin e cilësisë së arsimit të lartë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe promovimin e mirëkuptimit kulturor përmes bashkëpunimit me vendet e treta.¹⁷

3. Cilësia e arsimit të lartë

Një nga impaktet më kryesore dhe më sfiduese të globalizimit tek arsimi i lartë është presioni për të rritur cilësinë e shkollimit. Institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin studentë të aftë për t'u përshtatur dhe për të konkurruar në një botë më komplekse dhe më të ndërvarur. Globalizimi, integrimi rajonal dhe lëvizshmëria gjithnjë në rritje e studentëve dhe akademikëve, e ka bërë më urgjente kërkesën për njohje ndërkombëtare të standardeve të shkollimit. Rritja shpërthyes e universiteteve private përveç tyre tradicionale, ngre pyetje të reja mbi standardet e cilësisë. Natyrisht që konsumatorët e arsimit të lartë (studentët, prindërit që financojnë studimet e tyre, etj) po kërkojnë një lloj ‘certifikimi cilësie’ për institucionet e arsimit të lartë dhe për kualifikimin që ato ofrojnë.¹⁸

Për vlerësimin e cilësisë së programeve dhe universiteteve shqiptare, është krijuar sistemi i akreditimit me dy përbërës të rëndësishëm: Agjensia Publike e Akreditimit për Arsimin e Lartë (APAAL) dhe Këshilli për Akreditimin. Ky sistem kontrollon dhe organizon sigurimin e cilësisë përmes dy proceseve: vlerësimit dhe akreditimit.

Bazuar në të dhënat e faqes zyrtare të Agjensisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë, aktualisht në gjithë vendin veprojnë 39 IJPAL (Institucione Jopublike të Arsimit të Lartë). Sipas të dhënave nga MASH, numri i akredituar i tyre vazhdon të jetë 14. Kjo do të thotë se rreth 65% e universiteteve private janë ende të paakredituara. Brenda këtij grupi përfshihen përgjithësisht universitetet që kanë filluar punë pas vitit 2009. (Open Data Albania)




Figura 3. Akreditimi i Universiteteve Jopublike¹⁹

IJPAL-të operojnë në total me 229 programe studimi të ndryshme, si Bachelor, Master Shkencor, MNP, MND, etj, të cilat janë nivele të ndryshme diplomash. Në bazë të ligjit të Arsimit të Lartë, çdo institucion i arsimit të lartë apo program studimi në arsimin e lartë publik dhe privat, i nënshtrohet procesit të akreditimit. Akreditimi i jep të drejtën një institucioni publik ose privat të arsimit të lartë të lëshojë diploma të njohura në Republikën e Shqipërisë.




Figura 4. Akreditimi i programe të Universiteteve Jopublike (Open Data Albania)

Siç duket dhe nga grafiku, pjesa më e madhe e programeve të studimit në arsimin e lartë privat janë të pa akredituara (rreth 60% apo 192 prej tyre). Problem akoma më i madh janë programet të “Palicencuara dhe të paakredituara”, pra programe që nuk kanë marrë as lejen fillestare për fillimin e aktivitetit.

Për të vlerësuar cilësinë e universiteteve dhe si pasojë për të përcaktuar konkurueshmërinë e tyre, bëhet rankimi i tyre. Ky proces renditje ka si qëllim kryesor informimin e plotë të studentëve për ofertën në sistemin e arsimit të lartë. Rendiça ofron një gamë të gjerë treguesish që e ndihmojnë studentin të zgjedhë shkollën e lartë. Në korrik të vitit 2011 dolën rezultatet e rankimit të parë të universiteteve shqiptare. Institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat u vlerësuan përsa i përket elementëve të tillë si: kualifikimi i personelit, cilësia e mësimdhënies, ambjentet akomoduese, raporti pedagog/student, treguesi i punësueshmërisë, orientimi ndërkombëtar, etj.²⁰

4. Shanse të barabarta shkollimi

Konsiderohet si një tjetër sfidë për arsimin e lartë ‘barazimi i shanseve për gjithësecilin për të ndjekur universitetin’. Dhe kjo çështje nuk i sfidon universitetet vetëm në rrafshin kombëtar, por dhe në rang ndërkombëtar. Studentët dhe akademikët të cilët kanë avantazhe dhe mundësi të mira në një mjedis global kompleks të arsimit të lartë, konsiderohen si njerëz të privilegjuar, kur kërkesa për *shanse të barabarta* duket se është akoma larg realizimit.

Megjithatë, filozofia e kësaj kërkesë mund të konkretizohet me praktika të tilla si: sistemi i bursave, ndihma sociale dhe ekonomike, angazhimi i biznesit, pagesa private individuale, etj.²¹

5. Financimi i arsimit të lartë

Një çështje jo pak problematike është financimi i arsimit të lartë. Masivizimi i arsimit të lartë dhe rritja e kërkesave për cilësi e për shanse të barabarta, ndikon në pamjaftueshmërinë e burimeve publike. Kjo pamjaftueshmëri tashmë është duke krijuar një dilemë globale, sesi do mundën universitetet publike të vetëfinancohen.

Kur privati pothuajse e ka të zgjidhur çështjen e financimit, problemet përqendrohen tek universitetet publike, të cilat përballen me shqetësime të tilla si: problemi i pagave të stafit akademik, zhvillimi i infrastrukturës dhe mbi të

gjitha autonomia reale që ka munguar gjatë gjithë historisë së universiteteve publike.

Përsa i përket standardeve që vendi ynë duhet të plotësojë si kusht për integrim në BE, Shqipëria është ndër vendet e fundit në rajon për përqindjen e buxhetit të arsimit kundrejt PBB-së. Me trendin zbritës që ka marrë ky tregues vitet e fundit për Shqipërinë, duke shkuar në 2.8% për 2011-ën,²² mund të thuhet se arritja e standarteve të BE-së mbetet ende larg, kur mesatarja e shpenzimeve për arsimin sipas kriterëve të BE-së duhet të jetë jo më pak se 5.1%. (Open Data Albania) E njëjta shifër, 2.8% e PBB-së, është përcaktuar për arsimin e lartë dhe për vitin 2012, në projektbuxhetin e këtij viti.²³

6. Kohezioni social

Një influencë globale dhe njëkohësisht një sfidë tjetër e arsimit të lartë që duhet përmendur është pozicionimi që duhet të kenë dhe kontributi që duhet të japin universitetet përsa i përket kohezionit social kombëtar. Si arsimit i lartë publik dhe ai privat duhen të ruajnë një rol vendimtar për të bërë të mundur që të diplomuarit e tyre të jenë teknikisht në gjendje të operojnë në tregun e punës sipas pritshmërive dhe që qytetarët të jetojnë në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin dhe me fqinjët e tyre.

Stephen P. Heyneman, specialist për çështjet e arsimit në rang global, në artikullin e tij "Global Issues in Higher Education", rekomandon që universitetet, përveç qëllimit primar të tyre që është mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, të influencojnë kohezionin social me anën e dy mekanizmave. Së pari, përmes cilësisë së kurrikulumeve dhe profesionalizmit në mësimdhënie. Universitetet e afirmuara njihen për lehtësinë dhe disponibilitetin që kanë studentët për t'u konsultuar falas me literaturë, informacion dhe kontakte nga e gjithë bota. Mekanizmi i dytë konsiston në aftësinë e universiteteve për të rrënjosur tek studentët sjelljen etike dhe standardet e larta akademike dhe profesionale.²⁴

IV. Konkluzione

Globalizimi është konsideruar si një fenomen kompleks dhe si një proces gjithëpërfshirës, impakti i të cilit prek çdo shoqëri, politikë, ekonomi, apo individ në të gjithë botën. Globalizimi në thelb konsiston në rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe global, ndërveprimet të tregjeve, shkëmbimit

kulturore dhe ndërvarësisë politike, ekonomike dhe sociale. Rënia e barrierave të komunikimit, integrimi, rritja e konkurrencës në shkallë globale, si dhe informimi në kohë reale në çdo cep të botës, janë disa nga karakteristikat më të dukshme të globalizimit.

Në aspektin social, procesi gjithëpërfshirës i ndërveprimit, ndërvarësisë dhe bashkëpunimit, ka nxitur krijimin dhe konsolidimin e shoqërisë së informacionit dhe të dijes. Anëtarët e kësaj shoqërie e vlerësojnë dijen dhe informacionin si një faktor zhvillimi, duke e renditur më parësor se burimet e tjera si puna, apo kapitali. Shoqëria e dijes mbështetet në tre shtylla kryesore, që janë: arsimi, teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (ICT) dhe inovacioni. Teknologjia e informimit dhe e komunikimit konsiderohet si çelësi kryesor për stadin më të lartë evolutiv social: shoqërinë e dijes.

Arsimi dhe konkretisht arsimi i lartë, është një faktor përcaktues për zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe social. Globalizimi përmes zhvillimeve të reja në shkencë dhe teknologji, në evolucionin mediatik dhe dixhital, po e shndërron sistemin e arsimit të lartë në rrafsh global. Paradigmat e arsimit të lartë janë transformuar nga 'kombëtare' në 'globale', nga 'arsimim i përgjithshëm' në 'sistem arsimor i përshtatur kërkesave të tregut', nga 'arsim elitare' në 'arsimim gjatë gjithë jetës për të gjithë', nga 'mësimdhënie me në qendër mësuesin' në 'mësimdhënie me në qendër nxënësin'. Këto ndryshime sjellin kërkesa dhe krijojnë sfida të reja për sistemet e arsimit të lartë.

Sfidat e arsimit të lartë nën ndikimin e procesit të globalizimit janë të shumta, ndër të cilat masivizimi i arsimit, lëvizshmëria e studentëve përtej kufijve kombëtarë dhe shtetërorë, cilësia e kurrikulave dhe e diplomave universitare, krijimi i shanseve të barabarta për shkollim, financimi i universiteteve dhe kohezioni social. Këto sfida mund të përballen dhe të tejkalohen jo vetëm nëse universitetet do kthehen në qendra kërkimi intensiv shkencor, nëse do të promovohet dhe aplikohet realisht konkurrenca mes sistemeve të arsimit të lartë si publik dhe atij privat, nëse cilësia e programeve, e mësimdhënies dhe e diplomave do të përmirësohet ndjeshëm, por gjithashtu edhe nëse ndërtohet një bashkëpunim i frytshëm ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, qeverisë, grupeve të interesit dhe vetë opinionit publik.

Globalizimi i arsimit të lartë tashmë është një fakt që duhet pranuar nga të gjithë, ndaj nuk mund të mbyllem sytë dhe të mos përballemi me sfidat që ai sjell në menaxhimin dhe funksionimin optimal të universiteteve. Institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë po përpiqen të përshtaten me ambientin e ri të krijuar nga globalizimi dhe të plotësojnë kërkesat dhe pretendimet gjithnjë e

më shumë në rritje të konsumatorëve të sistemit arsimor, duke patur parasysh shembujt pozitivë të vendeve të zhvilluara dhe kriteret për integrim evropian.

Bibliografia

- 1 Singh, Parlo "Globalization and education", Educational Theory, Volumi 54, N. 1, 2004.
- 2 Tomlinson, John. "Globalization and culture", University of Chicago Press, 1999.
- 3 Stiglitz, Joseph. "Globalization and Its Discontents", W. W. Norton & Company, USA, 2002.
- 4 Legrain, Phillipe. Cultural globalization is not Americanization
<http://www.philippelegrain.com/cultural-globalization-is-not-americanization/>
- 5 "The Challenges of Globalization", Global Issues eJournal, shkurt 2006.
- 6 László Z. Karvalics, "Information Society - what is it exactly?"
http://www.itk.hu/netis/doc/ISCB_eng/02_ZKL_final.pdf
- 7 Evers, H. (2003). Transition towards a Knowledge Society: Malaysia and Indonesia in Comparative Perspective. *Comparative Sociology*, Vol2, fq.355-373.
- 8 Burch, S. (2006). The Information Society - the Knowledge Society. <http://vecam.org/article517.html>
- 9 UNESCO (2005). Towards Knowledge Societies, Paris, fq. 2.
- 10 Hooker, M (2010). "Building Leadership capacity for ICT Knowledge Societies in Africa".
- 11 Juan de Pablos Pons, Higher Education and the Knowledge Society. Information and Digital Competencies.
<http://www.uoc.edu/ojs/index.php/rusc/article/viewFile/v7n2-de-pablos/v7n2-de-pablos-eng>
- 12 UNESCO Asia and Pacific Regional Bureau for Education (2004) Guidebook 1 - ICTs in Education and Schoolnets.
http://www.unescobkk.org/fileadmin/user_upload/ict/e-books/SchoolNetKit/guidebook1.pdf
- 13 Civici, Ardian. "Globalizimi ... ante portas", UET Press, Tiranë 2009, fq 186-187.
- 14 Civici, Ardian. "Globalizimi ... ante portas", UET Press, Tiranë 2009, fq 193.
- 15 <http://open.data.al/lajme/lajm/id/126/titull/Zhvillimi-i-Arsimit-te-Lartene-periudhen-1991-2011>
- 16 Altbach, G. Philip; Reisberg, Liz dhe Rumbley, E. Laura, "Trends in Global Higher Education: Tracking an Academic Revolution", raport i përgatitur për: The UNESCO 2009 World Conference on Higher Education.
- 17 Bako, Dhimitër. "Globalizmi në Arsimin e Lartë", gazeta Mësuesi, numri 2, shkurt 2011.

18 "Trends in Global Higher Education: Tracking an Academic Revolution", raport i përgatitur për: The UNESCO 2009 World Conference on Higher Education.

19 <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/389/Akreditimi-i-Institucioneve-te-Arsimit-te-Larte-Privat-dhe-Programeve-te-Studimit>

20 Për më shumë shih: <http://www.mash.gov.al/faqe.php?id1=1&id2=86&id3=209>

21 Për më shumë lexo: Civici, Ardian. "Globalizimi ... ante portas", UET Press, Tiranë 2009.

22 <http://open.data.al/lajme/lajm/id/161/titull/Shqiperia-ne-raport-krahasimor-kundrejt-vendeve-te-rajonit-dhe-BE-se-per-nivelin-e-shpenzimeve-ne-arsim-si-e-PBB-se->

23 Ministria e Financave: http://www.minfin.gov.al/minfin/Projekt_Buxheti_2012_1821_1.php

24 Heyneman, P. Stephen, "Global Issues in Higher Education", Global Issues eJournal, shkurt 2006, fq 54.

KRIZA GLOBALE DHE DEBATI PER EURON

Prof. Dr. Anastas ANGJELI

Rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë

ABSTRACT

What should a Eurozone member state do if the Euro fails and the unthinkable scenario of the Eurozone dissolution comes true? This is the central issue the author of this paper deals with. In the first part of the paper the author focuses on the steps taken by the EU institutions in order to resolve the Euro crisis. In the second and third part the author presents the last theories dealing with the possibility of the dissolution of the Eurozone and the practical measures that member states should take in order to deal with this scenario.

Keywords : Euro crisis, EU, Greek crisis, public debt,

Hyrje

Ndërsa përpjekjet për masat antikrize në eurozonë nuk vazhdojnë së rreshturi, studimet dhe propozimet në sensin tjetër, në atë të mundësisë së falimentimit pjesor, të qëndrimit apo largimit nga euro, e ndonjë nga vendet (e vogla) në krizë, gjithashtu janë të shumtë, duke dhënë opsione me rrugëzgjdhje të ndryshme.

Pas Samitit të fundit të BE-së, ndërsa është shtuar besimi dhe flitet për “më shumë Europe” dhe masat e hapat konkrete për daljen nga kriza në vendet e prekura nga kriza në eurozonë po intensifikohen, frika se mund të ketë “krisje të vogla në këtë proces”, mbetet ende. Pas kaq vitesh, për herë të parë tani po botohen dhe studime mbi pasojat e mundëshme të një falimentimi të vendeve të vecanta të euros (p.sh.të Greqisë) ose shkatërimin e plotë të sistemit

të monedhës së përbashkët evropiane d.m.th të Euros. Janë mbi 400 punime të kompanive të fuqishme të studimeve ekonomike, ekipeve kërkimore shkencore bankash, si dhe akademikësh të njohur që u paraqitën për këtë çështje në kërkim të cmimit Wolfson Economics Prize për vitin 2012, cmim ky, i dytë për nga rëndësia pas cmimit Nobel, i fituar nga Kompania e kërkimeve ekonomike Capital Economics.

1. Nga Samiti i 20 -te i BE-së në takimin e Eurogrupit

Samiti i javës së kaluar i BE-së për krizën në eurozonë, i cili arriti një marrëveshje për marrjen e masave antikrizë si: “ndarjen” e bankave nga qeveritë për shkak të borxhit, faktin që kreditorët të cilët blejnë borxhe qeveritare nuk do të jenë në disavantazh nëse një vend falimenton ,reduktimi i kufizimeve për huat për vendet në borxhe, krijimi i një organi (mekanizmi) mbikëqyrës për zonën bankare të eurozonës i drejtuar nga Banka Qëndrore Evropiane, etj. Vazhdimi i zbatimit të tyre dhe marrje e masave të mëtejshme duket se ishte në qëndër të takimit të eurogrupit, sidomos për menaxhimin e situatës së kësaj krize në Spanjë dhe Greqi.

Takimi i Eurogroupit, që zgjati më shumë se 10 orë, vendosi t’i japë një vit më shumë kohë Spanjës deri në 2014, për të reduktuar deficitin e saj buxhetor në 3% të PBB si dhe financimin e sektorit bankar spanjoll. Për rikapitalizimin e bankave spanjolle, u vendos që kësti i parë i ndihmës evropiane prej 30 miliard euro, të jepet deri në fund të këtij muaji, ndërsa kushtet e paketës së ndihmës prej 100 miliardë euro, do të miratohen në takimin e jashtëzakonshëm të Eurogroup më 20 korrik. Sa i përket Greqisë, Ministrat e Financave të Eurogrupit, kanë diskutuar rezultatet paraprake të auditorëve të vizitës së Trojkës në Athinë dhe se do t’i kthehen çështjes greke, kur treshja të përfundojë vlerësimin dhe të përgatisë raportin përfundimtar për ecurinë e zbatimit të programit grek. Sa për këstin e ndihmës që Greqia pret më 20 gusht, Eurogroup, u angazhua se do të gjejë zgjidhje dhe se nuk ka asnjë arsye për t’u shqetësuar.

2. Cfarë ndodh nëse një shtet ikën nga Euro?

Kriza globale e viteve të fundit vecanërisht ajo në eurozone, nuk mund të mos nxiste (gati dy vjet më parë) nisma studimesh nga institucione të rëndësishme dhe prestigjioze financiare, bankare e akademike për ti dhënë përgjigje pyetjeve se çfarë mund të ndodhë në se :

- a) falimenton dhe del një shtet (rasti i Greqisë) nga Euro-ja dhe,
- b) shpërbëhet plotësisht sistemi i Euros dhe kalimi në monedhat kombëtare të vendeve anëtare.

Plot një vit më parë (7 Korrik 2011) Banka Hollandeze ING botoi modelin ekonometrik të hartuar nga grupi studimor i saj me në krye Mark Cliffi-n mbi pasojat e mundëshme të sistemit monetar të Euros me dy variante, në përgjigje të pyetjeve të mësipërme. Studimi i botuar me titullin enigmatik "Quantifying the Unthinkable" (Një shprehje sasiore e të papërfytyrueshmes), vazhdon të jetë objekt i një analize të vecantë nga shumë institucione financiare e bankare, media e gazeta serioze si Financial Times, The Guardian dhe të përditëshme të tjera. Ai dhe situata e krizës e krijuar nuk mund të mos nxiste dhe të conte më tej mendimin e ekonomisteve. Nëse situata në një shtet apo më shumë përkeqësohet, cila është rruga që duhet ndjekur? Duke iu referuar drejtuesit kryesor të studimit Mark Cliffi-t në këtë studim paraqiten pasojat e krizës të Euro-s me shifra konkrete të nxjerra nga modeli i të dhënave me dy variante.

Modeli i variantit të parë llogariste pasojat e falimentimit të kontrolluar të Greqisë, daljes së saj nga Euroja dhe kalimi në monedhen e saj kombëtare dhrahmin. Sipas këtij varianti, modeli arin për vitet 2010-2012, në këto parashikime për uljen e PBB, normën e inflacionit, kurset valutore dhe cmimet e pasurive të patundshme, janë pak "me të dhimbshme" se një falimentim total i vete sistemit të Euros.

Modeli i variantit të dytë, supozon shpërbërjen totale të sistemit të Euro-s dhe kalimi i secilit vend anëtar në monedhën e tij kombëtare. Sipas këtij varianti parashikohet ndryshimi i treguesve kryesore ,në gjithë vendet kryesore të eurozonës që karakterizoheshin kryesisht nga përkeqësime të dukshme si:

-Rënia e PBB-së në %: (Greqi - 9, Irlanda - 5, Spanja -4, Italia -4, Portugalia -3, Belgjika - 2, Holanda - 2, Franca -2, Gjermania -1)

Sic shihet, në këtë variant të dytë rënia e PBB parashikohet më e vogël, sepse ndodhin përkeqësime në kurset e kembimit të monedhave kombëtare ndaj markut gjerman të rivendosur.

Ulja e kurseve të monedhave kombëtare të rivendosura ndaj markës gjermane parashikohet si vijon: (Në Austri, Belgjikë, Finlandë dhe Hollandë -9%, në Francë 18 %, në Itali -22%, në Irlandë, Portugali, Spanjë -45%, dhe në Greqi -80%).

Shqetësuese do të jenë dhe ndryshimet e nivelit të cmimeve të banesave të cilat parashikohen të bien: (Në Greqi -35%, në Irlandë-4%, në Itali-5%, në Spanjë -5 %, në Portugali -2%).

Në bazë të këtyre skenarëve kuptohet lehte se një krizë e thelle e sistemit

monetar të Bashkimit Evropian do të krijonte jo vetëm një krizë të thellë ekonomike, por dhe shumë ndryshime të tjera në raportet e vendeve anëtare, si dhe në raportet e tyre me vendet e tjera e në radhë të parë me SHBA, por dhe me gjithë ekonominë globale. Është për këtë arsye që drejtuesi i studimit të permendur i bankës Hollaneze ING Mark Cliff në një nga intervistat e tij të fundit theksonte se: “Luhatjet e tregjeve pas falimentimit të Bankës amerikane të investimeve Lehman Brothers në vitin 2008 do të duken krejt të padhimbshme në krahasim me ato që mund të shkatohen nga shkatërimi i Euros”. Akoma dhe në rastin e Greqisë sipas këtij studimi “largimi i saj nga Euro-ja nuk do të ndihmonte në përballimin e problemeve të saj ekonomiko-financiare, por do të shkaktonte keqësimin e treguesit të borxhit të saj si përqidje ndaj PBB”. Megjithatë, si...

3. “Të largohesh nga Euro - Një guidë praktike”

Tashmë kjo është një çështje që mund të ndodhë. Dhe duhej zgjidhur. Jo për të dëmtuar procesin e euros, por për të menaxhuar me sukses situatën e krijuar me të në këtë krizë.

Kompania e kërkimeve ekonomike Capital Economics fitoi cmimin Wolfson Economics Prize për vitin 2012. Ky është cmimi i dytë për nga rëndësia pas cmimit Nobel.

Cmimi me një vlerë prej 250.000 paund është dhënë për përgjigjen kundrejt pyetjes “Nqs një shtet anëtar largohet nga Unioni ekonomik dhe monetar, cila është rruga më e mirë që procesi ekonomik të menaxhohet në mënyrë të tillë që të sigurojë themele solide për prosperitetin dhe rritjen ekonomike të unionit?”

Punimi i Capital Economics konkurroi bashkë me 400 punime të tjera të kompanive të fuqishme të studimeve ekonomike, ekipeve kërkimore shkencore bankash, si dhe akademikësh të njohur. Juria në mënyrë unanime zgjodhi punimin e Capital Economics si “zgjidhjen më të besueshme” për problemin se si mund të menaxhohet dalja e një vendi nga Eurozona.

Punimi “Të lësh Euron; një guidë praktike”, fokusohet në daljen e një vendi të dobët si Greqia dhe përfshin edhe rishfaqjen e menjëhershme të monedhes kombëtare.

Kursi fillestar i këmbimit do të jetë 1 për 1, por monedha do të lejohet të zhvlerësohet. Pagesat elektronike dhe Eurot do të lejohen të përdoren deri sa të shtypen monedhat vendase. Vendi do të riemëronte borxhin në monedhën e re dhe do të vendoste rregulla të forta fiskale.

Me konkretisht, hapat që punimi “ Leaving the Euro: A practical guide” sugjeron se duhen ndërmarrë në qoftë se një shtet i vogël (si p.sh. Greqia) largohet nga Euro janë :

- 1) Prezantimi i një monedhe të re me kurs këmbimi të barabartë me Euron në ditën e parë të daljes së vendit nga Eurozona.
- 2) Pagat(Rrogat), cmimet, kreditë dhe depozitat këmbehen në monedhën e re me kursin 1 me 1.
- 3) Banknotat dhe monedhat Euro do të përdoren për transaksionet e vogla për një periudhë deri në gjashtë muaj.
- 4) Vendi do të shpallte menjëherë një regjim *inflation targeting*, do të miratonte rregulla të ashpra fiskale, do të monitorohej nga një grup ekspertësh të pavarur dhe do të shpallte të paligjshëm indeksimin e pagave.
- 5) Qeveria do të ridimensiononte borxhin në monedhën e re kombëtare dhe do të bënte të qartë qëllimin e saj për të rinegociuar kushtet e borxhit.

Punimi sugjeron që zyrtarët e lartë të vendit që do të largohet nga Eurozona të takohen në mënyrë të fshehtë një muaj përpara se të shpallet publikisht se vendi do të largohet nga Euro, pra një muaj përpara së aqshuajturës D Day. Partnerët e Eurozonës dhe të institucioneve të tjera monetare ndërkombëtare do të njoftohen për D Day-n tre ditë përpara (mundësisht ditë të Premte) me një deklaratë publike ku do të thuhet se kalimi në monedhën e re do të ndodhë në fillim të javë së ardhshme. Menjëherë pas kësaj deklaratë bankat lokale dhe institucionet financiare duhet të mbyllen në mënyrë që të parandalohet një dalje e kapitalit. Qeveria e vendit dhe institucionet e BE-së duhet të kujdesen që të minimizojnë pasiguritë në lidhje me çështjet juridike si p.sh. për statusin e vendit në BE, për vazhdimësinë e monedhës Euro etj.

*

* *

Kjo ngjarje (fitimi i Cmimit Wolfson për punimi “ Leaving the Euro: A practical guide”) është vlerësuar nga analistë të ndryshëm si një sukses i punës në ekip të Capital Economics”. Njerëzit mund të mos pajtohen me faktin se dalja nga Euro është një gjë e mirë, por kontributi i Çmimit Wolfson ka qenë për të demonstruar se kjo gjë mund të ndodhë». Kjo, pra nuk duhet të cudis kërënd. Nuk duhet të mendohet si një sfidë ndaj masave antikrizë në eurozonë. Përkundrazi tashmë ajo duhet të konsiderohet si një element i mundshëm në procesin e pandalshëm “Te me shumë Europë” të vazhimit të masave për më shumë unifikim, ne politikat ekonomike, buxhetore, fiskale, bankare në një rrugë të domosdoshme të kalimit nga Federalizmi Demokratik European në më shumë Federalizëm Politik European, ndryshe...?!

Bibliografia

George Soros, Paradigma e re per tregjet financiare: Kriza kreditore ne vitin 2008 dhe rendesia e saj.

George Soros, Financial turmoil in Europe and the United States, New York 2012

Martin Wolf, Fixing global finance, How to curb financial crises in the 21st century; UK 2010

Alan Greenspan, The age of turbulence, Adventures in a new world; New York 2007

Mark Cliffl, "Quantifying the Unthinkable" Banka Hollandeze, 2011,

Leaving the Euro: A practical guide. "If member states leave the Economic and Monetary Union, what is the best way for the economic process to be managed to provide the soundest foundation for the future growth and prosperity of the current membership?" A submission for the Wolfson Economics Prize MMXII by Capital Economics Lead author: Roger Bootle. 2012. *Mund te gjendet ne adresen web*

<http://www.policyexchange.org.uk/images/WolfsonPrize/wep%20shortlist%20essay%20-%20roger%20bootle.pdf>

DISA ASPEKTE LIGJORE TE LIDHJES SE GLOBALIZIMIT ME PASTRIMIT E PARAVE

Naim MËÇALLA
Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

Globalization is the process of transformation of local phenomena into global phenomena inter alia as a consequence of communication and interaction increased speed between people and nations. Today, as a consequence of permanent increase of interdependence, none of world's countries can act under isolation from the impact of other countries. From this perspective, just like any other phenomenon, also the criminality in general and especially organized crime, due to globalization and its facilities, have been transformed into essential global activities that are extended behind state's borders.

Keywords: Globalization, Money laundering, international cooperation, transfer of assets, fights against money laundering

Hyrja

Globalizimi është një proces ekonomik, shoqëror, politikë dhe kulturor, që i kalon kufijtë e shteteve. Ai është i pranishëm në qarkullimin e shpejtë dhe të pakufizuar të transaksioneve ekonomike dhe financiare, lëvizjen e kapitalit dhe të pronës pa pengesa, etj.. Nëpërmjet transfertave elektronike, kartë kreditit dhe mjeteve të tjera të panumërta ne jemi në gjendje të lëvizin shuma të mëdha parash brenda sekondave nga një vend në tjetrin, në disa raste me anonimitet dhe siguri të madhe. Askush nuk mund t'i mohoj anët pozitive të globalizimit në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe ngritjen e standartit të jetesës.

Nga ana tjetër këto zhvillime teknologjike kanë lehtësuar kryerjen e aktiviteteve kriminale dhe fshehjen e origjinës antiligjore të parave. Rrjetet e komunikimit e kanë kthyer botën në një vend shumë të vogël, ku thirrjet telefonike, e-mail, mesazhet me tekst dhe fakse kanë eliminuar distancën në mes njerëzve. Krimi i organizuar, me ndihmën e teknologjisë informatike, ka kapërcyer kufijtë tradicionale, duke përbërë një sfidë të rëndësishme për agjensitë e zbatimit të ligjit.

Globalizmi i ekonomisë ka favorizuar krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, sasi të mëdha kapitalesh mund të transferohen lehtë pa u kontrolluar nga procedurat kombëtare të kontrollit. Kriminelët paguajnë asistencën ekonomike e ligjore, për të realizuar riciklimin e kapitaleve kriminale. Sistemet informatike i japin shumë mundësi dhe siguri krimin të organizuar, të bëjë riciklimin e parave në një kohë shumë të shkurtër. Pastrimi i parave është fenomen ndërkombëtar, dhe si i tilla çdo përgjigje adekuate në thelb duhet të bazohet në bashkëpunimin ndërkombëtar, si shkëmbimin e informacionit, të dëshmive dhe ekstradimit e të të dyshuarit, konfiskimin e aseteve kriminale, etj..

Çdo shtet duhet të jetë i vetëdijshëm se pastrimi i parave është vazhdim i veprimtarive të tjera kriminale që mund të ndodhin në çdo vend të botës. Prandaj është e një rëndësie të madhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar për të përballuar me sukses sfidat e globalizimit dhe të pastrimit të parave.

1. Çfarë është globalizimi?

Globalizimi është proces i gjendjes aktuale në të cilën gjendet bota jonë sot, ai është proces ekonomik, shoqëror, politik dhe kulturor, veprimet e të cilit i kalojnë kufijtë e shteteve nacionale. Termi "globalizim", në tërësinë e tij nënkupton "*zhvillimin e lidhjeve dhe të marrdhenieve të ndërsjellta ndërmjet njerëzve, ideve dhe informacionit, aktiviteteve ekonomike – financiare dhe tregtare, atyre politike dhe kulturore në shkallë planetare*"¹. Sipas Profesor Bedri Selmanit globalizimi është proces i ndërlikuar i ndërtimit të botës në tërësi dhe ka të bëjë me bashkimin²:

- ekonomik të tregut në botë, të uniformuar me format e prodhimit dhe konsumit;

1 Adrian Civici, "Globalizimi... ante Portas", UET-pres, Tiranë 2009, fq.13.

2 Selmani, Bedri: "Globalizimi Transicioni dhe Integrimet", Zenit, Ljubljana-Prishtinë, 2006. Marrë nga <http://institutivictory.org/?page=1,17,70>

- demokratik të botës mbi bazat e interesave për njerëzimin, siç janë barazia, mbrojtja e të drejtave njerëzore, sundimi i ligjit, pluralizmi, paqja dhe siguria, dhe
- moral të botës rreth disa vlerave qëndrore humanitare të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të njerëzimit.

Proceset globalizuese i shohim edhe në qarkullimin e pakufizuar të transakcioneve ekonomike dhe financiare në bursa. Teknologjia informatike dhe përdorimi i kompjuterit për kryerjen e shumë detyrave dhe funksioneve në fushën ekonomike, juridike, industriale, shkencore dhe në shumë fusha të tjera ka mundësuar zhvillimin e një progresi aq të shpejtë, sa që mënyra e jetesës ka ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme. Në çdo moment janë të pranishme lidhjet me të gjithë dhe informatat për gjithëshka që na intereson. *Konkretisht kriza ekonomike globale e tanishme, rrjedhat e të cilës kanë filluar nga SHBA-të, brenda natës përfshinë botën*³. Kjo pasqyron faktin se sa proceset globalizuese kanë pushtuar botën. Me kompjuterat, sot e pamundura është bërë e mundur, ai ka mundësuar që në të, të futen vëllime të gjëra, të të dhënave dhe informatave, sa që një gjë e tillë është e papërceptueshme për ndjenjat e njeriut. Kompjuteri ka mundësuar që me ndihmën e procesorëve, njerëzimi të ketë lidhje dhe komunikim me tërë botën dhe me një shpejtësi shumë të madhe.

2. Çfarë kuptojmë me pastrim parash?

Pastrimi i parave është përkufizuar si “... transferimi i të hollave të nxjerra në rrugë të paligjshme ose investimi për të fshehur burimin e vërtetë.”⁴ Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) e përkufizon pastrimin e parave si “një gamë të gjerë të aktiviteteve dhe proceseve me qëllim errësimin e burimit të të hollave të fituara në mënyrë të paligjshme dhe për të krijuar pamjen se ato e kanë origjinën nga një burim legjitim”⁵. Një zyrtar i Reserves Federale të ShBA-së e përcakton pastrimin e parave “...si kthimin e të ardhurave të realizuara me mjete të paligjshme në pasuri të cilave është e vështirë t’u gjendet origjina e kimit. Disa nga veprimet kriminale që shoqërohen me pastrim parash janë trafiku i drogës, financimi i terrorizmit dhe përvetësimi i fondeve publike”⁶. Një

3 Dr.sc. Veton Vula; “Kriminaliteti kompjuterik”, Prishtine 2009, fq. 28

4 Përkufizimet e pastrimit të parave janë miratuar në fjalor të përbashkët, shih Oksford anglisht Fjalor, Edicioni i dytë, 1989, fq. 702.

5 Shih IOSCO Komiteti Teknik, Tetor 1992, Raporti mbi pastrimin e parave.

6 Ted Truman (ish zyrtar i Rezerves Federale Sh.B.A) dhe Peter Reuter,

përfaqësues i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, Paul Byron, shprehet se, “...pastrimi i parave ka të bëjë me përfitimin e pasurisë nga aktivitetet ilegale dhe përpjekjet që këto përfitime të vendosen në sistemet bankare, në atë mënyrë që të fshihet origjina e parave apo edhe të vazhdohet aktiviteti kriminal, duke përdorur sistemin financiar”.⁷

Nuk ka dallime të rëndësishme në përkufizimin e pastrimit të parave. Në thelb kjo veprimtari kriminale përfshin përpjekjet për t’ju shmangur konfiskimit të të ardhurave të krimit, të cilat mund të përdoren si “të ligjshme”. Pastrimi i parave në përgjithësi përfshin transaksione të shumta të përdorura për të fshehur burimin e aseteve kriminale. Paraja pastrohen nëpërmjet agjencive të këmbimit valutor, kazinove, shitblerjes së makinave të shtrenjta, të bizhuterive, kompanive të sigurimeve dhe kompanive tregtare. Ajo pastrohet nëpërmjet “of-shorë”, parajsave financiare dhe bankare, korporatave të karburantëve, zonave të tregtisë së lirë, etj..

Metodat e pastrimit të parave mund të klasifikohen në tre faza të dallueshme:

a) Vendosja është procesi i lëvizjes fizike të parave nga vendi i krimit, nëpërmjet depozitave, SWIFT /transfertave bankare, ose instrumenteve të tjera financiare. Në këtë fazë kryhet shndërrimi i shumave të parasë fizike me origjinë kriminale (si nga trafiket e ndryshme, korrupsioni, etj.,) në një formë tjetër, si përshebull, në para elektronike, ose duke i përdorur në tregtinë me pakicë ose transferuar jashtë vendit;

b) Pastrimi i referohet procesit të ndarjes së të ardhurave nga origjina e tyre kriminale, nëpërmjet përdorimit të transaksioneve financiare. Kjo fazë përfaqëson sasinë më të madhe të parave dhe synon humbjen e gjurmave, mbulimin dhe maskimin e origjinës së tyre, nëpërmjet :

- futjes së parave në sistem financiar,
- kryerjes së investimeve të tjera,
- konvertimit të parave të pista fillestare në para të tjera,
- kryerjes së transaksioneve tregtare.

Në këtë fazë synohet copëzimi i kapitaleve të paligjshme me qëllim fshirjen e çdo mundësie për t’u ngjitur në origjinën e paligjshme të fondeve. Ky process realizohet nëpërmjet një sistemi kompleks transfertash financiare, me ndihmën

bashkëautorë të studimit të Institutit të Ekonomisë Ndërkombëtare, Uashington. Pastrimi i parave - 2004-12-15 <http://www1.voaneës.com/albanian/neës/a-30-a-2004-12-15-3-1-85540192.html? moddate=2004-12-15>

7 Albana Isufi, Prishtinë.Seminari “Pastrimi i parave përbën kërcënim global” 21.09.2004 <http://www.evropaelire.org/content/Article/1020095.html>. Cituar Paul Byron, përfaqësues i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara.

e shoqërive fantazëm ose nëpërmjet përdorimit të të ashtuquajtura “parajsave fiskale”.

c) Integrimi përfaqëson investimin e fondeve me origjinë të dyshimtë në një veprimtari ekonomike ligjore, me qëllim legjitimimin e tyre. Investimi, konsiston në përdorimin e parave të pista, pasi ato kanë dalë nga sistemi bankar. Pra, ndodh përdorimi i kësaj paraje “të pastër” në operacione investimesh të ligjshme. Në këtë fazë thuhet nuk mund të identifikohet më personi që kryen pastrimin e parave.

3. Përse globalizimi favorizon krimin e organizuar dhe pastrimin e parave?

Teknologjia informatike, largimi i barrierave doganore, zhvillimi i komunikimit botëror, e ka ngritur *mjaft standardin mesatar të jetës, standardin personal dhe publik*⁸. Krahas anëve të veta positive në shoqëri, globalizimi ka dhe anët negative. Përparimet teknologjike kanë hapur dyert e veprimeve kriminale në mënyrat dhe format që asnjëherë më parë nuk kanë qenë të mundshme. Sot sistemet kompjuterike ofrojnë mundësi të reja dhe më të sofistikuar për kryerjen e krimit. Në rrethanat e sotme të shoqërisë bashkëkohore, kriminaliteti tenton para së gjithash të depërtojë në teritoret e shteteve me demokraci të re dhe në shoqëritë në zhvillim, pasi gjenden hapësira të përshtatshme për kryerjen e veprimeve kriminale.

Organizatave kriminale shfrytëzojnë teknologjinë informatike dhe kompjuterat si mjete për planifikimin dhe kontrollin e veprimeve të tyre kriminale. Transferrat elektronike të fondeve u mundëson atyre lëvizjen e shpejtë dhe të sigurtë të shumave të mëdha të parave të krijuara nga veprimet antiligjore, të cilët transferohen më pas në llogari të bankave të ndryshme ndërkombëtare për të fshehur origjinën e tyre kriminale dhe në këtë mënyrë ndihmojnë në pastrimin e parave. Kompjuterat lehtësojnë veprimet e grupeve kriminale dhe i mundësojnë ata që me lehtësi dhe sukses të drejtojnë sistemet e tyre financiare, të koordinojnë dhe kontrollojnë me shpejtësi veprimtarinë e tyre në çdo cep të botës. Nga ana tjetër, teknologjia informatike vështirëson punën e agjensive të zbatimit të ligjit për hetimin dhe goditjen e organizatave kriminale.

8 Raporti i Bankës Botërore për standardin e popullsis në nivel global, Ëashington DC, 2008.

Qëllimi i një numri të madh të veprave penale është të gjenerojë një fitim për individin ose grupe të cilët kryejnë aktin kriminal. Pastrimi i parave është përpunimi i këtyre të ardhurave kriminale për të fshehur origjinën e tyre të paligjshme. Ky proces është i një rëndësie kritike, pasi ai mundëson kriminelët të gëzojnë këto fitime pa rrezikuar burimin e tyre.

Njëri nga faktorët kryesor negativ të procesit globalizues është mungesa e mbikqyrjes shtetërore demokratike në rrafshin e globalizimit ekonomik dhe si pasojë dobësimin e ndikimit shtetëror në transaksionet financiare transkufitare. Pamundësia e mbikqyrjes shtetërore të kompanive transnacionale mundëson ikjen e kapitalit në të ashtuquajturat vendet të “parajsës financiare” dhe të “parajsës fiskale” siç janë vendet ekzotike si Ujdhësat Kajmone, Monaco, Lihtenshtajni, Luxemburgu, ku paguhet tatimi minimal. Këto vende janë bërë lavatriçe financiare për pastrimin e parave që vijnë nga bota e krimit të organizuar.

Globalizimi financiar ka përmirësuar në masë të madhe efikasitetin e kapitalit financiar nëpërmjet transfertave në gjithë botën. Procesi i globalizimit ka favorizuar pastrimin e parave, pasi bota është kthyer sot në një “*fshat global financiar*”. P.sh. fondet e themeluar në det të hapur, qendrat “ofshore”, janë vlerësuar të jetë rreth US \$ 50-100 miliarda (OKB-2007)⁹. Organizatat kriminale që kryejnë aktivitetet të paligjshme të cilat gjenerojnë “para të pista” shfrytëzojnë çdo mundësi të ofruar nga globalizimi, për pastrimin e kapitalit të tyre në qendrat financiare si: Ishujt Kajman, Hong Kong dhe Lihtenshtajni. *Sipas një vlerësimi të kohëve të fundit, aktiviteti i pastrimit të parave në mbarë botën arrin në afërsisht US \$ 1.000.000.000.000(1 trilion) në vit¹⁰. Shuma e vlerësuar e parave të pastruara globalisht në një vit është 2 - 5% të GDP-së globale, ose 800.000.000.000 \$ - \$ 2 trillion në dollarë e tanishme amerikane¹¹.*

Integrimi gjithnjë e më shumë i Shqipërisë në komunitetin nderkombëtar, globalizimi i sistemeve tregtare dhe financiare, intensifikimi i tregtisë nderkombëtare, levizja e lire e njerezve, e mallrave dhe e pajisjeve, përveç zhvillimeve dhe progresit, krijojnë dhe hapësira e mundësi për aktivitete

9 Revista de Economía y Estadística - Vol. XLVI - N° 2 - (2008) - pp. 147-166 Instituto de Economía y Finanzas - Facultad de Ciencias Económicas Universidad Nacional de Córdoba - Argentina. Case Studies on Globalisation and Money Laundering, Prof. Dr. Eckhard Freyer, presented as an invited conference in the 8th Arnoldshain Seminar- ISCES, at the University of Sao Paulo, Brazil, April 2008.

10 Ibid

11 <http://www.unodc.org/unodc/en/money-laundering/globalization.html>. Akces date 10.09.2011.

kriminale ne fushen e krimit financiar dhe ne vecanti per pastrim parash te siguruara nga aktivitetet kriminale. Sipas Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2009 një total prej 55,701 transaksione pagesash u shlyen në sistemin AIPS (sistemi i shlyerjes së pagesave me vlerë të madhe), me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 85 milionë lekë. Ndërsa në sistemin AECH (sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël) një total prej 102,304 urdhërpagesa u kleruan gjatë vitit 2009, me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 150 mijë lekë¹².

Krimi i organizuar gjeneron shuma të mëdha parash, nga ana tjetër korrupsioni dhe skemat e mashtrimit kompjuterik nxisin krimin e organizuar, duke "legjitimuar" paratë e pista. Individit ose grupet e përfshirë në aktivitetet kriminale duhet të gjejnë mënyra për kontrollin e fondeve pa tërhequr vëmendjen për aktivitetin themelor ose personat e përfshirë. *Kriminelët e bëjnë këtë duke maskuar burimet, duke ndryshuar forma, ose duke lëvizur fondet në një vend ku ata tërheqin më pak vëmendjen*".¹³

Liberalizimi i tregëtisë, rritja e turizmit dhe e transaksioneve ndërkombëtare çuan në rritjen e zyrave të këmbimit valutor dhe të shumava të përfshira, duke lehtësuar në këtë mënyrë procesin e pastrimit të parave. Kur paratë e pista depërtojnë në sistemin financiar është më e lehtë për t'i lëvizur në shkallë globale. Kriminaliteti tregtar është më dinamike në kështjellat e globalizimit financiar. Nuk ka dyshim, se globalizimi ka krijuar mundësi të mëdha për kriminalitetin në përgjithsi dhe për krimin e organizuar në veçanti, megjithatë, ai ka krijuar mundësi për të përbashkuar sfidat e procesit të globalizimit, konkretisht¹⁴:

- avancimi teknologjik ka rritur jashtëzakonisht lëvizshmërinë e njeriut dhe ka shkurtuar shpenzimet e komunikimit në mënyrë drastike. Globalizimi e ka bërë, pra lëvizjen e mallrave dhe shërbimeve shumë më të lehtë dhe më të shpejtë. Kjo ka krijuar mbi të gjitha një pikëpamje të përbashkët globale në lidhje me kërcënimin e krimit të pastrimit i parave;
- Përveç krijimit të një pikëpamje të përbashkët të problemit, globalizimi ka inkurajuar një përgjigje kolektive për këtë kërcënim;
- Për më tepër, globalizimi ka krijuar edhe një perceptim të përbashkët për rreziqet e autorëve të krimeve.

12 Banka e Shqipërisë. Raporti_vjetor_2009_pagesat_3287_1.pdf.

13 FATF web page, "Money Laundering FAQ". Available: http://www.fatf-gafi.org/document/29/0,3343,en_32250379_32235720_33659613_1_1_1_1,00.html

14 For details see Margaret E. Beare, "North America: A Perspective on the globalization of crime" in *Journal of Financial Crime*, Vol. 6 No. I, Aug. 1998.

4. Dimensionet ndërkombëtare të pastrimit të parave.

Dimensioni ndërkombëtar i pastrimit të parave del qartë në një studim kanades të pastrimit të parave. Nga punimi rezulton se mbi 80 % e të gjitha skemave të pastrimit të parave kishin dimension ndërkombëtar. "Operacioni Green Ice"¹⁵ tregoi se pastrimi i parave ka natyrë transnacionale. Italia, Kolumbia, Mbretëria e Bashkuar, Kanada, Spanjë, Kosta Rika, Ishujt Kajman, dhe Shtetet e Bashkuara kanë bashkëpunuar së bashku për të vënë nën kontroll infrastrukturën financiare e mafias Cali. Gjatë fazës së parë të operacionit "Green Ice", mbi 50.000.000 \$ në para të gatshme dhe pasurisë u kapën dhe gati 200 vetë u arrestuan në mbarë botën, duke përfshirë shtatë menaxherë të parave të mafias Cali. Nga hetimi rezultoi se kishte lidhje direkte mes organizatave kriminale, mafias italiane dhe mafias kolumbiane të kokainës. Ky ishte një operacion historik edhe sepse ishte hera e parë që një agjenci e zbatimit të ligjit themeloi një bankë private - operohej nga agjentë të fshehtë - si një mjet hetues për të provuar pastrimit e parave të drogës.

Në dhjetor 1998 Lazarenko u arrestua nga policia zvicerane kur ai u përpoq të hynte në Zvicër me makinë duke përdorur një pasaportë panameze me emrin e Lopez. Ai u pyet nga Laurent Kasper-Ansermet¹⁶, një gjyqtari zviceran, në bazë të një kërkesë për ndihmë gjyqësore nga Ukrainë, u lirua me kusht, dhe u kthyer në Ukrainë. Në 1999 Lazarenko iku në Shtetet e Bashkuara pasi imuniteti i tij si një anëtar i të parlamentit të Ukrainës u hoq. Në qershor 2000 Lazarenko është dënuar në Zvicër për pastrim parash, pasi kishte depozituar në bankat zviceriane një shumë prej 72.000.000 USD të përfituara nga një kontratë e qeverisë ukrainase, dhe më pas shumicën e këtyre parave të paligjshme i kishte bartur në Bahamas dhe Antiguan. Në maj 2000 ai u akuzua në SHBA për mbi pesëdhjetë e tre akuza penale, duke përfshirë pastrimin e parave dhe përvetësim prej 114.000.000 \$. Katër vjet më vonë, më 4 qershor, 2004, një juri në SHBA e shpalli fajtor Lazarenkon¹⁷ për 29 akuza, duke përfshirë shpërdorim të pozicionit të tij politik për të zhvatur paratë dhe pastaj pastrimin e tyre nëpërmjet bankave në Kaliforni, përfshirë komplot për të pastruar paratë, mashtrimin dhe transportimin e pronave të vjedhura, etj., duke qenë të bindur

15 www.laundryman.u-net.com/.../operation_green_ice.html

16 *Corruption and Money Laundering: A Symbiotic Relationship* by David Chaikin and J.C. Sharman First edition: July 2009; Printed in the United States of America. Pg. 138

17 [Pavlo Lazarenko - Ëikipedia, the free encyclopedia en.ëikipedia.org/ëiki/Pavlo_Lazarenko](http://en.ëikipedia.org/ëiki/Pavlo_Lazarenko). Akces date 15.09.2011.

në lidhje me një sasi prej 44.000.000 USD humbje për qeverinë e Ukrainës dhe të pastrimit të parave mbi 21.000.000 USD nëpërmjet sistemit bankar amerikan. Më 26 gusht 2006, Lazarenko u dënua me nëntë vjet burg dhe u gjobit 10.000.000 USD. Sfida për prokurorët e SHBA në rastin Lazarenko ishte për të provuar të dy se pastrimi i parave, mashtrimi dhe të vjedhura transferet e pronës u bë në kundërshtim me ligjet amerikane dhe se paratë e fituara në mënyrë të paligjshme sipas ligjit të Ukrainës në fuqi në atë kohë. Rasti i Lazarenkos ishte praktika më e mirë e bashkëpunimit ndërkombëtar kundër pastrimit të parave.

Ngjarjet e mëdha që kanë ndryshuar koperturën botërore, si përfundimi i Luftës së Ftohtë, lëvizja e lirë e njerëzve, zhvillimet ekonomike dhe arritjet teknologjike si informatika dhe telematika, kanë sjellë me vetë globalizimin e ekonomisë, lëvizjen financiare ndërkombëtare. Fluksi i parave nuk njihet flamur. Kapitali investohet ku ka kushte më të mira. Globalizmi i ekonomisë ka favorizuar riciklimin financiar të krimit në ekonomi. Zhvillimet e shpejta të teknologjisë dhe të komunikimit lejojnë paratë që të lëvizin kudo në botë me shpejtësi dhe lehtësi. Kjo e bën detyrën e luftës kundër pastrimit të parave më urgjente se kurrë. Sa më thellë "paratë e pista" hyjnë në sistemin bankar ndërkombëtar, aq më e vështirë është të identifikohet origjina e tyre. Për shkak të natyrës së fshehtë të pastrimit të parave, është e vështirë të vlerësohet shuma totale e parave që "pastrohen". Sipas eksperteve të FMN-se, fitimi financiar neto nga pastrimi i parave arrin në rreth 2% të GDP-së botërore, gati pesë qind milionë USD në vit. "Askush nuk e di se sa para pastrohen çdo vit në botë përmes bankave, kjo shifër mund të arrijë në shtatëqind miliard dollarë".¹⁸ "Aktualisht shuma e vlerësuar e parave të pastruara globalisht në një vit është 2 - 5% të GDP-së globale, ose 800.000.000.000 \$ - \$ 2 trillion në USD"¹⁹.

Drejtuesit e botës së krimit kanë krijuar operacione pastrimi ndërkombëtare, të cilat kanë qenë tradicionalisht të imunizuara prej zbulimit. Globalizmi i ekonomisë ka favorizuar pastrimin e parave, pasi sasi të mëdha kapitalesh transferohen lehtë pa u kontrolluar nga procedurat kombëtare të kontrollit. Kriminelët paguajnë asistencën ekonomike, për të realizuar procesin e pastrimit të parave. Sistemet telematike i japin shumë mundësi dhe siguri krimit të organizuar, të bëjë riciklimin e parave në një kohë shumë të shkurtër.

Kalimi i shpejtë në ekonominë e tregut nga një ekonomi e planifikuar,

18 Raport i përgatitur nga eksperti ndërkombëtar për financimi i terrorizmit, Jean-Charles Brisard për presidentin e Këshillit të Sigurimit, Dhjetor 2002. Marrë nga libri Naim Mëçalla "Pastrimi i parave kercenim për sigurinë kombëtare". Tirane 2007, fq. 43.

19 <http://www.unodc.org/unodc/en/money-laundering/globalization.html> (akses date 12.09.2011)

provokoi edhe në Shqipëri, si dhe në vendet e ish sistemit socialist, dukuri të tilla si, privatizime të menjëhershme, shembje të sistemit të prodhimit, rritje të varfërisë, shtim të korrupsionit, që është i vështirë të kontrollohet, si dhe rritja e mundësive të informimit, globalizimi - krijoi një situatë të përshtatshme për rritjen krimin të organizuar, *ku kërthiza është pastrimi i parave*. Qëllimi i pastrimit të parave është të krijojë veprimtari ekonomike ku të maskohet transferimi i kapitaleve. Krimi ekonomik që të ekzistojë, kërkon veprimin në ekonomi, zbatimin e rregullave të sistemit ekonomiko - financiare. *“Pastrimi i Parave është një domosdoshmëri e vetë ekzistencës së krimit te Organizuar dhe pasojë e tij. Është një akt i mirëfilltë kriminal, që përbën një rrezik global me pasoja evidente për ekonominë e të gjithë vendeve”*.²⁰

5. Reagimi ndërkombëtar ndaj pastrimit të parave

Pastrimi i parave është një dukuri në zhvillim dhe përshtatje, i cili kërkon mobilizimin e të gjitha instancave legislative dhe rregullatore në botë, si edhe të komunitetit financiar ndërkombëtar. Evolucioni fillimisht ka qenë i ngadaltë. Në fillim të vitëve '80, Europa u ndërgjegjësua për ekzistencën e kapitalëve të paligjshme me origjinë kriminale dhe për domosdoshmërine e masave që duheshin marrë si edhe për vendosjen e bashkëpunimit europian. Më 27 Qershor 1980, Komiteti i Ministrave të Bashkimit Europian rekomandoi hartimin e dispozitave kundër transferimit dhe fshehjes së fondeve me origjinë ilegale.

Më 12 dhjetor 1988, u miratua Deklarata e Komitetit të Bazelit për parandalimin e përdorimit të sistemit bankar për qëllime të pastrimit të parave me origjinë kriminale. U rekomandua identifikimi i klientit, zbatimi i saktë i kuadrit rregullativ përkatës dhe bashkëpunimi me autoritetet e ngarkuara për zbatimin e ligjit.

Më 9 Dhjetor 1988, Konventa e Vjenës shënoi hapat e para të ndërtimit të një politike botërore dhe të një mobilizimi të gjërë ndërkombëtar kundër pastrimit të parave. Kjo Konventë solli këto të reja : Detyrimin e shteteve për përcaktimin e figurës së krimit të pastrimit të parave, me origjinë trafikun e narkotikeve, kur është kryer me vetëdije; dhe heqjen e sekretit bankar nëse bëhet fjalë për hetime gjyqësore lidhur me trafikun e narkotikeve.

²⁰ Naim Mëçalla, *“pastrimi i parave kercenim per sigurine kombetare”*. Dita 2000-Pres. Tiranë 2007, fq.39.

Në Korrik 1989 në takimin e Parisit të G7 për herë të parë u ngrit grupi Task-Forcë i veprimeve financiare ndërkombëtare (FATF), me detyrë kryesore të analizonte riciklimin dhe të bënte rekomandime për ndalimin e tij.²¹ Krijimi dhe funksionimi i FATF, përfaqëson ngritjen e luftës kundër pastrimit të parave në një nivel të ri, shumë më të lartë. Qëllimi i FATF-it është zhvillimi dhe promovimi i politikave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. U krijuan kështu kushtet kur ishte konstatuar se, sistemet financiare të vendeve të zhvilluara ishin përdorur pa dijeninë e tyre, vëllimi i kartmonedhave në qarkullim në valutat kryesore kishte arritur në nivele shqetësuese ndaj nevojitej rritja e kontrollit; kërkohet forcimi i sistemeve financiare dhe forcimi i mbikëqyrjes së tyre.

FATF ka miratuar **40 rekomandime** në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, 9 të tjera shtesë në kuadër të luftës kundër financimit të terrorizmit, të aplikueshme për të gjitha vendet.²² Rekomandimet synojnë në këto drejtime kryesore:

Konventa e Këshillit të Europës, Nr.141, datë 08.11.1990, "Mbi pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit", ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr.8646, datë 20.07.2000.²³, solli një zhvillim të mëtejshëm pozitiv. Konventa përqëndrohet në kërkimin dhe konfiskimin e pasurisë, që rrjedh nga pastrimi i parave. Qëllimi i Konventës është privimi i krimineleve nga produktet e krimit. Për këtë qëllim, kërkohet ngritja e një sistemi të kënaqshëm bashkëpunimi.

Sipas ligjit shqiptar Nr.9917/2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", përcaktohet Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave si "Autoritetin përgjegjës" që drejton luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ajo shërben si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave për veprimtaritë e mundëshme të pastrimit të parave. Gjithashtu, bashkërendon punën midis institucioneve të shtetit, në luftën kundër pastrimit të parave; ndjek kalimin e praktikave të dyshimta në organin e prokurorisë; bashkëpunon dhe shkëmben informacion me institucione të ngjashme të huaja.

Megjithëse, baza ligjore është bashkëkohore, konstatohet se në praktike ndeshen shumë probleme në kuptimin e pastrimit të parave, në metodat e hetimit që duhen ndjekur për të mbledhur provat e nevojshme, në koordinimin

21 Për më shumë informacion ne adresën <http://www1.oecd.org/fatf/> about FATF.

22 Për më shumë informacion ne adresën <http://www1.oecd.org/fatf/> 40 Recs_en..

23 Për më shumë informacion Konventa Nr.141 datë 08.11.1990 e Këshillit të Europës, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr.8646 date 20.07.2000.

e punes ndermjet institucioneve zbatuese te ligjit, apo dhe ne menyren e paraqitjes se rasteve para gjykates. Kështu, gjatë vitit 2010 janë referuar në organin e Prokurorisë, 64 raste²⁴ të analizuara e të konkluduara me dyshime të arsyeshme për pastrim parash. Por rastet e denimit penal te personave te perfshire ne aktivitetin kriminal te pastrimit te produkteve te vepres penale janë shumë të pakta. Pastrimi i parave të pista, si produkt i veprimtarise së paligjshme është sot një realitet në Shqipëri. Por dokumentimi me prova i kësaj veprimtarie, tek ne është ende në fazat fillestare

Ne keto kushte behet gjithnje dhe me shume e domosdoshme qe organet e zbatimit te ligjit te intensifikojne luften kunder ketyre fenomeneve negative, duke i njohur me mire ato sesi funksionojne, duke trajnuar personelin e tyre ne menyre te vazhdueshme, duke persosur ne vazhdimesi strukturat qe merren me parandalimin dhe luften e ketij lloj kriminaliteti, si dhe duke forcuar bashkepunimin ndermjet tyre dhe atë ndërkombëtar.

Ne Shqiperi nga fillim i vitit 2010 ka hyre ne fuqi dhe po zbatohet ligji per sekestrimin dhe konfiskimin jashte procesit penal te pasurive qe burojne nga krimi organizuar. Qellimi eshte parandalimi dhe goditja ndaj kimit te organizuar dhe trafikimit permes konfiskimit te pasurise se personave, te cilet kane nje nivel pajustifikuar ekonomik, si rezultat i veprimtarise se dyshuar kriminale. Konfiskimi civil i pasurive qe dyshohet se rrjedhin nga aktivitete kriminale eshte nje koncept i ri ne legjislacionin shqiptar, sepse e kthen barren e proves tek personi, pasuria e te cilit dyshohet se buron nga veprimtaria kriminale.

Konkluzione :

Globalizimi i tregjeve financiare dhe pastrimi i parave është një problem me dimensione të reja. Kërkohe transparencë më e lartë e lëvizjes së kapitalit dhe e transaksioneve financiare në tregjet botërore, si dhe sanksione kundër vendeve që nuk bashkëpunojnë.

Për rritjen e aktivitetit të luftës kundër pastrimit të parave kërkohe forcimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe administrativ si dhe mbikëqyrjes bankare.

Nuk ka dyshim se globalizimi ka krijuar mundësi për rritjen e krimin dhe kriminalitetin, megjithatë, ai ka dhënë gjithashtu disa mundësi për përbalimin me sukses të kësaj sfide nëpërmjet ndërjegjësimit të shumices së

24 Raporti vjetor 2010 i Drejtorisë PPParave, fq. 54. Marrë nga faqia zyrtare e Drejtorisë PPP-ve.

shteteve se krim i pastrimit të parave përbën një kërcënim global, prandaj dhe kundërpërgjigjet ndaj këtij krimi duhet të jenë të bashkërenduara.

Pastrimi i parave të pista është një dukuri globale dhe me përmasa ndërkombëtare, prandaj bashkëpunimi ndërkombëtar bëhet i domosdoshëm duke patur parasysh lehtësinë me të cilën organizatat kriminale akumulojnë dhe transferojnë vlera të mëdha monetare nëpërmjet kufijvë ndërshtetërorë. Transferimi i flukseve financiare është sot i mundur drejt çdo cepi të botës. Nuk ka vende të përjashtuara nga rreziku i pastrimit të parave. Por, sistemet e kontrollit dhe këndvështrimi mbi pastrimin e parave, janë ende në nivele të ndryshme.

Krimi i organizuar dhe korrupsioni, përfshijnë lëvizjet ndërkombëtare të parave dhe pasurive, ashtu si dhe pastrimi i parave përbëjnë kërcënimin më të madh për zhvillimin ekonomik, stabilitetin politik, dhe ushtrimin e qeverisjes përfaqësuese. Ato janë fenomene ndërkombëtare, dhe si të tilla çdo përgjigje adekuate në thelb duhet të bazohet në bashkëpunimin ndërkombëtar, si shkëmbimin e informacionit, të dëshmive dhe ekstradimit e të të dyshuarit. Konfiskimi i fondeve të vjedhura nga zyrtarët e korruptuar dhe të fshehur jashtë vendit është një nga qëllimet më të rëndësishme të asistencës ligjore reciproke. Çdo shtet duhet të jetë i vetëdijshëm se pastrimi i parave është vazhdim i veprimtarive të tjera kriminale që mund të ndodhin në çdo vend të botës. Prandaj është e një rëndësie të madhe që pastrimi i parave duhet të ndiqet penalisht i lidhur me krime të tjera në çdo vend të botës.

Bibliografia:

1. Adrian Civici, "Globalizimi...ante Portas", UET-pres, Tiranë 2009.
2. Bedri Selmani „Globalizimi Transicioni dhe Integritet“, Zenit, Ljubljana-Prishtinë, 2006.
3. Veton Vula; "Kriminaliteti kompjuterik", Prishtine 2009.
4. Banka e Shqipërisë. Raporti_vjetor_2009_pagesat_3287_1.pdf.
5. *Corruption and Money Laundering: A Symbiotic Relationship* by David Chaikin and J.C. Sharman First edition: July 2009; Printed in the United States of America.
6. Naim Mëçalla, "pastrimi i parave kercenim per sigurine kombetare". Dita 2000-Pres. Tiranë 2007.
7. Raporti vjetor 2010 i Drejtorisë PPParave, fq. 54. Marrë nga faqia zyrtare e Drejtorisë PPP-ve.

8. Pavlo Lazarenko - Wikipedia, the free encyclopedia en.wikipedia.org/wiki/Pavlo_Lazarenko.
9. <http://www.unodc.org/unodc/en/money-laundering/globalization.html>
(akces date 12.09.2011)
10. http://www1.oecd.org/fatf/40_Recs_en
11. <http://institutivictory.org/?page=1,17,70>
12. <http://www1.voaneës.com/albanian/news/a-30-a-2004-12-15-3-1-85540192.html?moddate=2004-12-15>
13. <http://www.evropaelire.org/content/Article/1020095.html>
14. <http://www.unodc.org/unodc/en/money-laundering/globalization.html>
15. www.laundryman.u-net.com/.../operation_green_ice.html

GLOBALIZIMI DHE NDIKIMI I SAJ NË VLERAT ETIKE, NE KULTURËN E POPUJVE SI DHE PASOJAT E SAJ NE SJELLJEN E ADMINISTRATES PUBLIKE

Rita LOLOCI

Shkolla e Larte Private "Vitrina"

ABSTRACT

This approach aims to identify some problems related to the influence of the process of globalization in the daily life of the human civilization and especially in the effects of circulation of the life styles, symbols and moral of this process. Which are some of the consequences that the process of globalization in the values of ethic, in the cultural identity of the peoples, in the reaction of the public administration as a result of this process and have the fans of the globalization the right to unify the world, make it speak the same language, get dressed and have the same intimacy. Who gives the right of this alienation? What should the society do in front of this diversification of globalization? 1. to address museums of celluloid; 2. To return into a controlled robot; 3. to collaborate to fulfil this process protecting the qualities of each of them.

What this article points out has to do with today's tendency toward Americanism of the cultures of different populations, and the placement of the same models in the communications and behaviors between them.

Keywords: globalization, values, Albania, public administration

Drejt kulturës homogjene, amerikanizuese botërore

Sa etike është që globalizimi të të çojë drejt një kulture amerikane, apo në një homogjenitet kinez? Spektri i dominimit botëror të kulturës përmes shpërndarjes së konsumit përfundimor dhe ngritjes në rritje të shoqërive

materialiste ka shqetësuar shumë shoqërinë në mbarë botën. Frika e “perëndimorizimit” është shpesh e më shumë e theksuar. Mjaft herë kjo është quajtur si “Mekdonaldizim” shpërndarja e produkteve të standartizuara dhe sistemet e tyre të lidhura me kontrollin e biznesit. Eshkuziviteti i ushqimeve të kësaj firme është shoqëruar nga shumë shqetësime të tjera. Natyrisht, joshja që i ka bërë botës vetë firma është e paimagjinueshme dhe gjigandeske. Gjatë vitit 1991 ajo kishte hapur shumë restorante edhe jashtë SHBA-së. Në 1992, ndalesa e parë ka qenë në Kinë dhe shtrirja e saj në të gjitha vendet e botës ka qenë me shpejtësi të paparë. Mbështetur tek kjo shpërndarje e gjerë, ndikohej jo vetëm konsumizmi në SHBA por edhe dominimi kulturor ishte nje proces që ndodhte vetvetiu, i cili bëhej pjesë e identitetit të ketyre vendeve. Hannerz krijoi dicka të ngjashme duke folur për përhapjen e “Coca-cola”-s në botë[□]. Frika e “perëndimorizimit” ishte shumë e theksuar në Francë. Kur kjo firmë aplikoi për licensë për të filluar shitjen lokale në 1948, Partia Komuniste Franceze fitoi shumë mbështetje publike kur argumentoi që inkursioni i saj duhej rezistuar për shaka se u quajt si një rrjetë spiunazhi amerikan. Të tjerë përmendën që ajo paraqiste një kërcënim për civilizimin francez ose e observuar si propagandë naziste, pasi reklama e saj nxiste një efekt “dehës”.

Në qytetet komuniste ekziston një dyshim se mbërritja e produkteve si “Fast Food” e “Big Marc” ishin të mirëpritura ligjërisht vetëm në 1980. Ato paraqiteshin si simbolika të fuqishme që ofronin hyrje në lirinë perëndimore dhe si ‘shija e mirëfilltë amerikane’. Raste të tilla paraqitnin një pamje të jetës perëndimore me një barazi të qartë të kulturës botërore në “amerikanizim”. A janë këto thjesht shembuj ekstremë të një rrëmuje të zakonshme drejt kulturës perëndimore në botë? A janë këto arsye për të menduar që globalizimi i konsumit nuk do të coje drejt një bote homogjene, amerikanizuese?

Mbijetesa e kulturës vendore, shembulli i Tiranës

Kultura e konsumimit amerikan nga “Disnei” tek televizioni “Dallas” mund të jetë e pranishme në cdo kulturë në botë por çështja qendron te kufizimi. Disa breza që kanë kaluar eksperiencia kulturore migruse i kanë shpëtuar ekspozimit të konsumizmit intensiv. Kjo ndodhi nuk është e thjesht për t’u kuptuar, ndërkohë që disponueshmëria e “Fast Food”-ve në rrugët e Bombeit ose aftësia për të parë një film hollivudian në fshatrat e Egjiptit shkojnë detyrimisht në cënimin e traditës kulturore. Megjithese, disa banore të Malajzisë mund të

konsumojnë produkte perëndimore, kjo nuk do të thotë që ata anashkalojnë zakonet, familjet, detyrimet fetare ose identitetet kombëtare.

Unifikimi etik dhe kulturor në Tiranën e pas viteve nëntëdhjetë

Domethënia e ndryshimeve kulturore nga Perëndimi në Japoni, nga Lindja në Perëndim dhe nga vendet e Afrikës drejt Europës ka qenë re pranishme gjatë gjithë kohrave. Për këtë mund t'i referohemi shembujve të difuzionit kulturor, të cilat manifestohen në fenomene të tilla si kuzhina botërore kineze, italiane, franceze, aziatike etj. Një tjetër shembull është difuzioni i ilaceve aziatike tradicionale, praktikat shëndetsore të tilla si: Joga, Tai Chi, Shia Tsu, Meditim, Kimioterapi, Akupunkturë dhe disa ilace bimore. Një proces i njëjtë ka ndodhur edhe me artet marciale.

Po me kryeqendrën tonë Tiranënë, çfarë ka ndodhur? Përpyekja për të parë dhe kuptuar se çfarë ka ndryshura në këto njëzet – njëzet e një vite të tranzicionit të gjatë shqiptar, në kuptimin e marrëdhënieve të reja që janë krijuar në kryeqendrën e vendit, nuk është fort e lehtë.

Shqipëria që linte pas sistemin totalitar, ndoshta e fundit në gjithë ish Europën Juglindore dhe në Ballkan, pati shumë zhvillime të ngjashme me ish shtete e tjera nën regjimin komunist, por spikat edhe për disa veçori që ndodhën vetëm brenda shoqërisë së saj. Nga një ndalim total i lëvizjes së lirë, ku çdo gjë kontrollohej nga shteti, u kalua në një shpërngulje masive të popullsisë që jetonte në fshat pranë qendrave të mëdha urbane. Për shkak të një jetese disi më të zhvilluar në jug të vendit, vetkuptohet se dyndjet më të mëdha në kryeqytet do të ishin nga zona veriore dhe verilindore e Shqipërisë, pa përjashtuar edhe lëvizjet demografike që përfshinë çdo fshat dhe qytet. Kjo zhvendosje pati një kosto të madhe për shoqërinë shqiptare dhe u shoqërua nga probleme, konflikte dhe ngjarje të pandodhura dhe të paparashikuara më parë. Problemet ishin të shumta si ai shkollimit, i punësimit, i bashkëjetesës me pjesët e tjera të Tiranës. Masa e madhe e migrimit të popullsisë bën që të ketë një shpërbërje të sistemeve sociale fshatare dhe lidhjeve të ngushta familjare, të cilat para vitit 1990 ishin të forta, sepse udhëhiqeshin nga direktiva të forta paternaliste të shtetit që vepronin në mbarë popullatën. Të dhënat tregojnë se në vitin 1997 rreth 235.000 banorë (afro 50% e popullsisë së qytetit të Tiranës) banonin në zona me mungesë të theksuar infrastrukture¹. Këto të dhëna flasin

1 INSTAT Vjetari Statistikor 1991-1999,dhe 1993-2001, f. 35-36,

gjithashtu se migrimi i popullsisë rural në zonat urbane nuk e uli varfërinë, por ka kontribuar në zhvendosjen e varfërisë në zonat urbane.

Që të mund të jetojmë jemi të detyruar të punojmë

Si qenie biologjike dhe sociale varemi nga të mirat dhe shërbimet materiale dhe kjo jo vetëm për ruajtjen e egzistencës sonë (ushqim veshmbathje, banesë), por edhe për të zhvilluar një jetë dinjitoze kulturore. Çdo formë kulture presupozon fillimisht marrjen e masave për grumbullimin e të mirave materiale. Rrjedhimisht puna dhe ekonomia si “funksion kulturor, që shërben për të siguruar jetesën”, jep një panoramë të ngushtë të punës. Ajo nuk shërben vetëm për të siguruar jetesën, por është e dobishme edhe për vlerat e tjera të jetës njerëzore, pasi ajo synon të të zhvillojë një humanizëm të plotë. Sa më shumë zhvillohen kultura dhe qytetërimi, aq më shumë njeriu dhe organizmat shoqërore kërkojnë të mira materiale.

Si qendron mentaliteti i zonave rurale për femrat dhe aktivizimin e tyre në jetën shoqërore?

Mentaliteti i zonave fshatare për ta mbajtur gruan në shtëpi rezulton të jetë mbizotërues. Shkalla e punësimit të grave është shumë e ulët. Një pjesë e mirë e familjeve shqiptare në veri të vendit nuk kanë mundësi të punojnë dhe ato mbahen nga emigracioni. Por nuk është vetëm ky faktor që ndikon në papunësimin e gjerë të grave. Në fshatrat apo zonat e tyre, relativisht të vështira, puna dominuese për gratë ishte ajo në kooperativa që shpërndante varfëri të barbartë, por që tashmë këto njësi nuk egzistojnë më. Por nuk duhen përjashtuar edhe rastet kur gruaja bëhej “burri” i familjes, një dukuri kjo tipike shqiptare dhe që pati një vëmendje të veçantë nga një pjesë të konsiderueshme e shtypit perëndimor. Këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë “kapërcim ylberi”² apo për ndërhyrje kirurgjikale për të ndryshuar seksin. Qëllonte që, në mungesë të burrave në familje, për shkak fatkeqësish, një nga gratë më të rritura, detyrohej të priste flokët shkurt dhe të vishej si mashkull duke nënkuptuar në fshat se ajo përfaqësonte kryezotin e shtëpisë, personin që jepte urdhëra, që merrte përgjegjësi dhe që përgjigjej për gjithçka.

2 Dukagjini, Lekë; Shtjefën Gjeçovi, Leonard Fox, Kanuni, Kap 1, (1989)

Si rezultat i levizjes se popullsise, krahas qarkullimit te vlerave ndryshon edhe qendrimi i shoqerise per femrat dhe perfshirjen e tyre ne jeten shoqerore dhe ate politike. Ky ndryshim eshte reflektuar dhe ne ndryshimet qe ka pesuar legjislacioni shqiptar per perfshirjen e femrave ne parlament ne raportin e 30 %

Siç dihet globalizimi ka pasoja te medha ne lemin e kultures

Në lëmin e kulturës globalizimi shkakton qarkullimin e modeleve jetësore, te vlerave, te simboleve, perceptimeve, qendrimeve, besimeve, zakoneve kodeve morale etj. Ndryshimet tradicionale kulturore dobësohen apo shpejt hapen nga jashtë dhe bashkëpunojnë në këmbimin kulturor me pranimin dhe dhënien, ku paraqiten diversitetet e reja, fragmentimi i identiteteve, duke rezultuar me shoqëritë multikulturale. Për këtë çështje, globalizimi nuk sjell unifikim kulturor, por e shpejtëson zhvillimin e identiteteve hibride paralele që paraqiten globalisht (siç janë ato: klasore, gjinore, moshore, etnike, nacionale, politike, morale, religjioze etj). Identiteti kolektiv e përfshin komponentin dinamik dhe aktiv të aksionit kolektiv, me të cilën komuniteti i imagjinuar ripërtrihet pandërprerë. Individu si një konsumues kulturor është aktiv në kërkimin dhe riprodhimin e vlerave ku njëkohësisht bëhet krijues kulturor. Individët me refleksionin dhe subjektivizimin mund të çlirohen nga disa korniza shoqërore dhe kulturore. Për të gjithë këtë koncepti i imperializmit kulturor është i parëndësishëm.

Globalizimin në sferën e kulturës mund ta përfytyrojmë edhe përmes konceptit të postmodernizmit. Scott Lashi e përcakton postmodernizmin si një koncept brenda kulturës, artit dhe kulturës së jetës së përditshme. Me këtë, fusha e kulturës zgjerohet në fushë të shoqërisë masive, dmth se kultura nuk kuptohet më si një kulturë e lartë elitiste apo art elitist, por si një kulturë e popullarizuar, kulturë masive, si një jetë e rendomtë, e përditshme³.

Identitetet, që janë dimensionin kryesor i komuniteteve etnonacionale, janë të përqendruara te pjesa e interiorizuar shpirtërore ku lëvizjet janë më të ngadalshme dhe ku dinamika afatshkurtër është më e dobët se ajo rrjedhëse. Dukuritë e tilla, për njeriun si një qenie sociale, antropologet i sqarojnë si nevoja të pazëvendësueshme, që në rrethana të shekullarizimit me plot sukses mund t'i kënaqë identiteti etno-nacional. Kjo me një hapësirë relativisht të ndarë dhe të përkufizuar, me kujtesë historike dhe mitologji të “prejardhjes” e cakton

3 *Post-Structuralist and Postmodernist Sociology*, Sussex, Edward Elgar, 1991 (edited) f 38

komunitetin si një veçori në dallim nga fqinjët e tij. Individit i ndihmon në zënie të pozitës, duke i garantuar ekzistencën dhe sigurinë sociale.

Nga aspekti i retrospektivës sociologjike rëndësi ka të shqyrtohet çështja e autonomisë individuale duke u nisur nga fakti, se si individi pavarësohet në kalimin nga bashkësia tradicionale (lokale) në bashkësi moderne. Poqese individi lejon që rrethi t'i përcaktojë mënyrën e jetës dhe akceptimit politik të sistemit në të cilin vegjeton, nuk i nevojitet gjë tjetër përpos të ketë aftësi të imitimit. Vetëm me ata që individi për zgjedh mënyrën e jetës, me ta forcon mundësinë e aftësive të tij. Nga aspekti i individualizimit, sa më i lartë është ai, pozita e individëve dhe kolektivitetit i përcaktuar me përkatësi është më i vogël. Sa më tepër që e shpjegon rrethi karakteristikën e subjektit konkret, aq më e vogël është e arritur shkalla e arritjes së individualizimit.

Për të gjitha shpjegimet e çështjes së autonomisë individuale dhe demokracisë politike është karakteristike se shumica përkufizohen në ndryshimet brenda kornizave shtetërore nacionale. Mirëpo në praktikë ka ndodhur që kufijtë në ndërlidhje paraqiten si kufi të pavarësisë të subjekteve përfaqesuese. Për atë shkak nuk mund të presim se procesi i ardhshëm i demokratizimit do të zhvillohet si proces endogjen brenda kufijve shtetërorë. Këtu shtrohet pyetja mbi argumentimin e dy interpretimeve të ndryshme të këtij procesi.

Në këto kushte hapet fusha e metafizikës etnonacionale, i dimesionit të pafundshëm të ekzistimit në mes të përkatësisë së komunitetit, besimit, kuptimit dhe ndjenjave të anëtarëve të komunitetit. Për shkak të këtyre lidhjeve psikike dhe metafizike, që i krijojnë identitet etnonacionale, edhe sot e kësaj dite ato janë ndër identifikimet më të rëndësishme të rendit shoqëror dhe solidaritetit shoqëror si dhe të ekonomisë morale.

Identitetet etno-nacionale në shoqërinë "e rrezikut postmodern" i përmbush disa funksione të nevojshme të njeriut si qenie sociale. Përparësia e tyre subkulturore qëndron në faktin se identiteti ka rëndësi të veçantë për vazhdimesinë e saj, e jo sasia e tij. Smithi në shembullin e grekëve tregon se si mundet identiteti të jetojë përkundrejt "plasaritjeve - ndarjeve" të shumta demografike, territoriale, politike dhe ndarjeve të shumta historike⁴. Nëse ekziston besimi në vazhdimësi të bashkësisë, identiteti i saj forcohet varësisht nga dinamika e globalizimit kulturor. Është e vërtetë se identiteti etno-nacional nuk është ekskluziv, nuk është gjithmonë përcaktues dhe nuk e ka domethënien e një kulture homogjene, mirëpo në rrethana të globalizimit bëhet aktual dhe depërton në qendër të vëmendjes, si një "komunitet i imagjinuar" latent kur i kanoset rreziku. Në këto komunitet vendoset një raport superioriteti i imponues

4 A. Smith National identity, fq. 16 dhe 160-161.

i shteteve me te fuqishme te cilet drejtpedrejt dhe indirekt i detyrojnë vendet e pazhvilluara te ndryshojne modelet e jetes se tyre duke vendosur nje lloj pushtimi te bute.

Sociologu i njohur Grams në “Selektimet nga fletoret e burgut” të cituar prej Hall dhe Jefferson, e përdor termin “hegjemoni” për t’iu referuar momentit kur klasa sunduese është në gjendje që të detyrojë klasat e nështruara që t’i përshtaten interesave të saj, por të ushtrojë “hegjemoninë” apo “autoritetin total social” ndaj tyre⁵.

Tek “Sociologjia”⁶ e Ian Robertson thuhet se burim i ndryshimit, e ndonjëherë edhe i tensionit brenda kulturës, rrjedh nga ekzistimi i grupeve që nuk marrin pjesë plotësisht në kulturën përcaktuese të shoqërisë. Këto grupe janë të zakonshme sidomos në shoqëritë e mëdha, të industrializuara, në të cilat ka dallime të mëdha kulturore brenda pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme regionale, religjioze e të profesionit. Dihet se grupet të cilat ekzistojnë brenda shoqërisë së njëjtë dhe që ndajnë kushte të njëjta materiale dhe historike pa mëdyshje se kuptojnë dhe deri në një masë edhe ndajnë “kulturën” e njeri - tjetrit. “Kultura” e grupit apo klasës është mënyra karakteristike dhe e dallueshme e jetesës që e dallon grupin apo klasën, kuptimet, vlerat dhe idetë e mishëruara në institucione, në raportet shoqërore, në sistemin e besimeve, në zakonet dhe normat, në përdorimin e objekteve dhe jetës materiale”. (Hall&Jefferson, 1993). Kultura përfshin “hartën e domethënies” (Hall&Jefferson) që i zbulon gjërat para pjesëtarëve të saj. Këto “harta të domethënies” nuk barten thjesht vetëm në kokat tona, por ato janë të objektizuara në modelet e organizimit dhe marrëdhënieve shoqërore përmes së cilave individi bëhet “individ shoqëror”⁷.

Udhëkryqet e globalizmit dhe individi; vështirësitë në komunikim postmodern

Dallimet në race, në fe, në gjuhe, ato ideologjike, mënyrat e ndryshme të organizimit shtetëror dhe shoqëror, niveli i ndryshëm i kulturës, emancipimit dhe i zotërimit të teknologjisë, pra, identitetet në një botë të ndryshme, shpesh bëhen burim konfliktualiti në vend që të jenë motiv plotësues apo kompensues. Në vorbullen e zhvillimit të shoqërisë njerëzore këto dallime kanë krijuar paragjykime, të cilat kanë ushqyer dhe janë shërbyer nga kastat politike si

5 Grams “Selektimet nga fletoret e burgut” të cituar prej Hall dhe Jefferson, f.95

6 “Sociologjia” e Ian Robertson f.123

7 “Selektimet nga fletoret e burgut” Hall dhe Jefferson, f. 12

psikoza kolektive për përplasje dhe ballafaqime, deri në luftra rajonale dhe botërore. Përvojat e imperializmit, fashizmit dhe komunizmit shkaktuan tragjedi jo të vogla. Tejkalimi i këtyre praktikave historike, e ka shpënë shoqërinë e sotme njerëzore përballë një alternative dhe dileme të re, që nga filozofët dhe antropologët e sotëm emërtohet si globalizëm me shfaqjet e saj në ekonomi, kulturë dhe politikë.

Zhvillimi i jashtëzakonshëm i teknologjisë (po flitet për zhvillimin e turizmit hapësinor), relativizimi i kufijve dhe mjetet e jashtëzakonshme të komunikimit (po instalohen autostadat e informacionit), liria e lëvizjes (emigracioni), përfundimi i “luftës së ftohtë”, fenomeni i socialdemokracisë si një “e mesme e artë” për të djathtën dhe të majtën klasike, shenjtërimi i “te drejtave te njeriut” si një besim dhe projektim i së ardhmes, euromonedha dhe erurokultura, etj., kanë krijuar një bazë të fortë për globalizimin si rendin e ri botëror në milleniumin e tretë.

Por me gjithë këtë zhvillim, përsëri dilema dhe kundërshtia mbetet; është po ajo dilemë që ka ekzistuar qysh në gjenezë të qënies njerëzore, dilema dhe konflikti midis individit, grupeve të individëve dhe shoqërisë në tërësi, dallimi midis së përveçmes dhe të përgjithshmes, midis identitetit dhe anonimatit, midis trashëgimisë, historisë dhe cilësisë së re. Problemi mund të shtrohet thjesht në formën nëse do të zhvillohemi si identitet apo do të tjetërsohemi, duke u kthyer në anonimat? Mbi ç’moral justifikohet ky tjetërsim dhe a na lejohet të bëhemi “tjetër” ose “tjetri”? Mos vallë, po vjen një kohë, që historinë dhe identitetin toë do ta fusim në muze, kur për të parë një shqiptar, një grek, një rumun apo një serb do të presim një biletë për në muzeun e ardhshëm të kombeve të zhdukur? Mos vallë, për të dëgjuar gjuhën shqipe, do të duhet të hapim kasetofonët apo të zhvillojmë celuloidët, duke patur nevojën e një përkthyesi? Cfarë do të jenë banorët e kësaj toke: europianë, atlantistë apo kinezë? Ndoshta, pas shume kohësh, të gjitha këto shqetësime, i gjithë ky ankth “nacionalist” do të konsiderohet një paragjykim i kotë ose një anakronizëm. Nuk është çudi që kjo të dalë pikërisht kështu. Për njeriun e ardhshëm do të mjaftojë si kartë identiteti vetëm shenja e gishtrinjeve në kompjuterat e stacioneve të policisë ndërkombëtare. Ballkani dhe veçmas Shqipëria janë një shembull klasik i frenimit të historisë dhe i përplasjeve të forta të saj. Atdheu i demokracise europiane dhe i mjaft personalitetet të shquara, pra Ballkani është bërë sot sfida e realizimit të projektit evropian dhe i rendit të ri.

Hapësira kulturore shqiptare ka qëlluar në kryqëzim të kulturave dhe qytetërimeve. Ky ka qenë fati historik i saj. Në historinë e largët shqiptarët ishin të krishterë, ndërsa aktualisht fetë kryesore të instaluara janë muslimanizmi,

(bektashizmi), ortodoksia dhe katolicizmi. Megjithatë, në Shqipëri nuk është verifikuar asnjë luftë apo përplasje me karakter fetar.

Përkundrazi, midis të tri besimeve fetare ka ekzistuar një mirëkuptim dhe bashkëjetesë tradicionale. Feja për shqiptarët nuk ka atë domethënie dhe vlerë që ka për serbët apo grekët, të cilët e lidhin fenë me përkatësinë kombëtare. Element thelbësor kulturor për identitetin e shqiptarit janë gjuha dhe folku. Duke qenë në udhëkryq të Lindjes dhe Perëndimit, në pikëpamje të kulturës, shqiptarët kanë përfituar, por edhe e kanë pësuar nga trusnia e kulturave të tjera, duke qenë se ndikimi ka pasur një prapavijë të qartë asimiluese, me synimin për t'i zhbërë shqiptarët etnikisht, politikisht dhe ekonomikisht.

Ndikimet nderkulturore

Në kohën e sotme, për shkak të hapjes dhe prirjeve globaliste, po ndodh një intensifikim i ndikimeve nderkulturore. Më pare kultura shqiptare ndikohej prej fqinjësisë, pro tashmë ka ndryshuar rrënjësisht koncepti i fqinjësisë. Nuk flitet më vetëm për komunikim të drejtpërdrejtë, por për komunikim në distancë. Nocioni i tele-distancës, lëvizja e lirë e njerëzve ka ndryshuar skemën e ndikimeve. Në këtë kuptim, kultura shqiptare sot është më shumë fqinje me kulturën amerikane se sa me atë italiane, greke, turke apo sllave, sic ka qenë tradicionalisht. Vjen puna deri tek çështja se çfarë e rrezikon tipologjinë e kulturës dhe të qytetërimit shqiptar: zona e kontaktit - sic shprehet Huntington, apo zona e tele-kontaktit. Masivizimi i këtij fenomeni, trajtimi i emigrantëve shqiptarë në Greqi dhe Itali si "ekstrakomunitarë", shfaqjet e ksenofobisë dhe të racizmit ndaj tyre, ndërkohë ka sjellë reagimin e kundërt; ringjalljen e ndjenjave nacionaliste tek vetë shqiptarët. Rreziku i kulturave të vendeve të vogla nuk është vetëm problem i kulturës shqiptare. Ky është edhe problem i kulturave të mëdha. Një prej botimeve që ka pasur më shumë vëmendje kohët e fundit në Francë është titulluar: "Parlez-vous franglais", që, për situatën tonë, do të pershtatej pak a shumë "A flisni shqip-aglisht". Problemi ndërlikohet nga fakti se vetë individi sot është në hall, sepse detyrimisht duhet të zgjedhë midis etnocentrizmit dhe eurocentrizmit apo atlantizmit, sic thuhet rëndom. A ka humbur vlera e etnocentrizmit? A ka më hapësirë në këtë botë për kulturat e vogla? A do të jetë e pajtuar bota e ardhshme me tretjen e parashikuar të këtyre kulturave në shtete qytetërime të vetme?

Dilema ndërmjet etnocentrizmit, eurocentrizmit, kozmopolitizmit dhe orientimeve të tjera kulturore mund të shkaktojë kriza të mëdha të identitetit

të njeriut. Në këto dilema njeriu i thjeshtë nuk duhet të lihet i vetëm dhe në udhëkryq. Për fat të mirë a për fat të keq, Shqipëria ndodhet në udhëkryq edhe nga pikëpamja gjeopolitike.

Ka dicka që na bën të gjithëve të afërt me njeri- tjetrin. Janë dhjetra situata e detaje, krejtësisht tonat, që kanë shenjuar një pjesë të rëndësishme të jetës ose formimit shqiptar. Kaq të vecanta dhe të ndryshme nga cdo situatë ose detaj që kishte shenjuar formimin e një populli, ose disa popujve në të njëjtën epokë me atë tonën.

Globalizimi sjell kultura të reja, sjell njohuri të reja, mund të sjell koncepte të ndryshme nga ato të një vendi por gjithmonë i lë rrugë të hapur zgjedhjes. Mirëpo vende konservatore dhe të prapambetura në këtë aspekt, nuk duan fare që këto opsione të ekzistojnë dhe që publiku apo konsumatori të bëjë zgjedhjet e tij. Pra Irani nuk e lejon videotekën me filma pornografikë të hapet në vendin e tij. E njëjta ndalesë ndodhte në Shqipëri në kohën e regjimit totalitar; të tjera ndalesa kishte në gjysmëbotën komuniste.

Ndikimi i globalizimit ne modelet e qeverisjes dhe ndryshimet te shkatuara nga proceset integruese

“Global Governance mes utopisë dhe domosdoshmërisë „Global Governance“ nuk është një projekt romantik për një ‚botë të vetme‘ të shëndetshme, por një përgjigje realiste ndaj sfidave të globalizimit “, kështu argumenton Franz Nuscheler. Konceptet e Global Governance përpiqen të gjejnë linja zgjidhjesh për problemet ndërkombëtare⁸.

Si duhet të funksionojë bashkëpunimi global në mënyrë efektive, nëse Shtetet e Bashkuara, si pushtet hegjeomonal, të kërkojnë gjithnjë e më tepër të ecin vetëm, p.sh. duke dalë nga Protokollin e Kyotos, çka do të thotë një goditje e rëndë për përpjekjet në ndërtimin e një mbrojtjeje të klimës? E kush duhet ta koordinojë bashkëpunimin e shteteve, sipërmarrjeve? Po edhe nëse do të mund të koordinohet një bashkëpunim efektiv: përmes kujt legjitimohen vendimet? Global Governance duhet të jetë në të njëjtën kohë efektive dhe demokratike. Të dyja këto kërkesa bazë ndërtojnë një raport të tendosur me njëra tjetrën.

Modelin më të përparuar të bashkëpunimit mes shteteve dhe shoqërive e shohim te Bashkimi Evropian (BE), i cili mund të vlejë edhe si laborator për Global Governance. Në kuadër të BE-së mund të shihet mjaft qartë dilema e tematizuar mes eficiencies dhe demokracisë, ku duhet mbajtur vazhdimisht parasysh, që ngjashmëria mes shteteve evropiane është natyrisht shumë më e madhe se sa është standarti botëror.

8 Franz Nuscheler Global Governance

Global Governance si përgjigje ndaj problemeve globale

Kështu, integrimi evropian përcaktohet si një përgjigje sukses-premtuese ndaj sfidave të globalizimit. Politika e organizuar, sikurse edhe më parë, kryesisht në nivel territorial dhe në kuadrin e shteteve kombëtare, ka mbetur prapa në krahasim me ekonominë e organizuar gjithnjë e më tepër në mënyrë ndërkombëtare apo globale, e çliruar nga kufijtë dhe materia. Vendosja e kapitalizmit në "shtratin" e një shteti social, kërcënon të dështojë në këtë çbalancim raportesh bazë. Por jo për gjithçka, për çfarë qortohet globalizimi, është vërtetë ai përgjegjës. Shpesh ai shërben për politikanët si kokë turku dhe armë argumentimi për të justifikuar qëllimet apo gabimet e tyre madhore.

"Aspekti politik i Globalizimit Si një term kyç, në fakt i ri por i gjithëpranishëm, globalizimi instrumentalizohet në funksion interesash të ndryshme. Ndaj njohja e këtyre proceseve duhet të shkojë shumë larg, përtej të kuptuarit më të mirë të diskutimit rreth globalizimit. Ky fenomen është duke e çuar botën drejt integritimeve ekonomike e socio-kulturore me përmasa botërore, të cilat nuk kanë ndodhur kurrë më parë në përmasa të tilla në historinë e njerëzimit. Shumë analistë në botë, kur flasin për globalizimin, shpesh potencojnë se globalizimi është një proces human me perspektivë dhe si i tillë është i pashmangshëm. Mirëpo, si çdo fenomen i madh, edhe ai ka dobësitë dhe problemet e veta, që i kategorizon njerëzit në përkrahës dhe kundërshtarë të globalizimit.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e proceseve të globalizimit, nuk na befason fakti se ndjenjat e njerëzve kundrejt globalizimit janë më të ndryshme dhe ndër të tjerash në kundërshtim me të. Në një pikpamje kemi pajtim të plotë mes simpatizuesve dhe kundërshtarëve të globalizimit: Globalizimi as që mund të ndalet apo në çfarëdo mënyre të kthehet mbrapa.

Bibliografia

1. M. Waters: Globalization.
2. C. Barker: Global Television
3. S. Lash: Sociologji postmodernizma;
4. A. Smith National identity, fq. 16 dhe 160-161.
5. Smith: National identity, fq. 28-29. fq. 174.
6. Waters, Malcolm: Globalisation. Routledge. fq. 145 dhe 156.
7. Arblaster, Anthony (1999). "Unity, Identity, Difference: Vol. 21. No. 2:195
8. Bell, Daniel (1995). "Ethnicity and Social Change".
9. Grams "Selektimet nga fletoret e burgut" të cituar prej Hall dhe Jefferson, f.95
10. "Sociologjia" e Ian Robertson f.123
11. "Selektimet nga fletoret e burgut" Hall dhe Jefferson, f. 12
12. INSTAT Vjetari Statistikor 1991-1999, dhe 1993-2001, f. 35-36, Tirane 2002 dhe 2003
13. Dukagjini, Lekë; Shtjefën Gjeçovi, Leonard Fox, Kanuni, Kap 1, (1989)

KULTURA KOMBËTARE SI IDENTITET

Tonin ÇOBANI

Instituti Shqiptar i Sociologjisë

ABSTRACT

This article focuses on three important concepts : identity, nation and culture. Each of these concepts requires long and specific definitions, each on its own. All three are in each case subject to longer discourses, each on its own or binomial: national culture, cultural identity and national identity.

Keywords : identity, nation, culture

Në titullin e kumtesës sime janë tre koncepte: *identiteti, kombi dhe kultura*. Të tre do të kërkonin që në krye përkufizime të gjata, secili më vete. Të tre janë në çdo rast objekt diskursesh edhe më të gjata, secili më vete ose në binomet: *kulturë kombëtare, identitet kulturor dhe identitet kombëtar*. Te gjitha këto prof. Martin Berishaj i ka shtjelluar me kompetencë dhe në mënyrë shteruese në pjesën e parë të librit të tij *Shteti dhe identiteti*, ku ai ka shpërfaqur gjerësisht teoritë më të fundit bashkëkohore për këto nocione.

Nga ana tjetër, dua të shtoj se kumtesa ime që në titull mbart diçka të papërcaktuar krejtësisht. *Kultura kombëtare si identitet*, duhej të vazhdonte: *si identitet i kujt? apo si identifikim me kë?* Në gjuhën e prof. Berishës, ky titull mund të plotësohej: *si identitet i njerëzve*, i cili kurdoherë, si shprehet ai, citoj: “është i pasigurt, i pashpjeguar” (Berishaj 180)¹.

Unë nuk mendoj se duke i trajtuar si një term të vetëm të tre konceptet e lartpërmendura, në formën: *identiteti kulturor kombëtar apo kultura kombëtare si identitet*, do ta kem më të lehtë të ftilloj një domethënie të pathënë më parë apo diqysh në atë vepër. Mendoj vetëm të rikonstruktoj atë piramidë të rrënuar të

shqiptarizmës, me bazë trekëndore (*kulturën kombëtare, identitetin kulturor dhe identitetin kombëtar*) dhe kulm: *identitetin shqiptar*. Edhe secili prej këtyre cepave të piramidës sonë të hipotezuar, do të përbënte në vetvete, në mos tjetër, shkak debatesh, si ka ndodhur prej vitesh, e deri në ditët tona po ndodh në mes Ismail Kadaresë, Rexhep Qoses e grupimeve të tjera, aspak për t'u nënvlerësuar në agresivitetin e tyre përjashtues të mendimit të tjetrit për këto çështje. Ndoshta, edhe i nxitur prej këtyre debateve për identitetin shqiptar, më së pari, do të shtroj pyetjen:

Përse *kultura kombëtare si identitet* dhe jo një tjetër, ta zëmë, politika (kombëtare), religjioni (kombëtar), etnia (kombëtare - nuk e di me siguri nëse jam i saktë, duke i pranëvënë epitetin "kombëtar" fjalës "etni"-) apo diçka tjetër?

Përgjigja do të vinte kështu: Një komb mund të përbëhet nga disa etni ose, më saktë, në kulturën kombëtare mund të kontribuojnë, më pak a më shumë, disa etni. Rasti shqiptar e dëshmon këtë pohim mjaft qartë. Rasti shqiptar shpjegon, gjithashtu, mjaft bindshëm edhe faktin se një komb mund të përbëhet edhe nga disa religjione, të cilët, nga ana e tyre, mund të kontribuojnë, njësoj ose jo, në kulturën kombëtare. Veçse rivalitetet ideologjike të religjioneve mund ta përçajnë kombin dhe të ndikojnë me mbishtresime kontradiktore të panatyrshme kulturën kombëtare. Madje, kur ideologjitë e religjioneve janë bashkuar me politikat shoviniste të shteteve pretendente, njësi të tëra kombëtare janë asimiluar krejtësisht dhe kulturat kombëtare të atyre njërive janë bërë relike të identiteteve të tjera kombëtare. Historia e shqiptarëve e dokumenton këtë gjë me fakte të dhimbshme qysh nga ilirët e deri në kohët moderne. Madje, duhet shtuar, se vazhdon ta ndiejë këtë agresivitet asimilues si rrezik permanent edhe sot e kësaj dite. Kjo edhe për shkak të politikave të mbyllura kulturore rreth njëshekullore, qysh kur u krijua shteti shqiptar, që mbulonte një pjesë të territoreve të banuara nga shqiptarë autoktonë.

Është vendi të përmendim këtu se identiteti shqiptar u kërkua në kulturën specifike të shqiptarëve si identitet kulturor, ende pa u krijuar shteti shqiptar e, ndoshta, ende pa u kristalizua nocioni *komb shqiptar*. Narracioni: Në Perandorinë Osmane jetonte një popull ballkanik që fliste një gjuhë të ndryshme nga turqishtja e osmanishtja edhe nëse ajo popullatë i përkiste besimit mysliman; një gjuhë të ndryshme nga greqishtja dhe sllavishtja, edhe nëse i përkiste besimit ortodoks; të ndryshme nga latinishtja e derivatet e saj në Mesdhe, edhe nëse ishte katolike. Ai popull tribesimesh përcillte historinë e vet që kur historia s'mbahej mend, kishte doket e zakonet e veta tradicionale, ruante mitet e veta origjinale dhe trashëgonte një folklor të pasur, që gjallonte fuqishëm ndër

pleq e të rinj, ndonëse ende i pashkruar, i pasistemuar dhe pa institucionet përkatëse kulturore, si i kishte bota e qytetëruar përreth. Ky popull e njihte veten me emrin *shqiptar* qyshkur Pirrua i Epirit u quajt shqiponjë e luftëtarët e tij - krahët e saj, të shqiponjës, pra.

Në këtë pikë të argumentimit tim, e ndiej se shumë nga ju po pëshpëritin nën buzë: ky narracion është patriotizëm romantik. Keni të drejtë. Edhe unë kështu mendoj. Por ju sugjeroj të pranoni edhe ju, si e kam pranuar tashmë edhe unë, se shkencat tona albanologjike ende nuk e kanë kapërcyer këtë nivel romantik në studimet kombëtare kulturologjike. Ato ende nuk e kanë kapërcyer esenë e Pashko Vasës *Shqypnia e shqyptarët*, publikuar në Alfabetaren e Stambollit në vitin 1879.² Ajo ese u botua po atë vit në: frëngjisht, anglisht, gjermanisht, turqisht e greqisht, dhe më vonë edhe në arabisht e italisht. Dhe s'kishin si ta tejkalonin studimet tona kulturologjike atë ese të Pashko Vasës kur asnjëherë nuk u ribotua e plotë deri në 2010-tën (është fjala për ribotim të pacensuruar). Të gjithë studiuesit e institucioneve tona shkencore, të Tiranës dhe të Prishtinës, kanë preferuar ta paraqesin atë vepër fundamentale të Rilindjes sonë Kombëtare jo si ese, por thjeshtë si një studim historiko-romantik të tejkaluar në kohë, pasi, sipas tyre, shkencat historike ka bërë përpara me teza e fakte të akademikëve të Ballkanit (unë në këtë formulim asnjëherë nuk kam arritur t'i kuptoj "akademikët" shqiptarë), që argumentojnë edhe sot e kësaj dite se Kosova është "djepi i Serbisë", ashtu si në kohën e Pashko Vasës, Epiri konsiderohej "djepi i helenizmit", madje jo vetëm Epiri i vjetër, por edhe Epiri i Ri, që vinte deri mbi Shkumbin, ndërsa shqiptarët : endacakë pa truall, "*pa histori, pa letërsi, pa asnjë përparim dhe pa vetëqenie kombëtare*"³.

Krijimi i një shteti tjetër me shumicë shqiptarë në trojet e tyre, si është Kosova, mbas gati një shekulli, paralajmëron një dukuri tjetër specifike të rastit shqiptar, për sa i përket argumentit *përse kultura kombëtare si identitet e jo politika kombëtare si identitet*. Në aspektin teorik, prof. Martin Berishaj, (Berishaj, 29,32), e parashtron këtë dukuri (që vjen natyrshëm si vetëdijësim subjektiv) të lidhur me pyetjen: *Kush jam unë?*, pasuar më tej me: *Prej nga vi unë?* dhe *Cilën të ardhme do të zgjedh unë për veten time?* Identiteti që buron prej këtyre pyetjeve e parakupton edhe grupimin social ose, së paku, nuk e përjashton ekskluzivisht atë. Ndërsa nuk mund të zëvendësohet *unë* me *na*, sepse nga pyetjet: *Kush jemi na?* *Prej nga vijmë na?* dhe *Cilën të ardhme do të zgjedhim na për veten tonë?*, identiteti mund të prodhojë fare lehtësisht përjashtimin në kundërvëniet *ne-ju të tjerët afër nesh* dhe *ne-ata të tjerët diku më larg*. Rasti shqiptar i vërteton këto. Pas Luftës së Dytë Botërore në Tiranë filloi të flitej me *ne, shqiptarët e ju, kosovarët* apo me *ata, për shqiptarët e Kosovës*. Në Prishtinë vazhdohej me kush *jam unë*.

Tani edhe në Prishtinë kanë filluar të flasin me *na të Parlamentit të Kosovës, Na, shkrimtarët e artistët kosovarë* dhe, nuk dua të bëj parashikuesin ogurzi, kur të përplasen kombëtares e sporteve të ndryshme të të dy shteteve shqiptare, nuk e di se si do t'i vejë halli identitetit të munguar politik (kombëtar). Prandaj ndër shqiptarë duhet ffilluar prej së vërteti kultura kombëtare si identitet.

Rruga e integritimit evropian (disa duan ta quajnë të integritimit euro-atlantik) ka vënë në garë qysh tani të dy shtetet e shqiptarëve, Shqipërinë dhe Kosovën: cili do të jetë identiteti i tyre evropian? Ndërsa, për të njëjtën pyetje, është zgjuar interesimi edhe te shqiptarët në Mal të Zi, Maqedoni, Serbi e Greqi (në Greqi bëhet fjalë, si për shqiptarët autoktonë të Epirit, ashtu edhe për emigrantët e vendosur aty pas viteve '90).

Evropa është një kontinent i konsoliduar veçmas kulturalisht dhe, në qoftë se do të flitej për identitet evropian, ai identitet gjendet në kulturat kombëtare të popujve të saj. Evropa është shumësia e gjuhëve dhe e kulturave kombëtare, me një fjalë, është një mozaik ngjyrash të ndryshme që identifikon të gjithë hartën e kontinentit. Nëse dikush do të mendojë se gjuha shqipe dhe kultura shqiptare, rrjedhimisht edhe identiteti kulturor shqiptar, nuk çojnë ndonjë peshë në epokën e sotme të integritimit, e ka gabim. Çdo mozaik ka ngjyrat e veta më të dallueshme apo më pak të dallueshme. Nëse mungon një ngjyrë, qoftë ajo edhe më anësorja, mozaiku do të quhet i dëmtuar: do ta humbasë tërësinë, bukurinë që buron nga tërësia e ngjyrave të veta. E, pra, nëse ne do të bëjmë që gjuha dhe kultura shqiptare të shkasin, nuk do të humbasë vetëm identiteti ynë, por do të dëmtohet edhe identiteti i mozaikut të gjuhëve dhe kulturave evropiane. Në këtë këndpamje *kultura kombëtare si identitet*, është edhe identitet evropian.

Gjithnjë, duke pranuar kompetencën e trajtimeve teorik të thella të autorit të librit "Identiteti dhe shtetësia", u përpoqa të përvijoj, pikërisht, atë domethënie që merr identiteti kulturor, rasti shqiptar, në kohën tonë. Piramida e kulturës kombëtare ose, thjesht, gama e ngjyrave të kësaj kulture në mozaikun evropian, përbën vlera sa kombëtare po aq edhe universale, sepse janë vlera njerëzore, sado të *pasigurta e të pashpjegueshme* të mbeten.

Bibliografia

1 Martin Berisha, "Identiteti dhe shtetësia", Kolegji Universitar "Victory", Prishtinë, 2010 (PDF).

2 Kur Pashko Vasa shkruan se "emërtimet Epir, Maqedoni dhe Albania... janë emra fare të panjohur për ta (për shqiptarët) dhe pa asnjë domethënie në gjuhën e tyre", redaktori shkencor ndërhyr me këtë vërejtje kinse objektive: "Këto shpjegime

pjesërisht sot nuk qëndrojnë. Rrënjët e emërimit Albani-a ndeshën qysh te vepra e gjeografit aleksandrin të shek.II, Klaud Ptolemeu, si emër i fisit albanoi që banonte në trevën midis Durrësit e Krujës, kurse trajtat Arbanon, përmendet që në shek.XI nga shkrimtarët bizantinë Mihal Atalati dhe Ana Komnena. Në shek.XI trajta mesjetare Arbëni, arbër, arbëreshe nuk qenë krejt të panjohura në Shqipëri. Ata përdorshin në këngët popullore dhe nga arbëreshët e Italisë (shën. i red.), Në librin, Pashko Vasa, Vepra letrare 1, Tiranë, 1987, shënim i f.78.

3 Për më tepër shih: Jani Vreto, "Apologjia kundër artikullit "Epiri, djepi i helenizmit, Shqipëria!!!", Stamboll, 1878. (Cituar nga Jani Vreto, "Apologjia", përkthye prej greqishtes nga Niko Çani, f.181, në Jani Vreto, "Vepra të zgjedhura", Tiranë, 1973, f.175-229).

IDENTITETI KOMBETAR PERBALLE GLOBALIZIMIT- RIKONCEPTIM I EDUKIMIT TE ADOLESHENTEVE

Zhulieta DEMI

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës

ABSTRACT

This article attempts to explain the problems that arise in transition the formation of teens personal and ethnocultural identity. Based on changes in social, economic, cultural of our society, restructuring of the Albanian family, economic migration, cultural or of different nature have become more complex formation of national identity among young people, therefore the education system must find more sophisticated ways to teen-oriented to the challenges of global culture. Globalization is seen as the approach to economic, cultural, social is a positive phenomenon and compare the development in our countries to emerge from totalitarian societies, seen as the expansion has produced conflicts of insecurity job and insecurity for the future in different countries. This article explores the characteristics of the behavior and limitations of education to adolescents about the concepts of responsibility problems of community, national, regional and global.

Keywords: Personal identity, national identity, globalization, cultural values, fierce nationalism, the nature of psychological manipulation, new concept of education

1. Identiteti etnik është një koncept i vetë-zgjedhur, i bazuar në përvojat brenda dhe jashtë familjes. Etniciteti i referohet një karakteristike të veçantë të traditës së përbashkët unike kulturore dhe një trashëgimie që vazhdon në të gjithë brezat. Identifikimi etnik është përcaktuar si një njohuri për veten brenda një grupi të caktuar, e cila është pasuar nga një ndjenjë e madhe respekti dhe krenarie, dhe kjo përbën një bazë për zhvillimin e një vetë konceptit të shëndetshme. (DeVos & Romanucci-Ross, 1982). Identiteti përcaktohet nga

karakteristikat intrapersonal ndërpersonale, mjedisore dhe ndërveprimet e komponentëve të rëndësishme të botës unike të një individi (Bronfenbrenner, 1979, teoria e sistemeve).

Zhvillimi i identitetit etnik

Identitetit etnik është pjesë përbërëse e indentitetit personal. ai përfaqësohet nga element si gjuha, territori, simbolet, mitet, heronjet, ngjarje të rëndësishme, arti, letërsia, sportet, feja, zakonet, mënyrën e jetes. Identitetit etnik është thelbësor për funksionimin psikologjik të individit, ai shkrihet me egon personale dhe bëhet pjesë e qenësishme e individit, një identitet që zhvillohet nga brenda, si një imazh që imponohet nga stereotipet e shoqërisë. Përkatësia në një etniteti të caktuar shpesh është një ndjenjë krenarie, apo dhe një burim konfliktesh (Maldonado, 1975, Rotheran & Phinney (1987)

Identitetit etnik është kompleks, ai përmban një pjesë që individi merr nga grupi që përfaqëson, por është i lidhur me kapacitetin individual të individit, që shërben për fuqizimin e vetes dhe për të përfaqësuar etnicitetin në mënyrën më konstruktive. Identiteti etnik fuqizohet sepse ne e shikojnë si një gjë reale të pashmangshme dhe të nevojshme të mënyrës se si është ndërtuar jeta jonë, sepse ai depërton në të gjitha lidhjet tona me botën fizike dhe shpirtërore, megjithëse në jetën e përditëshme bëhet i padukëshëm , ai është pjesë përbërëse e qënies tonë kudo që jemi.

Pjesë të veçanta të identiteti etnik fuqizohen kur individi ndihet i rrezikuar për ekzistencën e tij, kur i kërcënohet mirëqenia, ndërgjegjia e tij, prandaj identiteti etnik nga ana psikologjike shprehet në pjesën e tij përbërëse të njohjes, emocionale dhe të sjelljes

Çështjet e identitetit etnik kanë qenë shumë të rëndësishëm për shkak të ndryshimit demografike, duke përfshirë edhe normat e lindjes dhe numrin në rritje të emigrantëve dhe refugjatëve në të gjithë botën.

Nga ana psikologjike identitetin etnik :

Qenia social ka si tendencë që të marr maksimalen nga jeta, kjo spjegohet si një anë për të kompensuar problematikat që ka individi me veten. Duke u projektuar në identitetin etnik ai fuqizon anë të tjera të dobëta të identitetit të tij, projekton një veprimtari tjetër të dobishme për të mohuar dobësitë e tij si frika nga dështimi, turpërimi para opinianit etj. Në këto raste projektimi në identitetin etnik merret si mekanizëm mbrojtës.

Koncepti i identitetit kombëtar

Identiteti kombëtar është një nocion më i ri se identiteti etnik. Identiteti kombëtarë është një identitet më shumë politik. Konceptet e identitetit kombëtar u bënë të rëndësishëm atëherë kur kërkohej të dominoni pushteti ekonomik dhe territorial. Në këtë aspekt u forcua dhe koncepti i identitetit kombëtar.

Në rastin e Shqipërisë koncepti i identitetit kombëtar ka konotacion tjetër, ai lidhet me ekzistencën e vetë individit dhe familjes së tij, kështu në kuadër të mbijetesës koncepti i identitetit kombëtar është fuqizuar shumë në periudha të ndryshme të historisë së popullit tonë. Në periudhën e pushtimeve turke, mbrojtja e trojeve ishte mbrojtja për mbijetesë, besa dhe përkushtimi ndaj udhëheqësit ishin siguria dhe mbrojtja e të ardhnes së familjeve, fëmijëve. Në periudhën e Rilindjes Kombëtare gjithashtu u fuqizuan shumë elementë të tjerë të identitetit etnik, siç janë simbolet kombëtare, flamuri i arbërit, heroi Skënderbeu, gjithashtu shumë e fuqishme ishte lufta për gjuhën, e cila në atë periudhë mohohet dhe rezikonte të humbiste. Ndjenja etnike dhe kombëtare fuqizohen kur ato ndihen të kërcënuara. Ndjenja kombëtare në Kosovë është shumë e fuqishme për arsye se atyre për një periudhë të gjatë u është mohuar qenia e tyre si shqiptarë dhe të drejtat që rrjedhin nga ky përkufizim. Në periudhën e diktaturës ndjenja kombëtare dhe ngjyrimet emocionale të atdhetarizmit shqiptar kërkonin të justifikonin politikën e mbrapshtë të izolimit dhe mjeteve të tjera raprezalëse që përdorte pushteti komunist për të mbajtur pushtetin e tij.

Këto ishin disa nga faktorët të cilët ndikuan që të ardhmen e tyre shqiptarët ta shikonin të projektuar në kulturën dhe ekonominë e vendeve të zhvilluara të perëndimit dhe veçanërisht tek SHBA nëpërmjet të cilës shikonin një shtet mbështetës dhe pa interesa territoriale, si dhe me një fuqi dominuese ekonomike, simboli i zhvillimit. Duke iu referuar dhe shkrimtarit tonë I. Kadare i cili e argumenton pikërisht mbi këta faktorë historik që ndikuan fuqishëm që shqiptarët ta shikonin identitetin e tyre të orientuar nga shtetet e zhvilluara të Evropës “ Identiteti i vërtet i shqiptarëve është identiteti evropian”

Në situatën e sotme, pas viteve '90 me hapjen e kalimit në një shoqëri demokratike u vunë re largime masive nga vendi, jo vetëm të përndjekurit politik, por intelektualë të sferave të ndryshme, njerëz të thjeshtë etj. Refugjatët detyroheshin të ndërtonin identitetin për mbijetesë, mos humbi tek shqiptarët ndjenja e identitetit kombëtar, apo etnik, aspak, ne tani vume **re se elementë të fuqishëm të identitetit personal, etnik, kombëtar, orientoheshin drejt situatave të reja të sistemeve shoqërore.** Shoqëria pësoi ndryshime të rëndësishme

dhe la pas shumë nga mitet dhe ëndrrat e saj të mëparshëm. Shumë gjëra që kanë ekzistuar në të kaluarën herë pas here të duken gati nostalgjike: ndjenjat e unitetit, të vuajtjeve të përbashkëta, të përvojave të durimit, si dhe lidhjeve të përbashkëta, sa vijnë e bëhen më pak të rëndësishme. Kujtimet kolektive për të kaluarën janë duke u bërë më pak stigmatike dhe të dhimbshme. Të gjitha këto në vetvete janë gjëra të mira dhe të këqija, por është mjaft e vështirë për të bërë një prerje mes të asaj që është humbur dhe ka qenë dhe asaj që është duke u fituar tek identiteti kombëtar.

Sot është një realitet i ri social dhe kulturor në të cilin duhet të përshtatemi, dhe në të njëjtën kohë të përmbushim **sfidat e vërteta që sjell globalizimi. Një nga sfidat më urgjente që shoqëria po përballlet sot është nevoja e rishikimit dhe të ristrukturimit të identitetit të saj kombëtar nën ndikimet e europianizimit dhe globalizimit. Kjo detyrë mund të përfundojë me sukses, nëse ne e kuptojmë identitetin kombëtar si një koncept në evolim, që ndryshon.**

2. Globalizimi si përfitim kulturor ekonomik, social

Globalizimi është një fenomen që e ka ndjekur historinë njerëzore, por ajo ka fazat e saj më të avancuara dhe veçanërisht termi globalizim u bë term i ditës pas viteve '90 (Globalizimi...ante Portas A. Civici) .Ai doli më fuqishëm në pah në momentin kur u shpërbë sistemi socialist dhe e ekonomia e tregut të lirë tregoi epërsinë mbi atë të planifikimit socialist, rritja e probleme ekologjike dhe ndërëgjegjësimi i njerëzve për mbrojtjen e tyre, nevoja për një bashkëpunim global ekonomik, financiar, kulturor, teknologjik. Ka shumë përkufizime mbi globalizimin, por më sinjifikativ është: “Shprehje e lidhjeve natyrë-njeri të cilat ndikojnë në zhvillimin global.”

Sipas sociologut Zygmund Bauman “ globalizimi është i pashmangshëm dhe i pa kthyeshëm , ne tashmë jetojmë në një botë të ndërlidhur dhe të ndërvarur në shkallë planetare”

a. Globalizimi si ekspansion

Zhvillimi i vrullshëm i shkencës dhe teknologjisë ka bërë të mundur shpërndarjen e informacionit dhe komunikimin mes njerëzve në një mënyrë të rrufeshme. Këto zhvillime kanë ndikuar në politikat ekonomike, arsimore, kulturore dhe shpesh kanë bërë të ndryshojnë vendimet gjeopolitike.

Ky hop cilësor i zhvillimit të shoqërisë, zgjerimi i madh i tregut dhe të marrëdhënieve ekonomike ndikojnë në migrimin global, i cili prodhon shoqëritë kozmopolite. Zgjerimi i shpejtë i globalizimit dhe të depërtimit të forcave globale në shoqëri lokale dhe tregjet e tyre shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë frikës dhe zhgënjimit në shumë rajone të botës. Në vende të ndryshme termi globalizim është trajtuar nga kënd vështrime të ndryshme, në varësi se si kulturat, ekonomitë e shoqëritë e tyre ndihen dhe identifikohen me ndryshimet e sisteve shoqërore qendër-periferi, të kombeve të ndryshme me shtetet e fuqishme.

Natyrisht shoqëria shqiptare nuk është e përjashtuar nga presionet e globalizimit. Shqipëria si shumë vende të tjera që kaluan nga një shoqëri e mbyllur në një shoqëri të hapur, u përballën me forcat që veprojnë në një botë globale bashkëkohore siç janë papunësia, fuqia e ulët blerëse, borxhet shtetërore, zhvleftësimi i lekut përballë euros apo dollarit, krahu i lirë i punës, specializimi i profesioneve, por dhe me probleme të rëndësishme sociale si shpërbërjen e familjeve të mëdha në familje mononukleare, probleme të trafikimit të qenieve njerzore, dhunës së rrugës e asaj në familje, polarizimin e shtresave sociale duke iu afruar ekstreme, si dhe me mungesën e kulturës së shoqërisë për të hyrë një sistem tjetër shoqëror.

b. Koncepti utilitar i globalizimit

Si koncept utilitar, globalizmi jep idenë e një bote unike, e një botë pa kufinj, sipas këtij perceptimi mund të flasim për ndërthurje kulturash, ekonomishë, teknologjishë. Ky këndvështrim është në favor të bashkëpunimit dhe të hapjes për të arritur një paqe globale një eliminim tërësor të kufinjve.

3. Problematik të edukimit në fokusin e kurrikulës

Edukimi për qytetarinë është një përgjegjësi që rrjedh nga zhvillimet e shpejta sociale dhe politike të globalizimit. Edukimi në përgjithësi dhe ai qytetar në veçanti sigurojnë mekanizma që të transmetojnë vlera themelore për të ndërtuar shoqëritë demokratike paqësore. Qytetari i një kombi në aspektin ligjor ka të drejtat dhe përgjegjësitë që ia siguron kushtetuta e vendit të tij, por gjithashtu ai ka dhe të drejta të cilat ia sigurojnë institucionet ndërkombëtare, në një farë mënyre ai është dhe qytetar i botës, aq më tepër për emigrantët që u duhet të sigurojnë identitete të shumëfishta, atë të vendit të origjinës, vendit ku jeton dhe atë të një qytetari të botës. Ky realitet ve në pikëpyetje idenë e besnikërisë së një shtetësie të veteme (A. Osler&H.Starkey).

Për këto **arsye edukimi** merr një rëndësi të vaçantë në rritjen e sferës së njohejs së të rinjve për t'u përballuar me sfidat e të jetuarit në një botë globale, ai ka për detyrë t'i njoh të rinjtë me rolet e tyre të së ardhmes si qytetar i një shteti demokratik dhe qytetar kozmopolit, t'i njoh me institucionet ligjore, politike, fetare, ekonomike të vendit të tyre. Edukimi për qytetarin e një shteti demokratik merr shumë rëndësi dhe në faktin tjetër se sa ky qytetar i së ardhmes i gëzon të drejtat e tij se sa ai vlerësohet për të dhënë kontributin e tij për të ndjerë përkatësin e kësaj qytetari, sa edukohet me diversitetin kulturor.

Ka një kontraditë mes asaj që ne duam të realizojmë në sferën e njohjes për të modifikuar sjelljen e të rinjve, pjesa teorike, njohuritë në tekste mund të jenë të konsoliduara dhe angazhimi i tyre në veprimtaritë praktike është i vakët, duke i konsideruara ata si të painteresuar për problematikat e komunitetit, pra të rinjtë konsiderohen si qytetarë në pritje për të dhënë kontributin e tyre dhe jo si pjesë aktive e ndërtimit të një qytetarie demokartike (Olser & Vincent, 2003)

Qytetari tani e quan veten "qytetar të mbivendosjes së fateve të komuniteteve: lokale, rajonale, kombëtare, globale dhe gjithnjë virtual" (Kymlicka, 2001) edhe pse ata mund të kenë bindje të ndryshme politike, fetare, kulturore ata jetojnë një komunitet ku u përputhen politikat ekonomike dhe sociale për atë teritor të përbashkët. Këto mbivendosje ofrojnë mundësi për të zhvilluar një formë të re të demokracisë gjithëpërfshirëse dhe të vendimmarrjes demokratike.

Ne shikojmë se më shumë se njohuritë teorike të marra në shkollë sjelljen demokratike për një qytetar kozmopolit e orientojnë kushtet e jetës dhe marëdhëniet e ndërvaruar sociale.

Ajo që është më e domosdoshme në edukimin e të rinjve është lidhja e dijeve më sigurimin e aftësive praktike. Në kurrikulën e shkollës sonë pikësisht ky është disbalancimiraporti I formimit të dijeve me krijimin e aftësive praktike të qytetarit global, pra venvia e përvojës së nxënësit në themel të dijës dhe modifikimit të sjelljes.

Reformat e mëdha legislative ne sistemin e edukimit në Shqipëri, ratifikimi i konventave mbi të drejtat e fëmijëve, hartimi strategjive shtetërore si ato të Bashkimit Evropian tregojnë se format e administrimit shtetëror po i afrohen atij ndërkombëtar. Tani fenomini i qytetarit demokratik, qytetarit global nuk është më një imazh i paarritshëm por një realitet që dalëngadalë po preket.

HIPOTEZA:

Globalizimi është një proces i pashmangshëm i zhvillimit, atëherë është detyrë e rëndësishme e sistemeve të edukimit të orientojmë të rinjve drejt formimit të qytetarit global me nje identitet të qenësishëm qytetarit demokratik kozmopolit

METODA : interpetimi i pyetësorit

PJESËMARRËSIT : nxënës të viteve të katërta të 2 shkollave të mesme në Durrës dhe 2 në Tiranë

SKEMA E KËRKIMIT

Vendi i aplikimit dhe procedurat: Shkolla "S.Frashëri "Tiranë, "A. Vokshi", Tiranë, "N.Frashëri", Durrës, "L. Tomeu" , Durrës

27 Leoniku, 25 Naimi Durres – Tirane 25 S.Frasheri; 23 A.Vokshi 52 Durres- Tirane 48 GJITHSEJ 100 nxënës, Pjesëmarrja 100 të rinj maturatë 2 shkolla në Tiranë dhe 2 në Durrë

Mosha 17-18 vjeç, prejardhja 80 shqiptarë, 7 maqedonas, Grek 8; Malazez 2; Vendet e tjera 3 (rom, egjyptian, italian..) Gjinia 24 djem 76 Vajza

REZULTATET E PYETËSORIT**IDENTITETI KOMBËTAR, 2003 MODULI IDENTITETIT KOMBËTAR**

Të rinjtë janë të gatshëm për të ndërmarr veprimtari në dobi të komunitetit 96% e tyre janë të gatshëm të shtojnë gjelbërimin, të pastrojnë shkollat, parqet dhe 5% e tyre shprehen se ne paguamë taksa për këto veprimtari. Ata janë të gatshëm të ndikojnë në vendimmarjen politike të komunitetit duke u përfshirë 41 – 41% në forumet rinore të partive politike nga të cilët 22% PD, 14% PS , 5% LSI, 1% PDIU

Të rinjtë për pyetjen "**Ç'mendim keni për Aleancën "Kuç e Zi"**" - shprehen - 26% nuk kam dëgjuar; 55% Lëvizje patriotike jashtë ngjyrymeve politike. 19% E bëjnë politikanët për interesat .

J. H vjen nga Librazhdi tek kushërinjtë, pa familjen që të arsimohet në një qytete më të përparuar. Aleanca "kuç e zi " duhet të ekzistonte shumë kohë më parë që të shpëtonte Shqipërinë nga shovinistët grek dhe serb. Duhet të krenohemi sepse po mbron të drejtat e shqiptarëve.

Pse gjatë viteve '90 kemi një fluks të emigrimit, a e kanë mohuar emigrantet vendin e tyre.

100% kanë shkuar për një jetë më të mire; 45% kur të kenë një jetë më të sigurtë mund të kthehen në vendin e tyre. Ata janë më patriot se ne.

Ndikimi i shoqërive shumëkombëshe në ekonominë tonë do të ndikojë për mirë 70%, sepse ne jemi të varfër dhe nuk kemi për të investuar për të bërë

ndryshime të mëdha; 30% na shfrytëzojnë si minatorët e Bulqizës. Kemi shumë burime natyrore, kur shteti ynë nuk i menaxhon do t'i menaxhojnë të huajt.

Identiteti etnik sa të qëndrueshme janë lidhjet me vendin e origjinës, apo të rinjtë po orientohet drejt kulturave të reja të një bashkëjetese globale

35% nga nxënësit japin përgjigje se do të dëshironin të jetonin në vendet e BE- se kanë një kulturë më të përparuar dhe se duan të studiojnë atje ku kanë të afërmit; 20% SHBA vend i sigurtë dhe me ekonomi të zhvilluar, universitetet janë më të përparuar; 10% Gjermani do të shkojmë sepse vepron ligji

Identitetin etnik e konceptojnë si një të pandryshueshëm, 55% e tyre thonë se kudo që të shkojmë unë jam shqiptar dhe kjo është e pandryshueshme; 35% e komentojnë identitetin etnike me kulturene vendit ku jetojnë- po të lind në Angli e të rritem atje 15 vjeç unë do ta flas me vështirësi gjuhën shqipe; 10% Unë kudo që shkoj themë se jam nga Dibra e Madhe se ne i ruajmë shumë zakonet dhe shkojmë me pushime shpesh atje megjithëse kam 10 vjet që kam ardhur në Durrës ndihem më shumë Dibrane; Identiteti nuk ndryshon , ndryshon kultura.

Lidhje shpirtërore me vendin e origjinës 10% shumë afër; 13% afër; 30% joshumë afër, 25% nuk janë të lidhur.

Sa e rëndësishme është kombësia 70% shumë; 9% i rëndësishëm; 5% jo shumë i rëndësishëm Ndihej krenar për arritjet e vendit tim në sport Sh. krenar 80% . Krenar 10% disi krenar 10% , ndihem krenare për gjuhën simoket kombëtae se pse i kemi shumë të veçanta, për historinë e popullit tim, për njerëzit e shquar që kanë dhënë kontribute për vendet e tjera si Nënë Tereza etj...XH.R- Më bën të ndihem shqiptare gjaku që rrjedh në venat e mia Largimet e shqiptarëve janë dhe të mira dhe të këqija sepse me largimin ata harrojnë gjuhën shqipe Emigrantët përmirësojnë kulturën e vendit me kulturën që sjellin dhe ndikojnë shumë në pasurimin e vendit 10% shumë; 23% mirë; 50% disi; 7% pak; 10% nuk ndihet Pjesët e jashtë teritorit të Shqipërisë duhet të bashkohen vendin amë 97% P. Si do të votonit, nëse bëhet një referendum për t'u bërë apo jo pjesë e Komuniteti Evropian, Pro 93; Kundër 7 Qytetar global është ai që ndihet mirë në çdo pjesë të globit ku do të shkojë. Motivi më i madh i të rinjve për të shkuar jashtë është dëshira për të marr një shkollim shumë herë më të mirë se në Shqipëri. Qytetarin global e kuptoj si një qytetarë që ka mundësi të komunikojë me gjithë botën, për faktin se dhe shoqëria jonë është e hapur. Përkatë sia fetare, jam besimtar i fesë myslimane, por nuk e praktikoj. më pëlqejnë ritet fetare të krishtilindjes. Ne jemi bektashi dhe nëna me merr me vete për të shkuar ne teqe, një pjesë nuk prononcohen. Në xhami shkojnë burrat. Nuk më pëlqen të vishem si disa vajza që mbulohen

me çaf.Me pëlqejnë të dyja ndërtesat si xhamia dhe kisha e madhe jamë godina shumë të bukura.

KONKLUZIONE

- Të qenit qytetar demokrate dhe kozmopolit nuk realizohet vetëm në shkollë, por nga ndikimi i kulturës familjare e komuniteti dhe angazhimeve të vetë të rinjve.
- Qytetar kozmopolit nuk do të thotë që të refuzohet shtetësia apo kombësia e individit, por ka të bëjë me një koncept më të gjerë, me ruajtjen e identitetit kombëtar, por dhe ta zgjerojë atë më tej duke fituar aftësi dhe njohuri për t'u përshtatur në një jetesë më të gjerë atë globale.
- Zhvillimin e një ndjenje solidariteti për një komunitet global nuk mund të realizohet nëse nuk do të arrijmë të krijojmë një solidaritet me komunitetin ku jetojmë.
- Të rinjtë janë të hapur ndaj kulturave të tjera, marrin përgjegjësi për përmirësimin e jetesë në komunitet, pranojnë diferencën e kulturave, dhe kanë shumë dëshirë të studiojnë në shkollat më të mira jashtë vendit.
- Të rinjtë dëshirat e tyre për ndryshim dhe zhvillim pa paragjykuar kulturat dhe humbjen e identiteti kombëtar kryesisht i kanë impulsive dhe të ndikuar nga zhvillimet politikosociale
- Njohuritë për institucionet ndërkombëtre legjislatore dhe mënyrën e funksionit të shoqërive dhe ekonomike të vendeve të tjera janë të pamjaftueshme.
- Të mësuarit në shkollë duhet të rikonceptohet duke vënë në qendër të edukimit përvojën individuale të të rinjve, duke e konsideruar si një qytetarë aktual dhe jo si një qytetarë në pritje.
- Të ketë më shumë iniciativa të komuniteti dhe lokale për edukimin.
- Krijimi i qytetarit global demokratik për të zbatuar të drejtat e njeriut, për të jetuarit në paqe duhet bazuar në pajisjen e të rinjve me njohuri , shkathtësi dhe qëndrime për të mundësuar ndryshimin.
- Të rinjtë duhet të orientohen **drejt të ardhmes duke luajtur rol aktiv në formimin e botës në të gjitha nivelet lokal, kombëtar, global.**

REKOMANDIME

Edukimi i qytetarit kozmopolit në shkollën tonë realizohet në mënyrë të kënaqëshme nga përmbajtja duke iu referuar kurrikulës së saj, por nga studimi rekomandojmë që:

- 1- Lenda e edukimit të qytetarit global të jetë një lëndë më vete duke u bazuar jo vetëm në materialin teorik, por nxitjen e veprimtarive praktike në rang lokal, kombëtar dhe global duke vendosur në qendër të këtij edukimi përvojën e vetë të rinjëve
- 2- Të bëhet kujdes që ky edukim të jetë dhe kroskurikular

DISKUTIM:

Ky punim e për zgjodhi kampionin e tij në 2 qytetet më të zhvilluara nga pikëpamja ekonomike dhe kulturore e vendit dhe në anketim nuk kanë dalë të gjitha problematikat për të përgjithësuar, por meqenëse këto qytete kanë një popullsi pothuaj nga i gjithë vend, i përmbledhin problematikat e edukimit të të gjithë të rinjëve.

Shkollat ku u vendos pyetësori ishin nga shkollat me të mira në të dy qyteteve. Studimi gjithashtu iu referua dekomuntacionit shkollor dhe nuk u ballafaqua me konkluzionet apo mendimet e mesuesve, të prindërve kështu që mbetet i hapur për t'u pasuruar.

Ky studim është i dobishëm për t'u përcjellë hartuesve të kurrikulave, shkollave dhe studjuesve të problematikave të edukimit global tek të rinjtë.

Bibliografia:

1. Identiteti evropian i shqiptarëve- Ismail Kadare
2. Globalizimi...ante Portas – Adrian Civici
3. Nihilizmi dhe emancipimi – Ganni Vattimo
4. Ese sociologjike - Ali Pajaziti
5. Globalistika – Sevet pëllumbi
6. Shoqëri periferike – Artan Fuga
7. Hapësira qytetarie drejt fundit te tranzicionit
8. Programet: Qytetari, Sociologji, Aftësim për jetën
9. STARKEY, H. (2000). Citizenship education in France and Britain: evolving theories and practices, *The Curriculum Journal*,
10. OSLER, A. & VINCENT, K. (2002) *Citizenship and the Challenge of Global Education* (Stoke, Trentham).

II

- MIGRIMI -

MIGRIMI I POPULLSISË DHE IMPAKTET SOCIALE TË TIJ NË RAJONIN NDËRKUFITAR TË GOLLOBORDËS

Artan LILA

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Ilir HEBOVIA

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Enis URUÇI

Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres

ABSTRACT

Migration of populations, as an early phenomenon in our country, is linked to various factors; Impacts on social aspects and economic, take distinctive features in particular areas, especially in the undeveloped mountains areas. In this context for the Golloborda crossborder region historical phenomena such as school interruption, the reduction of working age, marriage at very young age, poor health culture are a consequence of low cultural level, and the existence of old age group as a result of the movement of the new age population.

Keywords: *Migration, Impacts on social aspects and economic, Golloborda crossborder,*

Migrimi i popullsisë si një nga fenomenet më të hershme në vendin tonë, lidhet me faktorë të ndryshëm. Ndikimet e tij në aspektin social por edhe ekonomik, marrin tipare të vecanta në rajonet malore e sidomos ato ndërkufitare. Në këtë kontekst ato paraqiten prezente edhe në rajonin ndërkufitar të Gollobordës. Fenomene të tilla si, shpopullimi i disa fshatrave, braktisja e shkollës nga fëmijët pa mbaruar arsimin,

bazëlargimi i popullsisë me moshë të re drejt zonave me te zhilluara, apo ulja e numrit të meshkujve si rezultat i largimit të tyre në emigracion kanë bërë që në këtë trevë këto pasoja sociale të jenë më të ndjeshme Ndaj për të zvogëluar këto pasoja sidomos nga emigrimi është i domosdoshëm hartimi i politikave të tilla të cilat të jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm të këtij rajoni e më gjerë.

Migrimi i popullsisë, fenomen i hershëm i shfaqur në vendin tonë

Lëvizja hapsinore e popullsisë nga njëri rajon në tjetrin është një dukuri e cila ka egzistuar që në periudhat e hershme të historisë së njerëzimit. Pavaresisht nga shkaqet apo faktorët të cilat ato i kanë shkaktuar, ato paraqiten si një fenomen i përhapur edhe në popullsinë e vendit tonë. Më të theksuara ato shfaqen gjatë periudhës së mesjetës, kur Shqipëria ishte nën sundimin osman. Politika shfarosëse e ndjekur prej tyre e shoqëruar me synimin për të osmanizuar popullsinë e Shqipërisë e detyroi një pjesë të mirë të saj të zhvendosej në drejtime të tjera për të shpetuar kësaj dhune të shfaqur në këtë periudhë. Drejtimet kryesore të kësaj lëvizje ishin: së pari largimi dhe vendosja e tyre në territoret kryesisht malore ku turqit nuk mundeshin të shtrinin sundimin e tyre, si në malësinë e Mirdites apo në Kurvelesh, Gjinar apo në zonën e alpeve. Drejtimi tjetër i kësaj lëvizjeje ishte Italia dhe kryesisht viset jugore të saj, me epiqendër Kalabrine. Në periudhën mesjetare e në vazhdim, kanë ndodhur lëvizje migruese kryesisht për arsye ekonomike, me destinacion disa vende të ballkanit si Rumani, Bullgari apo dhe në disa shtete të Lindjes së Mesme. Një fenomen i tillë sa social po aq edhe ekonomik e demografik ndikoi në fenomene të tilla si ulja e numrit të përgjithshëm të popullsisë, prishjen e raporteve gjinore me mbizotërim të numrit të përgjithshëm të femrave, lënia djerrë e tokave etj. Duke e analizuar problemin në aspektin kronologjik si dhe me vecoritë specifike me të cilën paraqiten këto lëvizje dallojmë disa etapa kryesore të lëvizjeve emigruese të popullsisë në vendin tonë.

Periudha e viteve 1910-1920, drejtimi kryesor i lëvizjes kanë qenë vendet e ballkanit, dhe shënohen fillimet e para të emigrimit në drejtim të SHBA. Shkaqet kryesore lidhen kryesisht me faktorët ekonomike dhe situatën politike jo të qëndrueshme në vend. Një ndikim jo të vogël në këtë fenomen për periudhën në fjalë ka dhënë përfundimi i luftës së parë botërore me të gjitha pasojat e saj.


Periudha midis viteve 1922-1939. Drejtimi kryesor i lëvizjes emigruese tani më tepër përqëndrohet në drejtim të vendeve të Europës e në veçanti Italisë, Francës apo Austrisë si dhe vendeve të afërta të Ballkanit. Shkaqet kryesore të

kësaj levizjeje lidhen si me faktorët ekonomikë, apo në disa raste të ndikuar dhe nga faktorët politik të brendshëm apo të jashtëm. Në aspektin e brendshëm vihet re një gjallërim i shpërnguljes së popullsisë në drejtim të qendrave kryesore ekonomike e urbane të kohës si Tiranë, durrës, shkodër. Një pjesë e popullsisë e cila ishte vendosur në viset e larta malore për ti shpëtuar rrezikut osman u rikthye në zonat prej të cilave ishin larguar. E vecanta e kësaj periudhe qëndron edhe në faktin se një pjesë jo e vogël, kryesisht të rinjtë, largohen për arsye shkollimi dhe më vonë ata integrohen në jetën e ketyre vendeve dhe vetëm një pjesë e tyre rikthehen në atdhe.

Periudha e viteve 1940-1945 përkon me pushtimin fashist të vendit, si dhe përfundimin e luftës së dytë botërore. Në këtë periudhë shkaqet kryesore të lëvizjeve emigruese të popullsisë mund të shpjegohen me situatën e rëndë ekonomike por në disa raste dhe politike. Me përfundimin e luftës vërehet një largim kryesisht i asaj pjese të pasur të popullsisë e cila nga frika e regjimit komunist që po vinte në pushtet largohet përgjithonë në drejtim të Italisë apo shteteve të tjera të Europës perëndimore si dhe në destinacione të tilla si SHBA apo Australi. Mbas vitit 1945 fillon një etapë e re e cila pasqyron një ndërprerje totale të këtij fenomeni i cili ka të bëjë jo më së shumti me permirësimin e situatës ekonomike në vend, por me karakterin tipik të mbyllur të sistemit komunist. Kjo periudhë njihet si më e gjata dhe e errta në lëvizjen e lirë të popullsisë në Shqipëri. Lëvizjet migruese tashmë marrin tërësisht karakter brenda vendit, të kontrolluara nga shteti dhe të miratuar vetëm prej tij.

Periudha e pas viteve 1990 e cila shënon ndryshimet e mëdha në sistemin politik në vend, ku lejohet lëvizja e lire e shtetasve. Ky moment historik për vendin mund të quhet pa dyshim si fillimi i lëvizjes më të madhe të popullsisë jashtë vendit. Shkaqet kryesore me të cilat shpjegohen përmasat e mëdha të emigrimit janë ato me karakter ekonomik. Të mos harrojmë se gjendja me të cilën popullsia doli nga sistemi i kaluar ishte tejet e vështirë. Drejtimet kryesore të lëvizjes së saj jashtë vendit ishin shtetet fqinje si Greqia apo Italia dhe më vonë në pothuajse të gjitha shtetet e Europës perëndimore dhe SHBA. Kjo lëvizje e madhe emigruese shkaktoi mjaft probleme brenda vendit në shumë aspekte. Nga ana tjetër u shoqërua me punësimin dhe rritjen e të ardhurave në familjet e tyre në Shqipëri. Për sa i takon lëvizjeve të brendshme, tipari më dallues paraqitet ai i zhvendosjes së popullsisë nga zonat e thella malore kryesisht veriu dhe verilindja në drejtim të rajonit perëndimor, nga zonat rurale drejt atyre urbane më të zhvilluara, apo nga rajonet malore në drejtim të zonave fushore. Të gjitha keto zhvendosje hapsinore lidhen me mundësitë më të mira klimaterike dhe tokësore dhe mundësitë më të mëdha për zhvillim. Në disa

raste në ditët e sotme vihet re fenomeni i zbrazjes së disa zonave të banuara, kryesisht malore në vend dhe mbipopullimi i disa të tjerave si Tirana, Durrësi, Fieri etj. Evidentohet qartë fakti se pas viteve 1990 si rezultat i emigrimit të popullsisë së re dhe kryesisht të meshkujve shfaqen dukuri të tilla sociale si rritja e numrit të divorceve, prishja e raporteve gjinore brenda vendit etj.



HARTA E RAJONIT NDËRKUFITAR TË GOLLOBORDËS

Veçoritë dhe faktorët kryesorë ndikues në lëvizjen emigruese të popullsisë në rajonin ndërkufitar të Gollobordës dhe impaktet e saj

Rajoni ndërkufitari Gollobordës i shtrirë në të dyja anët e kufirit shtetëror midis vendit tonë dhe Maqedonisë ka njohur një levizje të hershme të popullsisë së saj jashtë kufijve të vetë që në periudhat më të hershme. Situata e vështirë ekonomike, shoqërore e kanë detyruar atë të emigroje që prej periudhës së pushtimit osman. Duke u njohur për traditat në fushën e ndërtimitarisë nuk e patën të vështirë të punësoheshin në vendet e tjera në ballkan, e në vecanti në Turqi duke kontribuar në ndërtimin e mjaft objekteve të ndryshme, e sidomos

atyre fetare në Stamboll. Një pjese e tyre duke tërhequr dhe familjet e tyre u integruan më së miri në jetën aktive të Turqisë. Me këtë shpërngulje të hershme shpjegohet komuniteti gollobordas që sot përfaqësohet nga pasardhësit e tyre të asaj periudhe. Këto tradita si dhe karakteri punëtor i tyre bëri që një pjesë e mirë e tyre të emigrojnë në Selanikun e sotëm duke ndërtuar një pjesë të mirë të tij. Një drejtim tjetër i emigrimit të tyre në vitet 1920-1930 ka qene amerika dhe deri në Australinë e largët. Sipas të dhënave të kohës mbi regjistrimin e taksave për frymë të popullsisë, vetëm nga kjo zone janë larguar në vendet e tjera mbi 276 familie. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë së vitit 1926 , duke marrë parasysh dhe të dhënat historike, rezulton se nga rajoni në fjalë janë larguar në drejtim të vendeve të tjera kryesisht Turqi, Bullgari, ShBA, e tjrreth 3,100 banorë. Në periudhën midis viteve 1940-1944 numri i të larguarve nga ky rajon ulet dhe kjo mundet të shpjegohet me dy arsye.


Së *pari* : Me pjesmarrjen e tyre në luftën kundër pushtuesve të huaj dhe ruajtjen e terësisë territoriale nga shovinistët sllavë.

Së *dyti* :Me vetë nevojën që kishte zona për tu rindërtuar si pasojë e shkatërrimeve të mëdha që pesoi nga lufta e dytë botërore. Mbyllja e kufinjve tanë në mënyrë përfundimtare pas vitit 1948 bëri që pjesa tjetër e rajonit e cila mbeti në anën tjetër të kufirit të merrte disa tipare krejt të ndryshme nga ajo Shqiptare.

Në pjesën lindore të këtij rajoni të ndodhur tashmë jashtë trungut amë, kanë ndodhur dy shpërngulje massive, njëra në vitin 1960 dhe tjetra në vitin 1970. Në të dyja rastet duhet evidentuar qartë se kemi të bëjmë me një dëbim me dhunë të shqiptarëve të kësaj zone dhe për ta populluar atë me kolonë sllavë. Kjo përkonte me planin e madh të qeverisë sllave për spastrimin etnik të shqiptarëve në krejt ish Jugosllavinë. Drejtimi kryesor i largimit ishte Turqia, kjo edhe për shkak se aty gjendeshin prej shumë kohësh të afërmit e tjerë. Një pjesë tjetër u drejtua për në Shqipëri.

Periudha e viteve 1945-1990 për pjesën Shqiptare të këtij rajoni karakterizohet nga një levizje me intesitet të vogël por tashmë vetëm brenda vendit. Nevoja që kishte vendi për ngritjen e veprave industriale të mëdha bëri që një numër jo i vogël kryesisht ndërtues të lëviznin në drejtim të qyteteve të mëdha në të gjitha anët e vendit. Me këtë faktor mundet të shpjegohet sot prezenca e tyre në pothuaj të gjithë vendin. Ndryshimet e mëdha politike të ndodhura në vitin 1990, si dhe lëvizja e lire e qytetarëve në drejtim të vendeve të tjera sollin një levizje të madhe emigruese të popullsisë së këtij rajoni kryesisht në vendet fqinje si Greqi, maqedoni Bullgari dhe më vonë në drejtim të vendeve të Europës perëndimore. Shkaqet të cilat çuan në këtë fenomen ishin komplekse


ku më kryesori ishte niveli i ulët ekonomik i familjeve të tyre, si dhe karakteri i izoluar i këtij rajoni në raport me pjesët e tjera të vendit. Ndër shkaqet e tjera të cilat ndikuan në këtë fenomen ishin sipërfaqja e kufizuar e tokës së punueshme, karakteri tipik malor, dhe izolimi i saj për një kohë të gjatë të vitit, infrastruktura tejet e amortizuar e tij.



Impakti social i lëvizjeve migruese në popullsinë e rajonit

Përfshirja gjithnjë e më e madhe e popullsisë së këtij rajoni drejt largimit të tij për në zona të tjera brenda dhe jashtë vendit, kanë sjellë disa impakte kryesisht me karakter negative. Fenomeni i parë më i dukshëm është ai demografik i cili shpreh uljen e numrit të përgjithshëm të banorëve duke ndikuar direkt në zhvillimin e ulët ekonomik të tij. Kjo duket në mjaft tregues me karakter ekonomik dhe social duke e renditur atë ndër rajonet më pak të zhvilluara në vend dhe nivel rajonal. Renjen më të ndjeshme të numrit të popullsisë e ka pjesa perëndimore e tij që shtrihet në territorin shqiptar. Kështu nga 14,000 banorë që kishte në vitin 1989, në vitin 2001 ai ka patur 8,100 banorë kurse në vitin 2010 rezulton një popullsi prej 7,300 banorësh.

Vitet	Nr i Banoreve	Nr i banoreve ne %
1989	14,000	48%
2001	8,100	28%
2010	7,300	25%



Ulja më e madhe numerike e popullsisë ka ndodhur sidomos midis viteve 1990 deri në vitin 2001 me një ulje prej 70% te numrit të përgjithshëm, prej të cilëve 28% e përbëjnë pjesa e popullsisë e cila ndodhet në emigracion. Këto të dheëna rezultojnë nga pushteti vendor i rajonit per periudhën në fjalë. Një ndikim të madh ky fenomen ka dhënë në ndryshimin e madh të raporteve gjinore midis femrave dhe meshkujve në rajon. Largimi në drejtim të vendeve të tjera të popullsisë së re kryesisht të meshkujve, ka cuar në rritjen në mënyrë artificiale të numrit të femrave duke krijuar vështirësi në lidhjet martesore brenda rajonit. Në mënyrë të vecantë vihet re një përqindje e madhe tek femrat e moshes nga 16 deri në 45 vjec. Shkaku kryesor me të cilin shpjegohet ky fenomen është pikërisht largimi i meshkujvë të kesaj grup moshe të cilat janë më të aftat për të punuar të larguara në emigracion.

Totali	29,400	100%
Vitet	Nr i lindjeve	Nr i lindjeve ne %
1989	13	68%
2001	6	32%
Totali	19	100%




Tabela e Nr të lindjeve për vitet "1989-2001"

Mungesa e numrit të duhur të meshkujve për të hyrë në martesë ka cuar ne fenomenin e lidhjeve martesore të vajzave të këtij rajoni jashte tij, shoqëruar në disa raste dhe me martesë në mosha fare të reja. Akoma më rëndë duket fenomeni i lidhjeve martesore me diferenca të mëdha në moshë, midis vajzave të reja të rajonit dhe meshkujve në disa rajone të Maqedonisë. Kjo më tepër për të synuar një të ardhme ekonomike më të mirë pa marrë parasysh diferencën

e madhe në moshe midis çiftit. Sidoqoftë në të gjitha rastet kemi të bëjmë me largim të popullsisë nga rajoni i Gollobordës.

Një pasojë tjetër shumë negative e procesit të migrimit ka të bëjë edhe me faktin se ky largim i meshkujve kryesisht 20 deri në 30 vjec është shoqëruar edhe me uljen e numrit të përgjithshëm të lindjeve, duke mos qenë në gjendje të rrisin të vetme femijët e tyre, nënat e reja kanë tendencën e uljes së lindjeve. Kështu nga 13% që ka qenë koeficienti i lindjeve në vitin 1989 ai ka zbritur në 5-6%.

Një fenomen tjetër negativë social që është i lidhur ngushtë me fenomenin e emigracionit është ai i braktisjes së shkollës për fëmijët e arsimit bazë. Pamundësia për të përballuar jetesën dhe marrjen me aktivitetin e përditshëm në ekonominë familjare i kanë detyruar në shumë raste që fëmijët të braktisin shkollën dhe të jenë pjesëmarrës në aktivitetet ekonomike të familjeve të tyre. Ulja e ndjeshme e të rinjve të cilët ndjekin arsimin e mesëm kryesisht shpjegohet me argumentimin se ka lidhje indirekte me fenomenin e migrimit apo me nivelin e vështirë ekonomik në familiet e tyre. Akoma më i rëndë parqitet fakti se po vjen duke u ulur në masë dëshira për arsimin e lartë duke synuar largimin kryesisht të meshkujve në emigracion ose të martesave të vajzave në rajonet urbane të vendit. Pасojë tjetër negative e largimit të popullsisë së re në emigrim është ai i rritjes së peshës specifike të grup moshës së tretë e cila ka shkuar nga 13-14% të numrit të përgjithshëm të popullsisë në rajon. Po të kemi parasysh se në vitin 1989 ajo përbënte 9-10% të gjithë popullsisë së saj, vihet re se po shkohet drejt fenomenit të moshimit demografik në përgjithësi.

Duke e analizuar fenomenin e migrimit të popullsisë së këtij rajoni shihet dhe një dukuri tjetër sociale me karakter negativ, ai i rritjes së numrit të divorceve brenda çifteve të reja. Shkaku kryesor i këtij fenomeni midis shumë të tjerave është edhe largimi për periudha shumë të gjata kohore i meshkujve jashtë vendit, cka ka ndikuar në dobësimin e lidhjeve familjare midis bashkëshortëve. Së fundmi ndikim i drejtpërdrejtë i migracionit sidomos pas viteve '90 i popullsisë në këtë rajon është zbrazja e plote dhe braktisja e mjaft qendrave të banuara si Stebleva, Gjinaveci (në pjesën shqiptare të tij) apo Llakajc dhe një pjesë e fshatit Llabonisht në pjesën maqedonase të këtij rajoni. Drejtimet kryesore të largimit janë qendrat urbane më të zhvilluara si Tirana, Durrësi, Elbasani në territorin shqiptar, apo Struga, Ohri dhe Kërçova në pjesën maqedonase të tij.

Përfundime dhe Rekomandime

• Rajoni nderkufitar i Gollobordës dallohet për një lëvizje migruese që në periudha të hershme historike me karakter si brenda ashtu edhe jashtë tij. Shkaqet kryesore të kësaj lëvizje të madhe migruese lidhen me këto shkaqe kryesore:

• Karakteri malor i natyrës së saj çka mundëson një sipërfaqe bujqësore disi të limituar me të cilën lidhet aktiviteti kryesor ekonomik i tij

• Klima tipike e ftohtë malore me reshje të mëdha të dëborës, dhe me një izolim për një periudhë të gjatë të vitit duke humbur kështu mundësinë e komunikimit me rajonet e tjera, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.

• Karakteri i izoluar i pozitës gjeografike të tij e bën disi të vështirë mundësinë për tu lidhur me rajonet ekonomike më të zhvilluara si dhe ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e ulët social dhe kulturor të banorëve të tij.

• Megjithëse përfaqëson një njeje të rëndësishme lidhëse midis rajonit më të zhvilluar ekonomik të Shqipërisë i cili ndodhet në perëndim të saj me trevat etnike shqiptare në Maqedoni, infrastruktura rrugore mbetet në nivele tepër të ulëta dhe me një shkallë të lartë amortizimi. Kjo bën që të humbasë rolin e dikurshëm që ka patur si një rajon i ndërmjetëm midis tyre.

• Neglizhenca nga ana e pushtetit qëndror në lidhje me investimet të cilat janë shumë të domosdoshme për tu kryer sidomos në infrastrukturë kanë bërë që një pjesë e mirë e popullsisë së rajonit nderkufitar të largohen në emigrim si dhe në pjesën perëndimore të vendit tonë, duke shkaktuar kështu fenomenin e shpopullimit të zonës.

Rekomandime

Për një zhvillim sa më të qëndrueshëm dhe afatgjatë të rajonit nderkufitar të Gollobordës, dhe për të minimizuar në maksimum fenomenin social të largimit të popullsisë së tij, mendojmë se rrugët kryesore për të arritur këtë qëllim janë disa:

• Rikonstruksioni i plotë i rrugës nacionale e cila lidh zonën e Librazhdit me atë të Peshkopisë e cila kalon në pjesën më të madhe të fshatrave të këtij rajoni. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejtë në shumë aspekte si qarkullim më i shpejtë i mallrave dhe njerëzve me rajonet e tjera të vendit. Nga ana tjetër do të rriste mundësinë për investime nga ana e individëve të tjerë jashtë zonës, kryesisht në fushën e turizmit malor.

- Përmirësimi i infrastrukturës jo vetëm asaj rrugore por edhe në drejtim të fushës së shëndetësisë dhe të arsimit duke krijuar lehtësi tek banorët e këtij rajoni për nevojat që lidhen me këto drejtime.
- Vëmendje më e madhe nga pushteti qëndror për të vënë në jetë projektet e investitoreve të huaj dhe atyre vendas me qëllim zhvillimin e turizmit malor dhe sportive dimërore për shkak të ofertes së madhe natyrore që e mundesojnë atë. Kjo do të hapte vende të reja pune dhe do të ulte numrin e të larguarve nga ky rajon.
- Çelja sa më e shpejtë e pikës së kalimit kufitar të Stebleves sipas marrëveshjes së nënshkruar të të dy shteteve do të lehtësonte lëvizjen në të dyja anët e kufirit dhe do të krijonte vende të reja pune dhe do të rriste mundësinë për një zhvillim të qëndrueshëm e afatgjatë .
- Krijimi i kushteve lehtësuese dhe inkurajimi i banorëve vendas për mbështetje financiare me qëllim zgjerimin e aktivitetit të turizmit familjar, i cili ka hedhur bazat e para të zhvillimit në këtë rajon.

Bibliografia

- Lila, A.(2006) "Golloborda, studim kompleks gjeografiko-ekonomik" (Monografi)
- Qirjazi, P.(2002) "Rajoni verilindor i Shqipërisë,Gjeografia e Shqipërisë"
- Kica, H.(2005) " Fushegropa e Ohrit", (Monografi)
- Dauti, n.(2005) "Etnokultura e fushgropes se Ohrit"
- Akademia e shkencave e Shqipërisë(2002) "Instituti i Historisë -Historia e popullit shqiptar", volumni 1 2002.
- Shtylla, V. (1998) "Rruget në antikitet , mesjeten e hershme dhe të vonë "
- Simpozium , shkup (1994) "Shqipëtarët e Maqedonisë" , faqe 67
- Instituti i Statistikave të Shqipërisë (2001) "Popullsia e Shqipërisë"
- Instituti për Statistika në Republikën e Maqedonisë (2002) "Regjistrimi i Popullsisë në Maqedoni"

PËRVOJA SHQIPTARE E MIGRIMIT NË NJË KONTEKST NDËRKOMBËTAR

Esmeralda URUCI

Universiteti Aleksandër Moisiu

Fatilda BERISHA TAHIRI

Universiteti i Tiranës

Anisa SINA

Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

The function of this paper is to take stock of the unique Albanian experience of migration and its implications. This is done by a particular emphasis on its most recent effects, and on the way that the migration process has consolidated, changed and 'matured' over the past two decades. Particular attention is paid to remittances as the driving-force of migration's developmental impact on the country's economy. Remittances, being of a crucial importance for most of Albanians, have become a typical phenomenon in the Albanian economy. Recently, this money is not regarded only as income sources for non-productive purposes, for meeting essential needs related to improved standard of living, but also as sources of financing for productive purposes, in the form of real estate investments or other long-term investments.

Keywords: Migration, Remittances, Albanian policies, Management, Investments

Hyrje

Fenomen i migrimit ka qenë evident dhe e ka shoqëruar historinë e shoqërisë njerëzore. Po, duhet thënë se dy dekadat e fundit ky fenomen ka përfshirë mbarë botën, duke u cilësuar nga disa studjues si “epoka e migracionit”. Në kontekstin e Evropës Jugore lëvizjet më intensive të njerëzve përfshijnë migrimet brenda shteteve, migrimet në ish-Jugosllavinë, gjatë shpërbërjes së federatës jugosllave, migrimin masiv për arsye ekonomike nga shtetet ish-socialiste, si: Shqipëria, Bullgaria dhe Romania, duke rritur në mënyrë të konsiderueshme forcën e punës në vendet perëndimore, si Greqia dhe Italia kryesisht, por edhe në vende të tjera të Evropës, SHBA, Kanada e të tjerë.

Nga ana tjetër, normalizimi i proceseve migratore në fillim të shekullit të 21-të dhe periudha e shkurtër historike nuk krijon mundësi për një analizë të plotë shkencore, pa pasionet e tanishme politike dhe kombëtare. Por është shumë e rëndësishme të kuptojmë se mbledhja e të dhënave për këto zhvillime është e gjetur dhe në kohën e duhur.

Në mars të këtij viti u mbushën 20 vjet nga largimet e para massive të mijëra shiptarëve drejt Italisë së jugut. Një fenomen i tillë i vecantë, i lidhur me një vend komunist me zhvillime dramatike tërhoqi vëmendjen e opinionit publik evropian e botëror. Imazhet e asaj kohe të shqiptarëve të dëshpëruar në kërkim të një jete tjetër më të mirë kanë mbetur dhe nuk kanë vetëm vlera studimore ekonomike. Ato shërbejnë për të mos harruar një epokë, të cilën shqiptarët e kanë lënë pas dhe i kanë kthyer shpinën përgjithmonë.

Duhet evidentuar se media perëndimore e asaj kohe, i portretizonte emigrantët shqiptarë si pjesë e një “populli anije”, njerëz të dëshpëruar të vendit të bunkerëve. Udhëtimi i tyre i shkurtër përfaqësonte një udhëtim në det mes dy “botëve”, në mes të Shqipërisë së varfër e të traumatizuar dhe Evropës së zhvilluar. Në të njëjtën kohë, por më pak të dukshëm për median, në studim paraqiten dhjetëra mijëra të tjerë të shpërndarë përgjatë kufirit me Greqinë, e cila shumë shpejt u bë vendi i destinacionit kryesor për emigrantët shqiptarë.

Nga analizat e bëra në studim, konkludojmë se dy dekada janë një kohë e mjaftueshme për të vlerësuar shkallën, efektet dhe implikimet më të gjera të këtij migrimi masiv.

Tema e migracionit të punës që prezantohet në këtë konferencë shkencore vjen në vazhdim të hulumtimeve të tjera edhe më të gjëra që unë kam bërë si autore dhe bashkëautore. Në të gjitha këto studime është analizuar roli i dërgesave të emigrantëve shqiptarë për zhvillimin ekonomik të vendit pas rënies së regjimit komunist.

Sipas raportit të fundit të Bankës Botërore *Factbook Migracioni dhe Dërgesat*, numri i emigrantëve shqiptarë jashtë vendit tani ka arritur 1.438.300 të barabartë me 45 për qind të popullsisë prej 3.2 milionë banorë, e cila aktualisht jeton në Shqipëri. Asnjë vend tjetër në botë nuk e ka këtë profil migrimi të arritur në vetëm 20 vjet.

Mund të themi se emigrantët shqiptarë, në përgjithësi, kanë qenë të suksesshëm, në kapërcimin e pengesave për integrimin social në shoqëritë pritëse. Pas arritjes në vendet e migrimit, ata janë përballur me qëndrime të ndryshme, herë pozitive dhe herë shumë negative. Fillimisht, për disa muaj në vitet 1990 dhe 1991, ata gëzuan një periudhë të shkurtër si të themi 'muaj mjalti' gjatë së cilës u pritën me një kuriozitet ekzotik si refugjatë nga një vend komunist. Por, shumë shpejt, nën ndikimin e politikave nacionaliste greko-serbe në Itali dhe në Greqi, filloi një fushatë e orkestruar nga elementë të partive të djathta e konservatore, të mbështetur fuqimisht nga media. Ato arritën ti stigmatizonin emigrantët si "të padëshërueshëm"; hajdutë, kriminelë dhe prostituta. Në të dy vendet filloj të kultivohej një frikë e parsyeshme, e cila në thelb s'ka asnjë lidhje me Shqipërinë dhe shqiptarët. Identifikimi i tyre vetëm me të keqen do të merrte fund një ditë. Dekadën e dytë ka patur një zbutje të këtyre pikëpamjeve raciste. Tashmë shqiptarët e kanë tejkaluar këtë situatë, duke bërë përparim të dukshëm social-ekonomik, duke punuar në vende më të mira pune si dhe duke jetuar në banesa me kushte më të mira jetese. Shumica e tyre shlyejnë në mënyrë korrekte të gjitha detyrimet fiskale në vendet ku jetojnë. Ndryshe nga komunitetet e tjera, shqiptarët dallohen si folës të mirë të gjuhës greke apo italiane. Kësisoj, ata kanë rritur e përmirësuar, përmes vështirësive profilit e tyre social. Vecanërisht, fëmijët e tyre po shkollohen në shkollat dhe universitetet më të mira të këtyre vendeve dhe sipas shumë burimeve janë të mirëintegruar. Familjet shqiptare emigrante kanë përmirësuar marrëdhëniet me fqinjët e tyre dhe kolegët, duke u bërë një shembull i mirë në komunitet.

1) Migracioni shqiptar në Perspektivën Krahasuese Ndërkombëtare

Në këtë çështje do të kthehemi në të dhënat e *Factbook* të Bankës Botërore në lidhje me Migracionin dhe Dërgesat e emigrantëve, nepërmjet të cilit njihemi me të dhënat më të fundit të vendosura në mënyrë krahasuese të migracionit shqiptar në një kontekst ndërkombëtar. Të dhënat e Bankës Botërore për numrin e Emigrantëve shqiptarë në vitin 2010, në shifrën 1.440.000, paraqet një rritje të konsiderueshme mbi vlerësimet zyrtare të mëparshme nga ana e

autoriteteve shqiptare prej mbi 1 milion në 2004-2005 dhe 800.000 në vitin 1999. Kjo konfirmon vazhdimin e emigrimit në dekadën e dytë, por me një ritëm më të ngadaltë se sa gjatë dekadës së parë (pra 800,000 gjatë 1990-1999, plus një tjetër 640,000 gjatë 2000-2010). Azzarri dhe Carletto, bazuar në të dhënat e mostrës ALSMS, vlerësojnë 50.000 emigrantë në vit deri në vitin 2000, duke rënë në 25.000 në vit nga viti 2004 e këtej. Megjithatë, numri i shqiptarëve jashtë vendit, gjithashtu rritet me rritjen natyrore, dhe kjo padyshim është bërë më e rëndësishme në dekadën e fundit, për shkak të formimit të familjeve të reja në vendet migratore. Kjo justifikohet me argumentin e thjeshtë se emigracioni shqiptar që në fillim ishte i dominuar nga të rinj, të cilët më pas u martuan dhe krijuan familje.

Le të bëjmë tani një analizë më të qartë ndërkombëtare krahasuese. Sipas të dhënave të Tabelës 1, Shqipëria ndodhet në 20 vendet me emigracion më të lartë në lidhje me shkallën e emigrimit (në përqindje të popullsisë që jeton në vend) Shqipëria renditet e nënta, ndërsa në lidhje me remitancat (si përqindje e PBB-së). Shqipëria renditet e nëntëmbëdhjeta. Në shikim të parë kjo nuk mund të jetë prova bindëse për hipotezën tonë se Shqipëria ka dëshmuar një përvojë pothuajse unike në shkallë të gjerë të emigracionit gjatë 20 viteve të fundit. Një vështrim nga afër me vendet e tjera të listuara mundëson një interpretim të ndryshëm. Megjithatë sa i përket emigracionit, të gjitha vendet e mësipërme, kanë një popullsi të vogël prej më pak se 1 milion banorë, disa prej tyre të matur në vetëm dhjetëra mijëra. Shumica janë ishuj të vegjël dhe/ose varësi koloniale me një ish- histori të gjatë të emigrimit të pas-luftës. Kjo është e njohur, pasi ishuj të vegjël, me burime të pamjaftueshme tokësore dhe shpesh me rritje të shpejtë popullsisë, kanë tendencë për të pasur një emigracion intensiv me gjenerata të njëpasnjëshme. Kështu, krahasimi i bërë me këto vende është i diskutueshëm.

Kur ne shikojmë remitancat si përqindje ndaj PBB, vlera e tyre është e ulët për Shqipërinë në krahasim me vendet e tjera të listuara. Përsëri, duke interpretuar tabelën mund të përsërisim që shumicën e vendeve të mësipërme e ndajnë nga Shqipëria dy karakteristika. *Së pari*, siç kemi vënë në dukje tashmë për kolonën e emigrimit, ata janë vende me histori më të gjatë emigracioni dhe kështu kanë krijuar traditën e dërgimit të remitancave. *Së dyti*, shumica janë vende shumë më të varfëra se Shqipëria, që do të thotë se, në përpjesëtim me popullsinë, GDP-të e tyre janë shumë më të ulëta. Në këtë kontekst, remitancat kanë një ndikim më të madh në ekonomitë e këtyre vendeve. Nga 18 vendet e mësipërme vetëm katër kanë një GDP më të lartë për frymë se Shqipëria (US \$ 5.944 Liban, Serbia

US \$ 5.435, Xhamajka US \$ 4.272, Bosnje-Hercegovinë US \$ 4.014; krahasuar Shqipëria US \$ 3405)

Një faktor i *i tretë* i rëndësishëm, është se dërgesat e emigrantëve në Shqipëri kanë kaluar tashmë kulmin e tyre dhe, me rritjen e ekonomisë, kontributi i tyre është në rënie ndaj PBB-së. Vlera e tyre në vitin 1996 zinte rreth 20 për qind të PBB-së.

Referuar të dhënave më të detajuara të Bankës Botërore për migrimin dhe remitancat për Shqipërinë, vendet e Ballkanit, dhe më gjerë në rajonin e Evropës Juglindore, konfirmohet pozicioni i Shqipërisë si vendi me emigrim më të lartë në rajon, përkundrejt popullsisë. Vetëm Bosnje-Hercegovina është më afër, por këtu emigracioni është artificial pasi që fillimisht u zhvillua si migrim i brendshëm në kuadër të ish-Jugosllavisë.

Sa i përket remitancave, profili i Shqipërisë është tipik ndaj disa vendeve të rajonit. Ai ruan edhe sot një ndikim të rëndësishëm në të ardhurat kombëtare bruto për frymë.

Remitancat kontribuojnë jashtëzakonisht në qarkullimin e kapitalit në kuadër të ekonomisë bashkëkohore botërore dhe kanë treguar elasticitet në recesionin global të shfaqur vitet e fundit. Ndryshimet e reja politike dhe ekonomikeqë shoqëruan dështimin e regjimeve komuniste në të gjithë vendet e Evropës Lindore sollën jo vetëm migrimin drejt perëndimit, por edhe kontributet e tij. Dërgesat e emigrantëve mund të konsiderohen si kontributi më i dukshëm dhe i dobishëm i migrimit për zhvillimin e vendit, ku ka ende zona të cilat vuajnë nga shkallë të ndryshme të varfërisë. Megjithatë, ky koncept është sfiduar kohët e fundit nga një numër sociologësh zhvillimi, të cilët theksojnë rreziqet shoqërore në rritje të pabarazisë në mes të atyre që marrin remitanca dhe atyre që nuk e kanë këtë burim, si dhe rrezikun mbi varësinë e të ardhurave nga remitancat. Ky rrezik manifestohet në drejtime të shumta. Në rastin e familjeve fshatare ekziston rreziku që dërgesa të vijë për të zëvendësuar aktivitetet prodhuese të vjetra, duke çuar në një tërheqje nga bujqësia dhe punimet artizanale lokale. Kjo ka çuar në një tkurrje të zhvillimit ekonomik lokal. Ekonomitë shtëpiake mbështeten në paratë e dërguara nga një ose më shumë anëtarë të familjes që punojnë jashtë vendit. Në tregun e punës brenda vendit shihet një tërheqje e anëtarëve të rinj të familjeve për të punuar në bujqësi dhe në degët e tjera të ekonomisë lokale. Gjithashtu, ato marrin rrugën e migracionit, duke përforcuar varësinë nga remitancat.

Edhe në nivel kombëtar mbështetja vetëm në dërgesat e emigrantëve nuk është produktive për zhvillimin ekonomik. Kështu, remitancat deri

pak vite më parë kanë amortizuar nevojat e mëdha të familjeve shqiptare, Në të njëjtën kohë ato kanë parandaluar reformat strukturore më thelbësore të nevojshme për ta bërë ekonominë kombëtare më të efektshme dhe konkurruese në parametrat rajonale dhe global.

Tabela 2. Shqipëria dhe Europa Juglindore; popullsia emigracioni dhe dërgesat, 2009-10

Shënim: Të dhënat për Kosovën dhe Malin e Zi padisponueshëm.

Burimi: Banka Botërore, op. cit. (Shënimi 1), f. 54, 77, 81, 100, 102, 125, 167, 180, 210, 218, 223, 246.

Një debat i gjërë teorik dhe politik gjithashtu shoqëron përdorimin dhe ndikimin e remittancave. Së pari, remitancat janë përdorur për mbështetjen dhe mbijetesën e familjeve të emigrantëve, të cilat i kanë 'konsumuar' për ushqim, veshmbathje e të tjerë. Sot, ndryshe nga më parë kursimet ruhen për qëllime të investimeve, për shembull për të ngritur një biznes, ose për të investuar në edukimin e anëtarëve të rinj të familjes. Megjithatë, pjesa më e madhe e shpenzimeve ose investimeve të remittancave në Shqipëri, përbëhet nga blerja e mallrave të konsumit dhe përmirësimi i strehimit, zgjerimi dhe modernizimi i banesës ekzistuese, ose ndërtimi i një banese të re. Meqenëse dërgesat e emigrantëve janë shpenzuar në blerjen e mallrave të konsumit të importuara, për shkak të kufizimeve të prodhimit vendas, rezultati ka qenë rritje e importeve dhe humbje në fluksin e këmbimit valutor të parave të fituara nëpërmjet emigracionit.

2) Tendencat e remittancave në Shqipëri

Tabela 3 Fluksit vjetor i remittancave në Shqipëri nga viti 1993-2009,

Duke filluar nga një bazë prej 150 \$ milion në vitin 1992, dërgesat e emigrantëve u rritën me shpejtësi nga viti në vit për të arritur në vlerën e 500 milion usd në vitin 1996. Në periudhën e kolapsit të sistemit financiar, rënia e piramidave në vitin 1997 shifra ishte 47 për qind nën nivelin e vitit 1996, duke u rikthyer në vitin 1998, e duke u ulur në vitin 1999 në kohën e krizës së Kosovës, dhe pastaj duke gëzuar për një kohë të gjatë rritje të qëndrueshme nga 530.000.000 usd në vitin 2000 dhe duke arritur kulmin prej 1295 milion usd në vitin 2007. Ndikimi i recesionit global është ndjerë me një reduktim të totalit të remittancave prej 10 për qind në vitin 2008 kundrejt vitit 2007, dhe më tej 5

për qind rënie në vitin 2009 kundrejt vitit 2008. Duke pasur parasysh numrin e madh të emigrantëve shqiptarë që punojnë në Greqi, ndoshta më shumë se 600.000 tani, efektet e plota të krizës financiare greke, e cila u thellua në vitin 2010, pa dyshim do të pasqyrohen në dërgesat e emigrantëve shqiptarë që punojnë atje.

Pavarësisht rritjes gati pesë-fish të totalit të dërgesave midis viteve 1993 dhe 2007, rëndësia makro-ekonomike e dërgesave në mënyrë të qëndrueshme ka rënë, siç është ilustruar nga tri shtyllat e mesme në Tabelën 3. Si pjesë e PBB-së, kontributi i emigrantëve ka rënë nga rreth 20 për qind në 1993-1994 nën 10 për qind në vitin 2008-2009.

Për shembull, në fillim deri në mesin e viteve 1990, remitancat kompensojnë pothuajse të gjithë deficitin tregtar, nga 2006 kjo pjesë kishte rënë në 55 për qind dhe pastaj në 33 për qind në vitin 2008 dhe 2009. Të dhënat e 'eksportit' konfirmojnë që puna është konsideruar si burimi kryesor i eksportit për Shqipërisë. Së fundi, vlera për frymë e remitancave është rritur vazhdimisht gjatë gjithë periudhës 1993-2009. Gjithashtu duhet patur parasysh se remitancat kanë tejkaluar vazhdimisht disa herë shumën e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si dhe shumën e ndihmave të huaja të marra nga organizatat ndërkombëtare dhe donatorët. Një ndikim të mëtejshëm të remitancave në mbështetjen e ekonomisë shqiptare ka qenë vlerësimi i monedhës shqiptare, lekut, kundrejt valutave të huaja, duke i bërë produkte shqiptare dhe eksportet, më të shtrenjta dhe më pak konkurruese.

3) Përdorimi dhe efektet e remitancave

Evidencat e mjaftueshme mbështesin përfundimin se remitancat kanë qenë mekanizimi kryesor për zbutjen e varfërisë në Shqipëri dhe për rritjen e të ardhurave familjare. Vlerësimi cilësor të Bankës Botërore të varfërisë në Shqipëri, i kryera në dhjetë rrethe të vendit në vitin 2001, pas një dekade emigracioni, tregoi se remitancat përbëjnë faktori kryesor dallues në mes të një familje të varfër dhe një tjetër jo të varfër. Studimi raportoi se shumë njerëz në Shqipëri dallojnë një familje nga një tjetër nga numri i anëtarë të familjes, të cilët janë duke punuar jashtë vendit.

Sondazhet e realizuara tregojnë që gjatë dhjetëvjeçarit të parë të migracionit, prirjet konvergojnë në lidhje me destinacionet e remitancave: *e para*, plotësimi i nevojave të anëtarëve të familjes që lënë pas në Shqipëri, (ushqim dhe veshje). Së dyti, përmirësimi i kushteve të jetesës, rritja e hapësirave të banimit, dyer të reja, dritare, çatitë, pajisjet sanitare dhe

për gatim, mobilje, duke përfshirë këtu për disa, ndërtimin (ose fillimin e ndërtimit) të vendbanimit të ri; dhe *së treti*, hapjen e shërbimeve në sektorin aktiviteteve të vogla të tilla si dyqane, karburante bare e tjerë. Gjithashtu faktorë në këtë rend, për disa familje, u blerjen e një makine, shpenzimet për jetën-fazë të rëndësishme shoqërore dhe të komunitetit ngjarje (kryesisht martesat dhe funeralet), dhe mbështetjen e anëtarëve të rinj të familjes në arsimimin e tyre. Kushdo që udhëton nëpër Shqipëri që nga fundi i viteve 1990 mund të identifikojë me lehtësi efektin e remitancave në transformimin e peizazhit: dyqane, bare dhe kioska, ku disa kanë ekzistuar para, dhe kudo shpejtë zhvillimin e sektorit të ndërtimit ka qenë e dukshme, së bashku me braktisjen e ndërtesave të vjetra, duke përfshirë fabrikat dhe strukturat rurale kooperative. 'Këpurdhat' e zonave të banimit të paplanifikuara në skajet e qyteteve kryesore, dhe mbi të të gjitha në kryeqytet, Tiranë, dhe qyteti kryesor i portit, Durres "s, ka qenë e drejtuar jo vetëm nga e financuara nga jashtë 'shtëpitë e dërgesave të emigrantëve', por edhe nga rryma e fuqishme e migrimit të brendshëm që ishin bllokuar në masë të madhe gjatë regjimit komunist

Në dekadën e dytë, migrimi pa dërgesave rritet dhe pastaj belbëzoi, pjesërisht për shkak të recesionit global, por edhe, sepse remitancat kanë tendencë për të ndjekur migracionin, në se të dy kanë një lloj të ciklit dinamik të jetës. Sa më shumë procesi i emigracionit maturohet, vërejmë ndryshimin e prioriteteve të dërgesave të emigrantëve, si për sa i përket shumës dhe përdorimin e tyre. Zgjidhje afatgjatë, formimin e emigrantëve familje dhe integrimin në shoqërinë mikpritëse do të thotë se shuma të reduktuara janë dërguar: mbi të gjitha, sepse emigrantët që ishin vetëm të rinj burrat në vitin 1990 janë të martuar tani dhe vendosur jashtë vendit, dhe për shkak të familjes ribashkimit migrimit, si rezultat i rregullimit, nënkupton se burrat e martuar nuk ka më dërgojnë para për të mbështetur familjet e tyre bërthamw në Shqipëri.

KONKLUZIONE

Megjithë përpjekjet e bëra, sistemi financiar në Shqipëri mbetet prapa vendeve të rajonit. Vendi ynë vazhdon të ketë një përqindje të lartë *cash* të ekonomisë. Sektori bankar shqiptar duhet të ofrojë një gamë më të përshtatshme dhe më efikase të shërbimeve për emigrantët me qëllim menaxhimin më të mirë të dërgesave të tyre duke zgjeruar objektet e kreditit. Ai duhet të përballet më seriozisht me këtë problem.

Për sa i përket qeverisë, shumë pak është bërë për të planifikuar dhe menaxhuar migracionin dhe remitancat. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Veprimit 'Plani për Migracionin 2005-10' hartuar nga IOM ka qenë problematik për shkak të ndryshimit të qeverisë, mungesës së koordinimit, mungesës së fondeve dhe të disa strukturave të nevojshme për ta vënë në jetë atë.

Një Plan Kombëtar Veprimit për Dërgesat, i miratuar në fund të vitit 2007, kërkon me të drejtë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet sektorit bankar. Por duhet të themi se ky plan ofron shumë pak në sensin operativ duke mos dhënë praktikisht mënyrën për të arritur këtë qëllim si dhe për të ndihmuar emigrantët. Për më tepër, në këtë plan ka vakuum në ofrimin e informacionit në lidhje me përdorimin e remitancëve për biznes dhe për investime.

Pavarësisht nga fakti se u krijua një organizatë qeveritare (ALBINVEST) për këtë çështje mbetet shumë për t'u bërë.

Së fundi, premtimet zgjedhore të forcave politike për emigrantët potencialë të kthyer, të cilët duan të investojnë kursimet e tyre kanë mbetur në letër, duke vepruar si faktorë të përforcuar për mosbesim ndaj situatës reale në Shqipëri.

Ky material nuk me duket ne
rregull mungojne tabelat

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TE EMIGRIACIONIT SHQIPTAR

Kosta BARJABA

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Jona MARASHI

Simpson College, USA

Joniada BARJABA

Stanford University, USA

ABSTRACT

The vulnerability of Albania in the global migration system, the context and background of such a weakness and the nature of Albanian migration as a particular case of international migration, have shaped some of the symptoms of contemporary Albanian migration, which are linked with its vulnerability, dynamic, particularity and exceptionality.

Keywords : Albanian migration, development, migration flow,

Numri i emigrantëve shqiptarë po arrin shifra rekord. Shqipëria është aktualisht vendi evropian me fliksin më të madh të emigracionit. Emigrantët shqiptarë kapin shifrën e më shumë se një milion. Komuniteti i emigrantëve konsiston në mbi 25% të popullatës dhe mbi 35% të popullatës aktive. Aktualisht fluksi mesatar i emigracionit në vendet në zhvillim është afërsisht 5-6% të popullatës aktive. Rrjedhimisht fluksi i emigracionit shqiptar është 5-6 herë më i madh se fluksi mesatar i vendeve në zhvillim.

Aftësitë dhe performanca ekonomike e emigrantëve shqiptarë po bie. Kjo ka ardhur si arsye e kapaciteteve të limituara të tregut të punës së vendeve pritëse për të thithur forcën punëtore të huaj, për arsye të reformave strukturore për të arritur standardet e BE-së dhe të impaktit të krizës aktuale ekonomike. Këta faktorë e bëjnë tregun kombëtar të punës më kërkues. Edhe faktori moshë duhet

marrë në konsideratë. Brezi i parë i emigrantëve po arrin moshën e pensionit kurse brezi i dytë po përballlet me pengesa dhe vështirësi për të hyrë në tregun e punës.

Të ardhurat e emigrantëve shqiptarë vazhdojnë të jenë më të ulta se sa të vendasve. Kjo lidhet me përkeqësimin e performancës së tyre ekonomike. Hendeku ndërmjet të ardhurave të emigrantëve dhe vendasve po zvogëlohet me vonesë. Eksperienca emigruese tregon se hendeku në të ardhura emigrantëve vendas zvogëlohet me vetëm 10% në dy dekadat e para të emigrimit (Borjas, 1999). Emigrimi bashkëkohor shqiptar po festoon aktualisht përvjetorin e 20të.

Përkatësia etnike e emigrantëve shqiptarë vazhdon të luajë rol. Emigrantët shqiptarë përbëjnë shumicën e emigrantëve në Greqi dhe zënë vendin e dytë në Itali. I ashtuquajturit fenomen i viktimizimit, inkriminimit dhe demonizimit si dhe perceptimi public për emigrantët shqiptarë ka ndryshuar në mediat lokale. Sidoqoftë ato vazhdojnë të kenë një impact të dukshëm në bërjen e politikave të emigacionit si dhe në formimin e sjelljes shoqërore të popullsisë vendase në vendet pritëse (Perrone, 1998). Megjithë progresin e dukshëm hendeku ndërmjet imazhit të emigrantit shqiptar dhe atij të një origjine tjetër duhet të vazhdojë të merret në konsideratë.

Emigrantët shqiptarë rrezikojnë mundësitë për punësim të vendasve me më pak aftësi. Kjo ndodh jo vetëm për emigrantët shqiptarë të cilët kanë një nivel të dobët aftësish dhe arsimimi por edhe për ata që kanë aftësi të larta, të cilët punësohen në sektorë që kërkojnë aftësi të ulëta në vendet pritëse. Kjo konkurrencë në tregun e punës ka rritur ndjenjat anti-emigrantëve ndërmjet punëtorëve të kraut vendas të cilët ndikohen nga forca e huaj punëtore.

Emigrantët shqiptarë kanë një impakt të rëndësishëm fiscal në ekonominë dhe sistemin social të vendeve pritëse. Sa më pak të kualifikuar janë emigrantët aq më e madhe është barra fiskale e tyre, sidomos në Greqi dhe Itali vende që përballen me vështirësi në sistemin e tyre social dekadën e fundit. Sondazhet për emigrimin ndërkombëtar tregojnë se gjatë 15 viteve të para emigrantët janë një barrë por pas këtyre 15 viteve ata bëhen të rëndësishëm për sistemin social të vendeve pritëse. Duke u bazuar të kjo kornizë teorike mund të konkludojmë se emigrantët shqiptarë kanë filluar rishtazi të kontribuojnë në sistemin social në Itali, Greqi dhe vende të tjera pritëse.

Fitimet neto nëpër vendet pritëse nga emigrantët shqiptarë janë të konsiderueshme. Me futjen e shqiptarëve në tregun e punës në Greqi dhe Itali, rrogat e vendasve u ulën. Punëtorët vendas humbën sepse emigrantët e ulën nivelin e rrogave. Por në të njëjtën kohë firmat vendas fituan nga kjo dukuri. Pra punëdhënësit fituan sepse emigrantët e ulën koston e punës. Nga

këndvështrimi i konsumatorëve, këta të fundit fituan sepse kostoja e ulët e punës con në mallra dhe shërbime më të lira për ta. Në përgjithësi impakti i emigrantëve në ekonominë dhe sistemin social të vendeve pritëse mund të konsiderohet si një program rishpërndarjeje e pagave, një lëvizje e pasurisë nga punëtorët vendas të cilët konkurrojnë me emigrantët drejt punëdhënësve dhe konsumatorëve. Emigracioni mund tu sjellë humbje por edhe përfitime vendeve pritëse edhe në mënyrë të tërthortë: prodhime dhe shërbime që sillen nga emigrantët, gatimi, prodhime kulturore etj. Por nga ky këndvështrim impakti i emigrantëve shqiptarë nuk është i rëndësishëm sepse kuzhina shqiptare si dhe produkte dhe shërbime të tjera nuk po përhapen në vendet pritëse.

Paligjshmëria kundër ligjshmërisë: Emigrimi i shqiptarëve filloi si i paligjshëm dhe u shndërrua në të ligjshëm. Në valët e para të emigrimit shqiptar, edhe Shqipëria si një vend dërgues por edhe vendet pritëse si Greqia dhe Italia ishin të papërgatitura për të administruar valët dalëse dhe hyrëse të emigrantëve. Në kontekstin e përpjekjeve për të rregulluar fluksin e emigrantëve Shqipëria nënshkroi marrëveshje për punësim sezonal me Greqinë në pranverë të vitit 1996 dhe me Italinë në vjeshtë të vitit 1997. Përmirësimi i kornizës ligjore të emigracionit pati një impakt të dukshëm në ndryshimin e raportit të flukseve të rregullta dhe të parregullta të emigrantëve. Dominimi i flukseve të rregullta kundrejt atyre të parregullta filloi në vitin 1998. Rreth 70,000 emigrantë shqiptarë të paligjshëm u legalizuan në Greqi dhe Itali gjatë periudhës 1998-2005. Rrjedhimisht gjatë vitit 2006 raporti emigrant i rregullt - i parregullt (për emigrantët shqiptarë) në Greqi ishte 1.5-1 dhe në Itali 3-1. Aktualisht ky raport po ndryshin në favor të emigrantëve të ligjshëm. Studiuesit kanë bërë kërkime dhe kanë evidentuar anë të ndryshme të procesit të integritit të emigrantëve shqiptarë bë Itali (Barjaba & Perrone, 1996; Barjaba, 2002; Barjaba, 2008; Melchionda, 2003; Pittau & Forti, 2004).

Shqipëria ka një nivel të lartë të emigrimit të minorenëve, grave dhe familjeve. Ashtu si edhe vendet e tjera ballkanike (Booth, 1992), Shqipëria ka përjetura një nivel të lartë të emigrimit familjar të favorizuar nga afërsia kulturore, linguistike dhe gjeografike si dhe nga kostoja e ulët për të emigruar në vendet fqinje. Vendi ka përjetuar një fluks të lartë të emigrimit të minorenëve të shoqëruar dhe jo si dhe emigrimin e grave. Emigrimi i grave është favorizuar nga lehtësia e tyre për të hyrë në tregun e punës sidomos në aktivitetet shtëpiake. Kjo shkaktoi një lloj tjetër të tipologjisë të vejushave: Shqipëria nuk ka “të ve të bardha” si në rastin e vendeve të tjera në zhvillim, po një lloj “mashkulli të ve”. Bashkëshortë qëndruan në shtëpi kurse gratë e tyre emigruan.

Niveli i lartë i emigrimit të njerëzve të kualifikuar është një tjetër

karakteristikë e emigracionit shqiptar. Rreth 50% e lektorëve, kërkuesve shkencorë dhe intelektualëve janë larguar nga Shqipëria që prej vitit 1990. Rreth 60% e shqiptarëve që kanë kryer studimet e doktoraturës në Evropën perëndimore ose në SHBA ose janë larguar nga Shqipëria ose nuk janë kthyer në Shqipëri pas diplomimit (UNDP, 2006). Pjesa më e madhe e profesionistëve të kualifikuar kanë gjetur punë në sektorë të ndryshëm nga a ii kualifikimit të tyre. Për këtë arsye fenomeni “Brain Drain” është etiketuar në mënyrë simbolike “Fenomeni Kanada” sepse politikat e emigracionit në Kanada favorizojnë emigrimin e njerëzve të kualifikuar dhe kjo gjë ka tërhequr shumë shqiptarë në këtë vend.

Emigrimi dhe burimi i konsumit kundër emigrimit dhe zhvillimit. Sic u përmend më sipër, studiuesit kanë arritur në përfundimin se gjatë 15 viteve të para të emigrimit, emigrantët janë një burim i mbijetesës ekonomike dhe konsumatore për vendet e origjinës. Kjo gjë vlen edhe për emigracionin shqiptar. Politikat dhe veprimet për të përdorur emigracionin si një faktor për zhvillimin e vendit i përkasin kohëve të fundit (King & Vullnetari, 2004). Strategjia për administrimin e emigracionit është aprovuar në vitin 2005 dhe bashkë me të edhe masa dhe iniciativa për të mbështetur kthimin vullnetar të emigrantëve.

Varësia e ekonomisë së vendit nga remitancat është proverbiale në rastin e Shqipërisë. Remitancat përbëjnë 15% të GDP-së dhe rreth 13% të të ardhurave familjare. Shqipëria është vendi me varësinë më të madhe nga remitancat. India që është vendi më i madh pritës i remitancave në botë ka një mesatare prej 30 USD per capita kurse Shqipëria rreth 500USD per capita (MPI, 2009). varësia e lartë e bën të nevojshme administrimin vizionar të remitancave dhe rrit rrezikun e konsekuencave të administrimit të dobët. Administrimi i dobët demonstron edhe si një mungesë sinergje midis remitancave dhe burimeve të tjera të rëndësishme të zhvillimit si investimet e huaja direkte dhe tregëtia.

Bibliografi

Barjaba, K. 2008 *Immigrazione Albanese, integrazione e sviluppo*, in Devole, R.; Pittau, F., Ricci, A., Urso, G. *Gli Albanesi in Italia, Conseguenze economiche e sociali dell'immigrazione*, Edizioni Idos;

Barjaba, K. 2002 *Ondate senza Ritorno: Scritti e Saggi sull'Emigrazione Albanese*. Rome: *Organizzazione Internazionale per le Migrazioni*;

Barjaba, K., Perrone, L. 1996 Forme e grado di adattamento dei migranti di cultura albanese in Europa (Italia, Grecia, Germania): 1992-1995, In Barjaba, K., Lapassade, G., Perrone, L. 1996 *Naufragi Albanesi, Roma: Sensibili alle Foglie*;

Booth, H. 1992 *The migration process in Britain and West Germany, Avebury, Ashgate Publishing Ltd, England*;

Borjas, G. 1999 *Heaven's Door. Immigration Policy and the American Economy, Princeton University Press, New Jersey*;

King, R. and Vullnetari, J. 2004 *Migration and Development in Albania. Brighton: University of Sussex, Development Research Centre on Migration, Globalisation and Poverty, Country Background Paper.*

MPI, 2009 *Migration Policy Institute, Washington DC*;

Melchionda, U. (ed.) 2003 *Gli Albanesi in Italia. Inserimento Lavorativo e Sociale. Milano: Franco Angeli*;

Perrone, L. 1998 *I flussi migratori albanesi tra stereotipi e pregiudizi, Da Qui, 4*;

Pittau, F., Forti, O. 2004 *Italia, paese di immigrazione: tra flussi regolari e irregolari, Studi Emigrazione, 153*;

UNDP 2006 *From Brain Drain to Brain Gain: Mobilising Albania's Skilled Diaspora. A policy paper for the Government of Albania. Prepared by the Centre for Social and Economic Studies, in collaboration with the Development Research Centre on Migration, Globalisation and Poverty, University of Sussex, UK, Tirana, April.*

MIGRACIONI, LËVIZJA E LIRË E PERSONAVE DHE MARRËVESHJET E RIPRANIMIT

Ledia HYSI

Ministria e Punëve të Jashtme

ABSTRACT

The paper will have as main objective to analyze the movements of people in general, and the causes and reasons that push people to emigrate. Aspect of the analysis will be the migration policies. With attention in this paper is an analysis of Albania on the legal framework and its attitudes toward the phenomenon of migration. The paper will present an overview of the readmission agreements in contemporary Europe and the effect that they bring to the field of migration, the international obligations of states and international acts to which they rely. A specific focus in the paper will take the MARRI (Regional Initiative for Migration, Asylum and Refugees), which addresses issues of population movement in the Western Balkans, aiming at a closer regional cooperation and ensuring an integrated approach to contemporary issues of migration, border management, visa policies, etc., to reach European and International standards.

Keywords : migration, free movement, border management,

1) Migracioni

Lëvizjet e personave në përgjithësi, ndodhin kur një person, një familje, një grup njerëzish ose një numër i pacaktuar njerëzish për arsye politike, ekonomike, të luftës, etj., detyrohen të lënë vendin e tyre dhe të shkojnë në

një vend tjetër, qoftë edhe provizorisht, ose për një kohë të gjatë. Si i tillë, ka ekzistuar edhe ripranimi apo mospranimi i njerëzve të veçantë apo grupeve nga një vend në tjetrin.

Ky fenomen është shumë i lashtë, por për herë të parë në mënyrë të organizuar ai filloi kryesisht pas Luftës së Parë Botërore, ku emigrimet ishin të shumta si në raste, ashtu edhe në sasi. Në këtë periudhë masa të mëdha njerëzish emigruan jo vetëm në vendet e ndryshme të Europës, por kaluan oqeanin duke shkuar në SHBA, Australi, Amerikën Latine, Kanada etj, vende këto që nuk ishin dëmtuar nga luftërat dhe që kishin një sipërfaqe të madhe toke, si dhe një popullsi të rrallë.

Ky emigrim vazhdoi edhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe, pas përfundimit të saj, për herë të parë u krijuan organizmat që merreshin me rregullimin ndërkombëtar të migracionit. Krahas planifikimit dhe organizmit të lëvizjeve të popullsisë nga organizatat ndërkombëtare, lëvizjet spontane, të paorganizuar ose klandestine janë të pashmangshme. Nga studime të ndryshme rezulton se rreth 70% e të huajve nëpër botë hyjnë ilegalisht në vendet ku ata ndodhen.

Ripranimi dhe largimi nga vendi, shpesh herë shkojnë në konformitet me njëri-tjetrin. Në rastet e konflikteve, njerëzit janë të detyruar të largohen për një arsye madhore nga vendi dhe, kuptohet që me qetësimin e gjendjes, me zgjidhjen e konflikteve, rikthimi është i mundshëm dhe i pamohueshëm. Këto janë ripranime të pashmangshme dhe që nuk kanë domosdoshmëri përfundimin e një marrëveshje.

Lëvizja e lirë e individit është koncept që ka evoluar që nga lashtësia. Nëse fillimisht lëvizja konsiderohej si një e drejtë e individit, i cili zgjidhte vetë ku do të qëndronte dhe nga do të udhëtonte, më pas ishte një lëvizje e kontrolluar nga vasali dhe e kufizuar nga pushteti.

Në ditët tona, koncepti i lëvizjes së lirë të individit ka ndryshuar krejtësisht. Ky koncept trajtohet në kuadrin e marrëdhënieve të krijuara ndërmjet individit dhe shtetit, si dhe ndërmjet vetë shteteve, është një e drejtë dhe një detyrim që duhet respektuar në të njëjtën kohë. Akti Final i Helsinkit mbështetet në të gjitha parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare, një ndër to është dhe ai i sovranitetit të barabartë dhe respekti për të drejtat që rrjedhin nga sovraniteti.

Shtetet pjesëmarrëse angazhohen se do të respektojnë barazinë sovrane dhe individualitetin e njëri-tjetrit, ashtu si dhe të drejtat, duke përfshirë në mënyrë të veçantë të drejtën e çdo shteti për barazi ligjore, integritet territorial, liri dhe pavarësi politike.

Në Aktin final të Helsinkit, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, parashikohen marrëdhënie reciproke ndërmjet shteteve, përmirësimi sigurisë dhe procesit të bashkëpunimit. Procesi i Helsinkit u ofron vendeve pjesëmarrëse

një kanal komunikimi, një kod sjelljeje normativ (për marrëdhëniet ndër-shtetërore dhe brenda-shtetërore) ashtu si dhe një program afat gjatë bashkëpunimi. Ky Akt zgjeroi qëllimin e marrëdhënieve ndër-shtetërore duke prezantuar fusha të reja bashkëpunimi, ndërmjet të cilave: të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e lëvizjes së lirë të personave, janë ndër më domethënëset.

Duke marrë në konsideratë se marrëdhëniet ndërkombëtare duhet të përfshijnë një «dimension human» fitimprurës për vetë individin, angazhimet në këtë fushë bëhen çështje të interesimit legjitim për të gjitha vendet pjesëmarrëse dhe nuk i përket ekskluzivisht vetëm çështjeve të brendshme të një shteti. Lëvizja e lirë e personave është një ndër çështjet më të diskutuara në rajon.

Duke marrë për bazë bashkëpunimin në fusha të ndryshme si tregtia, turizmi, bashkëpunimi ekonomik, arsimit, aktivitetet kulturore sportive etj, liria e lëvizjes nuk konsiderohet vetëm si një e drejtë individuale, por dhe si një e drejtë kolektive që i përket shtetit. Ky i fundit duhet të krijojë kushtet për lëvizje si për shtetasit e tij, ashtu edhe për të huajt që hyjnë në territorin e tij. Në këtë kuadër, përveç të drejtave, ka edhe detyrime reciproke, përmbushja e të cilave krijon bazë mirëbesimi dhe ndërmarrje të veprimeve të përbashkëta, jo vetëm ndërmjet vendeve fqinje, por të gjithë rajonit dhe më gjerë.

Përgjithësisht kërkohet që të ketë një sistem kufitar të mirë organizuar, dokumente të vlefshme udhëtimi, shkëmbim informacioni mbi legjislacionin në fuqi për trajtimin e të huajve dhe ekzistencën e strukturave efikase për parandalimin e trafikut të qenieve njerëzore, si dhe bazën ligjore për të ripranuar shtetasit e tij dhe të vendeve të treta kur kalojnë nga territori i një shteti në atë të një tjetri në mënyrë të paligjshme, harmonizimi i legjislacionit dhe praktikës lidhur me dhënien e azilit dhe trajtimin të refugjatëve.

Shpesh herë konstatohet konflikt midis parimeve për lëvizjen e lirë dhe kufizimeve që u vihen vendeve të veçanta, në këtë kuadër edhe Shqipërisë. Shmangie ndaj këtij konflikti do kishte arritja e rezultateve graduale në stabilitetin politik, lufta efikase kundër trafikut ilegal, si dhe krijimi i një "imazhi" pozitiv në arenën ndërkombëtare. Vetë iniciativat e fundit të Bashkimit Evropian konsistojnë në krijimin e një kuadri ligjor dhe strukturave të posaçme për parandalimin e trafikut të qenieve njerëzore dhe përfundimin e marrëveshjeve të ripranimit me vendet e treta, duke kontrolluar dhe kufizuar në një farë mënyre lëvizjen e lirë të individëve.

Shqipëria është plotësisht e angazhuar në plotësimin e kuadrit ligjor dhe strukturor të përshtatshëm për të krijuar lehtësitë e nevojshme në bashkëpunimin maksimal me vendet e rajonit e më gjerë. Qëndrimi për sa i përket forcimit të kontrollit kufitar, bashkëpunimit në luftën kundër trafikëve,

përfundimin e marrëveshjeve të ripranimit dhe lehtësimin e lëvizjes së lirë të shtetasve të saj, përputhet me prioritetet e politikës së vendeve të rajonit.

Shqipëria është angazhuar, duke marrë masa konkrete në adoptimin e Ligjit për të Huajt dhe gjithë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e tij konform legjislacionit ndërkombëtar. Gjithashtu është në procesin e përfundimit të marrëveshjeve të ripranimit me vendet e treta, ndërkohë që nuk kanë munguar kontaktet diplomatike dy dhe shumëpalëshe me qëllim realizimin e lehtësimit të lëvizjes së personave nga një vend në tjetrin.

Ndërkohë që dhe kontaktet shumëpalëshe kanë qënë mjaft intensive dhe me rezultate konkrete ndër vendet e rajonit, kjo e shprehur në takimet që nismat rajonale kanë organizuar duke patur në axhendën e diskutimit dhe lehtësimin e lëvizjes së individëve në vendet e rajonit. Pothuajse gjithë vendet pjesëmarrëse në këto takime mbështesin idenë e një lëvizje të lirë dhe të pakufizuar të individëve jo vetëm për kategorinë e turistëve dhe studentëve, por dhe për atë të biznesmenëve, transportuesve ndërkombëtare etj, reflektuar kjo në përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe për liberalizmin e vizave.

Krijimi i lehtësirave në lëvizje, jo vetëm që shpreh një shkallë të lartë bashkëpunimi ndër vendet e rajonit, por krijon bazat për një bashkëpunim dhe komunikim gjithmonë e më të madh në të gjitha fushat e interesit të përbashkët.

Qëllimi kryesor konsiston në shkëmbimin e eksperiencave dhe know-how në fusha të përcaktuara të interesit të përbashkët. Por është akoma më e rëndësishme për vendet që problemet rajonale t'i zgjidhin me veprime të përbashkëta. Këtu përfshihen jo vetëm çështje të politikës, por edhe çështje të një natyre operative si: krijimi i një strukture rajonale për luftën kundër krimit të organizuar, me synimin që strategjia rajonale të mund të zhvillohet dhe të zbatohen gjithë mekanizmat e nevojshëm. Duke patur një ekspertizë në fushën e sistemit kufitar dhe migracionit për të kontribuar në shkëmbimin e eksperiencës teknike, bashkëpunimin e forcave policore në një shkallë më të lartë dhe reformat institucionale, do të ketë një impakt të konsiderueshëm në termat e sinergjisë. Krijimi i gjithë këtyre kushteve lehtëson lëvizjen reciproke të individëve dhe ndihmon strukturat shtetërore në konsolidimin përfundimtar konform standarteve të pranura evropiane.

Plotësimi i kriterëve konsiston, ndër fushat e tjera të politikës, legjislativit dhe ekzekutivit, në krijimin e një sistemi të harmonizuar të politikës së migrimit, trajtimit të të huajve, dhënies së vizave dhe procedurave të lëvizjes së të huajve brenda një vendi, të njëjtë me atë të vendeve të tjera të Bashkimit Evropian.

Lëvizja e lirë e individit, edhe pse parashikohet në dispozitat e shumë akteve ndërkombëtare, është një e drejtë themelore e cila duhet të respektohet nga çdo individ apo autoritet. Për t'u respektuar në mënyrë efikase, duhet të krijohen

bazat për zbatimin e kësaj të drejte. Krijimi i bazave parashikon ekzistencën e një sistemi ligjor që respekton sovranitetin e vendit dhe pavarësinë territoriale. Mbi të gjitha duhet që ky sistem ligjor të jetë një lloj i zbatueshëm në vendet të cilat kanë bashkëpunim dhe marrëdhënie reciproke.

Shqipëria është plotësisht e angazhuar në respektimin e gjithë detyrimeve ndërkombëtare që trajtojnë lëvizjen e lirë të individëve, duke bërë hap pas hapi përshtatjen e procedurave të brendshme ligjore me ato të pranuar ndërkombëtarisht, duke marrë pjesë aktive në të gjitha iniciativat rajonale, duke u siguruar informacionin e nevojshëm në këtë fushë dhe duke zbatuar në praktikë gjithë angazhimet e marra.

Në këtë mënyrë Shqipëria dhe një herë konfirmon dëshirën dhe vullnetin për të vepruar në unanimitet me organizmat ndërkombëtare dhe duke respektuar në të njëjtën mënyrë vullnetin dhe iniciativat e vendeve të rajonit.

2) Politikat e migracionit

Shqipëria është e ndërgjegjshme për faktin që ekziston realisht një nevojë për të përballuar efektet negative që lëvizjet jo të rregullta të njerëzve mund t'i imponojnë një shoqërie në zhvillim.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Migracionin¹, si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit², qeveria Shqiptare synon një menaxhim dhe kontroll konstruktiv të flukseve migratore, në interes të stabilitetit të brendshëm dhe prosperitetit ekonomik, ku do të kontribuonte në një përdorim më të mirë të burimeve të disponueshme njerëzore mbi bazën e një tregu fleksibel punësimi dhe rritjen e mundësive për të hyrë në marrëveshje formale, individuale apo kolektive, me vende të tjera evropiane me skema që nxisin liri më të madhe të lëvizjes dhe liberalizim eventual të regjimit të vizave.

Në këtë kuadër kërkohet angazhim në trajtimin e barabartë dhe të drejtë të shtetasve të vendeve të tjera, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit në këtë fushë dhe arritjes së standarteve evropiane.

Në të njëjtën kohë kërkohet edhe angazhimi për respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë në vendet ku ata jetojnë, duke kërkuar një trajtim të barabartë dhe respektim të standarteve ndërkombëtare në këtë fushë.

1 Miratuar me VKM nr. 760, datë 19.11.2004

2 nenet 46, 48 dhe 80 të MSA

3) Vështrim i përgjithshëm mbi marrëveshjet e ripranimit në Europën bashkëkohore.

Përgjithësisht marrëveshjet e ripranimit u shfaqën në praktikën e shteteve dekadën e parë pas Luftës së Dytë Botërore, kryesisht në vendet e Europës Lindore. Fillimisht ato parashikonin të rregullonin kontrollin kufitar dhe trajtimin e personave të cilët hynin në mënyrë të paligjshme në territorin e shtetit palë në marrëveshje.

Marrëveshjet konfirmojnë dhe parashikojnë një strukturë të përgjegjësive së shteteve për shtetasit e tyre, të cilët hynin ose qëndronin në mënyrë jo të ligjshme në territorin e palës tjetër kontraktuese. Duke filluar nga fundi i viteve 1980, si pasojë e ndryshimeve politike në Evropë, në fillim të proceseve demokratike dhe të luftës kundër regjimit komunist, u parashikua që një lëvizje prej rreth 30 milionë vetësh do të ndodhte në drejtim të perëndimit dhe, si rrjedhojë, do të ishte shumë vështirë të kontrollohej kjo lëvizje.

Vetëm gjatë vitit 1989 nga vendet e Evropës Lindore emigruan drejt asaj Perëndimore 1300000 vetë. Me kalimin e kohës dhe ndryshimin e kushteve, vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore u transformuan gradualisht nga sjellës të emigrantëve, në vendet e pritjes dhe transportimit të emigrantëve. Këto të fundit mbeten akoma jo aq «tërheqës» për refugjatët ose emigrantët, të cilët thjesht kërkojnë një përmirësim të kushteve të jetës krahasuar me ato të vendeve të tyre të origjinës, sesa të vendeve fqinje perëndimore.

Marrëveshjet e ripranimit kërkojnë nga vendet palë të ripranojnë kategori të caktuara të personave në territorin e tyre në bazë të kërkesës së palës tjetër kontraktuese. Në zbatim të këtyre marrëveshjeve, personat që duhen ripranuar janë shtetas të shtetit dhe, në kushte të caktuara, shtetas të vendeve të treta ose persona pa shtetësi, të cilët kanë kaluar nëpërmjet territorit të palës së kërkuar ose kanë një leje qëndrimi për territorin e këtij të fundit.

4) Marrëveshjet e ripranimit dhe detyrimet ndërkombëtare të shteteve.

Në bazë të praktikës së të drejtës ndërkombëtare, çdo shtet është i detyruar të ripranojë shtetasit e tij, edhe në mungesë të një marrëveshje ripranimi. Çështja e nevojës për një marrëveshje të tillë shtrohet më tepër kur bëhet fjalë për ripranim të shtetasve të huaj, të një shteti të tretë, që përdorin territorin e një shteti për të kaluar në territorin e një shteti tjetër që kërkon dhe ripranimin e tyre.

Marrëveshjet synojnë të parandalojnë lëvizjen tranzit të personave që nuk janë në posedim të dokumenteve të nevojshme të vlefshme të udhëtimit për të hyrë në vendin fqinj apo vendin e destinacionit. Për realizimin e tyre është i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet shteteve të cilat nuk janë vende tranziti por vende pritëse.

Në përfundimin e marrëveshjeve të ripranimit, kërkohet intensifikimi dialogut ndërmjet shteteve duke përfshirë konfirmimin e parimit të marrëdhënieve të mira në baza reciprociteti, me qëllim parandalimin e trafiqeve të paligjshme të personave dhe lëvizjet klandestine.

Disa shtete theksojnë se qëllimi i përfundimit të marrëveshjes së ripranimit nuk është përsëritja e këtij detyrimi, por lehtësimi i zbatimit të tij. Marrëveshje të tilla janë të nevojshme për përcaktimin e formaliteteve të kërkuara për ripranim, llojin dhe nivelin e evidencave të nevojshme, si dhe përcaktimin se cila palë do të mbulojë shpenzimet e ripranimit, apo kthimit.

Nga ana tjetër, përfundimi i marrëveshjeve të ripranimit mund të krijojë përshtypjen se vendet kanë detyrim ndërkombëtar të ripranojnë shtetasit e tyre vetëm kur kjo është parashikuar në marrëveshje të tilla. Për të evituar këtë opinion, duhet theksuar në marrëveshje rolin zbatues të tyre.

Ripranimi i shtetasve të një shteti mbështetet në këto akte ndërkombëtare:

1. Neni 13 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të datës 10 dhjetor 1948, sipas të cilit çdo person ka të drejtë të kthehet në vendin e tij. Mospranimi i kthimit bie në kundërshtim me këtë nen.

2. Sipas termave të nenit 29 të po kësaj Deklarate, ushtrimi i të drejtës së personave për t'u kthyer në vendin e tyre, nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveçse atyre të parashikuara në ligj që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike, për të garantuar njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të të tjerëve si dhe për përmbushjen e kërkesave të moralit, rendit publik dhe mirëqenies për të gjithë.

3. Neni 12 i Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike parashikon se çdo person ka të drejtë të largohet nga çdo vend, përfshi dhe vendin e tij. Neni 4 i këtij Pakti parashikon se askush nuk mund të privohet nga e drejta për të hyrë në vendin e tij. Një dispozitë analoge përmban dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ku vendi ynë është palë. Për më tepër aty citohet: "askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të hyrë në territorin e shtetit, shtetas i të cilit ai është".

Në rastin e ripranimit ndeshen çështja e sovranitetit të shtetit mbi shtetasit e tij me atë të sovranitetit territorial të shtetit tjetër. Nga pikpamja juridike, e drejta e kthimit në atdhe korrespondon me detyrimin për të ripranuar personat të cilëve u është refuzuar zgjatja e qëndrimit të tyre nga një shtet tjetër, i cili ligjërisht ushtron sovranitetin e tij territorial. Garancia e respektimit të të drejtave të njeriut në rastin e kthimit në vendin e origjinës do të varet nga vullneti i personit për t'u kthyer. Kjo bazohet në një të drejtë individuale të njeriut.

Nga ana tjetër, ekziston një detyrim i shtetit të origjinës për ta ripranuar personin, apo një grup personash, për shkak se nuk kanë respektuar ligjet e caktuara, konkretisht ato që lidhen me qëndrimin në territorin e shtetit tjetër. E thënë me fjalë të tjera, baza e detyrimit të një shteti për të pranuar shtetasit e tij është sovraniteti personal dhe territorial i shtetit. Rregulli ndërkombëtar kërkon që çdo shtet të mbikqyrë të paktën shtetasit e tij. Nëse këta shtetas gjenden në vende të tjera, ata përfitojnë nga mbrojtja diplomatike e shtetit të origjinës, i cili, është i autorizuar që në rast nevojë ta ushtrojë këtë mbrojtje edhe në shtetin e qëndrimit të shtetasit.

Në bazë të parimit të reciprocitetit, nga ana e tij, shteti i qëndrimit, ka edhe ai të drejtën të ushtrojë kompetencën e tij për të dërguar në vendin e tyre të huajt që, për arsye të drejta, nuk mund t'i mbrojë në territorin e tij. Zgjidhja e rasteve të tilla, për arsye të marrëdhënieve miqësore ndërmejt shteteve, bëhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

Problemi më shqetësues dhe më konkret, paraqitet në Europë, ndërmejt Bashkimit European dhe vendeve të tjera të Europës. Duke qenë se vendet e Europës në përgjithësi janë fare pranë njeri-tjetrit, ku kalimet kufitare bëhen me forma dhe mjete të ndryshme, deri duke kaluar edhe me këmbë dhe, duke parë një hendek të theksuar, për sa u përket kushteve ekonomike, ndërmejt vendeve të Europës Perendimore dhe asaj Lindore, kuptohet që flukset e kalimeve janë më të mëdha, më të shpeshta dhe nganjëherë edhe më shqetësuese.

Pavarësisht nga preferenca për një kthim vullnetar, shtetet, asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga e drejta e kryerjes së një kthimi të detyruar të refugjatëve kur nevoja e mbrojtjes ka kaluar si rezultat i ndryshimit të situatës në vendet e origjinës.

Përgjithësisht marrëveshjet e ripranimit janë kuptuar si një instrument për të parandaluar fluksin e pakontolluar të emigrantëve në vendet që kanë përfunduar marrëveshje të tilla. Por marrëveshjet nuk mund të zgjidhin problemin e emigrimit ilegal, sidomos kur pala tjetër kontaktuese nuk është "një vend i sigurtë" sipas kuptimit të Konventës së Gjenevës për sa i përket

lirisë nga persekutimi dhe abuzimit të të drejtave themelore të njeriut.

Nuk duhet harruar roli i marrëveshjeve të ripranimit në parandalimin e emigrimit të njerëzve të cilët largohen nga varfëria. Nga ky këndvështrim emigrimi është një nga mënyrat e zgjedhura për përmirësimin e kushteteve të jetesës. Sigurisht asnjë nga vendet europiane nuk është në gjendje të të pranojë qindra e mijëra njerëz në kërkim të kushteve më të mira të jetës. Zhvillimi global duhet të jetë qëllimi i komunitetit ndërkombëtar. Marrëveshjet e ripranimit janë efektive vetëm si një rregullim afat-shkurtër dhe moralisht të diskutueshme.

Ka opinione të ndryshme për mënyrën si mund të funksinojë një skemë ripranimi. Duhet pranuar se, fillimisht, theksi duhet vendosur tek mirëkuptimi për të arritur në një kthim vullnetar, duke marrë në konsideratë ndikimin në rritjen intelektuale apo dhe në eksperiencën që sjellin njerëzit e grupit intelektual të cilët kanë emigruar.

Në këtë pikë ka shumë diskutime dhe, kjo bie menjëherë në sy, nëse marrim në konsideratë fjalorin e përdorur në këto rastësi “identitet”, “kohezion” dhe “liri”, duke vazhduar më tej me “trashëgimi”, “kulturë” dhe “zhvillim”, shprehje këto të nevojshme për të përshkruar konceptin e veçantë të shoqërisë dhe për të justifikuar një kthim të vullnetshëm.

5) Bashkimi European, zgjerimi dhe politikat e ripranimit

Me kalimin e kohës, vendet e Evropës Lindore, vijnë duke u konsoliduar çdo ditë e më shumë si në aspektin politik ashtu edhe në atë ekonomik, shoqëror etj. Bashkimi Evropian, me anë të institucioneve të tij, po punon që të gjitha këto vende të integrohen në familjen e madhe evropiane. Dhe është fakt që kjo familje sa vjen e rritet. Kështu, Polonia, Republika Çeke, Republika e Hungarisë, Estonia dhe Sllovenia janë bërë anëtare të Bashkimit Evropian.

Ky fakt presupozon që e drejta e lëvizjes së lirë brënda vëndeve të Bashkimit Evropian do t’u garantohet gjithë shtetasve të vëndeve, anëtarë të rinj. Megjithatë, lëvizja e lirë nuk mund t’u garantohet që nga dita e parë e anëtarësimit. Mund të parashikohet një periudhë tranzitore, në fund të së cilës do të stabilizohet levizja e lirë. Mund të përmendim rastin e Greqisë, Spanjës dhe Portugalisë, ku u konsiderua e nevojshme një periudhë 7 vjeçare, përsa i përket aderimit në traktatet e Bashkimit Evropian.

Zbatimi i Marrëveshjes Shengen (inicuar në 1985, zbatuar në 1990) është tregues i një numër zhvillimesh pozitive, përsa i përket politikës së përbashkët të migracionit si:

- Politikë e harmonizuar e lëshimit të vizave;
- Bashkëpunim ligjor në procedurat e pranimit dhe ekstradimit;
- Efektivitet përsa u përket detyrimeve ligjore që rregullojnë kalimin ndërkuftar dhe ndalimin e personave të kërkuar;
- Bashkëpunim në luftën kundër tregëtisë së drogave;
- Përpunimi i një informacioni të përbashkët dhe rregjistrimi i tyre në sistemin kompjuterik.

Vetëm 10 vitet e fundit, janë adoptuar mbi 70 akte për emigracionin dhe azilin, disa prej tyre të detyrueshme dhe në fuqi (p.sh. Konventa e Dublinit: parashikon procedurat për fitimin e statusit të azilit, bashkëpunimin policor, lufta kundër trafikut të paligjshëm të njerëzve, drogës etj.) të cilat, pothuajse të gjitha, përfshijnë në përmbajtje të tyre dispozita të ripranimit ndërmjet vëndeve të Bashkimit Europian dhe vëndeve të asociuara si dhe vëndeve fqinje të tyre, të tëra së bashku duke synuar krijimin e një regjimi europian kolektiv dhe të harmonizuar.

Traktati i Amsterdimit ka si qëllim në vetvehte të sanksionojë harmonizimin e dëshirës së shteteve për bashkëpunim dhe bashkëveprim. Transferimi i sovranitetit shtetëror mbi kontrollin e hyrjes në struktura ndërshtetërore, sigurisht, kërkon zhvillimin e një procesi që kërkon besim në mundësinë dhe aftësinë e strukturave ndërshtetërore, duke ruajtur në të njëjtën kohe interesat vitale të shteteve dhe duke respektuar ndarjen e barrës "*burden-sharing*" në mënyrë të njëjtë.

Këto marrëveshje në përmbajtje të tyre parashikojnë, jo vetëm kthimin e shtetasve shqiptare, të cilët në mënyrë të paligjshme kanë hyrë në territorin e shteteve të tjera, për edhe të shtetasve të shteteve të treta të cilët kanë hyrë nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimi i menjëhershëm i kushteve ekonomike, papunësia dhe nevoja për standarte më të larta jetese, bënë që një numër i konsiderueshëm shqiptarësh të lënë vëndin e tyre duke emigruar kryesisht në vendet fqinje, Itali dhe Greqi, por edhe në vënde të tjera evropiane si Republika Federale e Gjermanisë, Belgjika, Zvicra etj.

Nga ana tjetër, Shqipëria u konsiderua si një trampolinë për vëndet e Europës Perëndimore nga shtetas të vëndeve në zhvillim. Krahas emigrimit të paligjshëm u evidentua dhe rritja e kriminalitetit dhe trafikeve të paligjshme.

Me zhvillimet demokratike u zgjerua edhe veprimtaria diplomatike, ekonomike, kulturore etj. Në këtë kuadër, krahas ndihmës që vëndet fqinje i akorduan Shqipërisë në fusha të ndryshme, për një zhvillim sa më të shpejtë

dhe konsolidimit të ekonomisë së tregut të lirë, kërkohet edhe respektimi i detyrimeve ndërkombëtare. Kjo, në aspektin e vendosjes së marrëdhënieve të partneritetit si dhe respektimit të normave të bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë.

Gjithashtu në zhvillimet e fundit ku Shqipëria po përgatitet për integrim në strukturat evropiane, ndër kushtet që duhen plotësuar është edhe ai i respektimit të sovranitetit territorial dhe parandalimit të trafikeve të paligjshme të personave, prostitucionit, drogës, lëvizjes klandestine, që mund të kontrollohen me përfundimin e marrëveshjeve të ripranimit jo vetëm me vendet e Bashkimit Europian, por edhe me vendet fqinje dhe vendet e treta.

6) Iniciativa Rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI)

Iniciativa Rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI) u krijua në vitin 2003, brenda kontekstit të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Nga qershori i vitit 2004 kjo iniciativë ka marrë karakter rajonal nën patronazhin e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECp). MARRI funksionon nën drejtimin e gjashtë vendeve anëtare të tij: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, i cili mbledhet dy herë në vit në Forumin Rajonal të MARRI-it.

MARRI trajton çështjet e lëvizjes së popullsisë në Ballkanin Perëndimor, duke synuar një bashkëpunim rajonal më të ngushtë dhe duke siguruar një përfaqëse bashkëkohore të integruar ndaj çështjeve të migrimit, menaxhimit të kufijve, politikave të vizave, etj., për të arritur standartet evropiane dhe ndërkombëtare.

Prioriteti i zhvillimit të veprimtarisë së MARRI-it është rritja e bashkëpunimit rajonal në fushat e veprimtarisë ndërmjet vetë vendeve të rajonit, si pjesë thelbësore e procesit të integrimit evropian dhe në respektim të Axhendës së Selanikut për Ballkanin Perëndimor³.

3 qershor 2003, në Selanik të Greqisë u mbajt takimi i trojkës evropiane për JHA me përfaqësues të Greqisë, Italisë, Komisionit Europian, vendeve të ballkanit perëndimor: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Serbi-Mali i Zi, vendet kandidatë: Bullgari Rumani, Turqi dhe përfaqësues të Europolit, Paktit të Stabilitetit, përfaqësues të BE në Bosnjë-Hercegovinë dhe Maqedoni, si dhe të UNMIK në Kosovë.

Axhenda ndër të tjera parashikon:

- Vendet pjesëmarrëse ranë dakort të përgatisin një listë të arritjeve, bazuar në angazhimet e marra në Konferencën e Londrës, 25 nëntor 2002, duke pasqyruar masat e marra për të luftuar efektivisht krimin e organizuar. Kjo listë e arritjeve do të prezantohet zyrtarisht

Objektivi kryesor i MARRI-t është të kontribuojë për një lëvizje të lirë dhe të rregullt të njerëzve në interes të sigurisë dhe prosperitetit, duke punuar në fushat e azilit, migracionit, menaxhimit të integruar të kufijve, politikës së vizave dhe bashkëpunimit konsullor, kthimit/zhvendosjes së refugjatëve, personat e zhvendosur.

Qendra rajonale MARRI me qendër në Shkup, Maqedoni, filloi të funksionojë në shtator 2004, duke përmbushur angazhimet politike të vendeve pjesëmarrëse. Gjithë vendet e MARRI-t kanë përfaqësuesit e tyre në qendër dhe veprojnë si bërthamë për konsultime, dialog, trajnime, shkëmbim informacioni, analiza dhe aktivitete të tjera rajonale. Nga prilli i vitit 2004 deri në prill të vitit 2005 dhe 2009-2010, Shqipëria ka patur presidencën e Forumit Rajonal të MARRI-t.

Inisiativa e MARRI-t trajton tre komponente që zenë një vend domethënës në politikat e vizave të vendeve perëndimore: hyrja dhe dalja e të huajve në Shqipëri, azili dhe migracioni. Gjatë presidencës së kësaj inisiative nga Shqipëria lehtësimi i lëvizjes së personave ka qenë objekti kryesor i çështjeve që trajtoi kjo inisiativë gjatë kësaj periudhe. Nga vendet fqinje u kërkua bashkërendimi i përpjekjeve për heqjen e vizave në hapësirën e Shengenit.

Konkluzione

Referuar parashtrimt të çështjes së lëvizjes së lirë të individëve dhe zbatimit të marrëveshjeve të ripranimit, një nga sfidat e autoriteteve shtetërore përveç punës në vijim të përfaqësuesve zyrtarë për hartimin e legjislacionit të brendshëm dhe zbatimit të tij efikas në praktikë, edhe qytetarët duhet të ndërgjegjësohen për të dhënë kontributin e tyre në paraqitjen e një imazhi pozitiv të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Deri tani konstatohet një punë e mirë në drejtim të anëtarësimit të Shqipërisë në aktet ndërkombëtare të cilat trajtojnë çështjet e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke përfshirë edhe lëvizjen e lirë të individit.

në Samitin e Selanikut, në qershor.

- Të hartohen plane Veprimi Kombëtare, pas Samitit të Selanikut, me qëllim luftën efektive të krimit të organizuar në baza afat-mesme, me mbështetjen e BE.
- Të forcohet bashkëpunimi i autoriteteve përkatëse të vendeve të ballkanit perëndimor me zyrtarët ndërlidhës të migrimit të vendeve të BE, në kuadrin e krijimit të Rrjetit të Zyrtarëve të Migrimit, me qëllim luftën e suksesshme të migrimit të paligjshëm dhe krimit të organizuar në përgjithësi.

Në këtë kuadër, nuk kërkohet vetëm arritja e standarteve si: pajisja e qytetarëve me karta identiteti, kontroll efikas i kufijve dhe i lëvizjeve kufitare, frenim i lëvizjes klandestine dhe në mënyrë të veçantë ndalim i trafikimit të qenieve njerëzore, por mbi të gjitha një rritje të standardeve të zhvillimit ekonomik në vend. Me rritjen e mirëqenies ekonomike, vjen edhe pranimi dhe perceptimi i plotë i politikave të familjes së madhe evropiane, në të cilën Shqipëria është e vendosur të bëhet pjesë, si një anëtare e saj me të drejta të plota së shpejti.

Një rol të veçantë luan edhe bashkëpunimi me vendet fqinje dhe ato të rajonit. Ka patur arritje të lavdërueshme pothuajse në të gjitha fushat e bashkëpunimit, duke përfshirë këtu jo vetëm aspektin politik, por edhe atë shoqëror e ekonomik, të finalizuara në një sërë marrëveshjesh dy dhe shumëpalëshe.

Përsa i përket marrëveshjeve të ripranimit, Shqipëria i ka respektuar gjithë detyrimet ndërkombëtare në këtë kuadër dhe i është përgjigjur pozitivisht çdo kërkesë për ripranimin e shtetasve të saj, edhe me vendet me të cilat nuk ka patur një marrëveshje ripranimi. Problematike dhe që kërkon një zgjidhje të shpejtë, mbetet trajtimi i shtetasve të vendeve të treta me të cilat ende nuk janë përfunduar marrëveshje ripranimi.

Bibliografia

Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

The externalisation of EU policies on migration and asylum: readmission agreements and comprehensive approaches. Dr. Agnes Huswitz

Direktiva "Mbi statusin e shtetasve nga shtete jo anetare të BE-se që janë rezidentë afatgjatë";

Direktiva e Këshillit, datë 28 Qershor 2001, pjesë e paragrafeve të Nenit 26 të Konventës që zbaton Marrëveshjen Shengen të 14 Korrikut 1985;

Rregullorja e Këshillit (KE), nr. 2252/2004, 13/12/2004, "Për standartet e sigurisë dhe biometrikën në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga shtetet anëtare"

Direktiven e Këshillit, datë 28 nëntor 2002 "Mbi përcaktimin e hyrjes së paautorizuar, treanzitit dhe qëndrimit";

Official Journal C 038 , 17/02/2003 P. 0001 – 0024

<http://www.marri-rc.org>

<http://ec.europa.eu>

